

BARRA FISKALE

në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor

2019

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019

Tatimet ndaj Prodhimit të Brendshëm

Barra fiskale sipas qarqeve/rajoneve në Shqipëri dhe Kosovë, 2018

Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacionit të shpenzimeve

Investimet dhe Normat Tatimore në 7 shtetet e Ballkanit Perëndimor

Indeksi GINI dhe pabarazia

Tax Freedom Day in Albania, Kosovo and Western Balkans in 2019

Tax to GDP ratio 2018

Tax burden according to regions in Albania and Kosovo in 2018

Distribution of tax burden based on the destination of expenditures

Investments and tax rates in the 7 countries of Western Balkans

GINI Index and Inequality

BARRA FISKALE

në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor

2019

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019

Raporti i Tatimeve, taksave dhe kontributeve ndaj Prodhimit të Brendshëm
 Barra fiskale sipas Qarqeve/Rajoneve në Shqipëri dhe në Kosovë në vitin 2018
 Investimi dhe Normat Tatimore në 7 shtetet e Ballkanit Perëndimor
 Indeksi GINI dhe pabarazia
 Shpërndarja e barrës fiskale

Studime Fiskale Shqiptare
 Edicioni 7^{të}

DITA E LIRISË FISKALE NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE BALLKANIN PERËNDIMOR, 2019

Qendra ALTAX është një nismë studiuësish shqiptarë me synimin e një qasje të re në ndihmë të politikës fiskale dhe ekonomike shqiptare me qasje drejt politikës fiskale evropiane. Qëllimi kryesor është që të promovojë edukimin me sistemin fiskal dhe pershtatjen e tij sipas ambjentit ekonomik, të ndihmojë tatimpaguesit dhe palët e interesuara (studentët, ekspertët në terren, studiuësit) nëpërmjet ekspertizës të jenë të informuar mbi ambjentin fiskal dhe klimën ekonomike. Nga ana tjetër bashkëpunimi me akademikë dhe ekspertë fiskale ndihmon për të zgjeruar dhe për të krijuar një audiencë të plotë në ndihmë të rritjes së kapaciteteve fiskale në Shqipëri dhe Kosovë.

NE JU NDIHMOJMË TË PAGUANI TAKSAT!
NE JU NDIHMOJMË TË MOS PAGUANI BAKSHISH PËR TAKSAT!

Studime Fiskale Shqiptare
DITA E LIRISË FISKALE
 Edicioni 7
 Nr. 2019/03/01
www.altax.al
altax@altax.al
 Datë 31.03.2019
 Tiranë, Shqipëri

© ALTAX

Studime Fiskale Shqiptare

Mars 2019

Përgatitja dhe shpërndarja
Qendra ALTAX

Barra Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019

Raporti i Tatimeve, taksave dhe kontributeve ndaj Prodhimit të Brendshëm

Barra fiskale sipas Qarqeve/Rajoneve në Shqipëri dhe në Kosovë në vitin 2018

Investimi dhe Normat Tatimore në 7 shtetet e Ballkanit Perëndimor

Indeksi GINI dhe pabarazia

Shpërndarja e barrës fiskale

Analiza dhe krahasimet, sipas tatimeve dhe shpenzimeve të kryera gjatë 2018, sipas zonave administrative të Shqipërisë shërben për të parë se kush zonë gjeografike është ngarkuar më shumë apo më pak me detyrime fiskale. Nga ana tjetër, një analizë më e detajuar në brendinë e dokumentit synon të orientojë politikën fiskale dhe debatin publik, për të verifikuar shpërndarjen e barrës dhe investimeve edhe për industri apo zona, të cilat duhet të kenë zhvendosje të barrës sipas situatës ekonomike që ndryshon vit pas viti.

Fjalë kyçe: barra tatimore, Shqipëria, Kosova, Ballkani Perëndimor, tatime, taksë, qark, rajon, shkalle tatimore, liri fiskale

JEL Classification: H20, H26

Dokumenti është përgatitur nga ekspertët e ALTAX, në serinë e përmbledhjeve tematike, me synimin që të kthehet në një burim diskutimi për gjithë të interesuarit, ose për ta përdorur në funksion të diskutimeve dhe analizave të politikave për shpërndarjen e barrës fiskale dhe zbatimin në praktikë në kuadër të politikës decentralizimit dhe forcimit të financave lokale.

Autorësia është e ALTAX.

Cilido që do të përdorë të dhëna apo pjesë nga ky botim, është i detyruar të shënojë autorësinë si referencë në publikimet që do të përdorë.

Dokumenti gjendet te faqja në internet www.altax.al

Nëse keni kërkesa apo pyetje dërgojini te altax@altax.al

Acknowledgment

(ENGLISH) ALTAX CENTER is an Albanian think-tank initiative assisted by tax experts and fiscal policy analysts, aiming at a new approach to Albanian-European fiscal and economic policy. The primary goal is to promote education in taxation, help and assist the taxpayers and interested parties (students, field experts, civil servants) with the proper expertise. On the other hand, the cooperation with the academics and fiscal experts helps to expand and create a comprehensive audience in help of increasing of fiscal capacities in Albania and Kosovo. One of our key goals is to achieve a more efficient and less complex tax system for all. Our comments and recommendations on tax issues are made solely in order to achieve this aim; we are an entirely apolitical organization.

ALTAX represents the interest of taxpayer and is founded to help, increasing the knowledge and education about the implementation in the right way of fiscal policies and public finances management. We are organized and work based on the principle "Right from the start".

WE HELP YOU TO PAY TAXES! WE HELP YOU NOT TO PAY BRIBE FOR TAXES!

Konsideratë

(ALBANIAN) Qendra ALTAX është një nismë studiuesish dhe analistësh fiskalë shqiptarë me synimin e një qasje të re analize dhe diskutimi në ndihmë të politikës fiskale dhe ekonomike shqiptare me qasje drejt politikës fiskale evropiane. ALTAX është një qendër studimore fiskale dhe punon që të rritë mirëkuptimin e qeverisë dhe publikut për çështje të lidhura me ndershmërinë e sistemit ekonomik, fiskal në shoqërinë civile në Shqipëri, si dhe kryerjes së shërbimeve publike vendore dhe qendrore të duhura dhe të qëndrueshme.

ALTAX përfaqëson interesat e taksapaguesve, si një qendër kërkimore të pavarur fiskale, në rolin e një komentatori të financave publike, politikës fiskale, ligjit tatimor, edukimit fiskal, politikave sociale dhe pabarazive sociale në shpërndarjen e mirëqenies duke vlerësuar zhvillimin e politikave me qëllim promovimin e zhvillimit në Shqipëri të krahasuara me vendet në rajon dhe botë.

NE JU NDIHMOJMË TË PAGUANI TAKSAT! NE JU NDIHMOJMË TË MOS PAGUANI BAKSHISH PËR TAKSAT!

Për komente dhe sqarime, ju mund të kontaktoni altax@altax.com

PËRSHKRIM

(ALBANIAN) Në serinë e publikimeve, një traditë e krijuar për të gjashtin vit për analizën mbi barrën fiskale, QENDRA ALTAX prezanton edhe këtë vit, barrën fiskale më të lartë dhe më të ulët, për secilin nga 12 qarqet dhe qytetin bregdetar të Sarandës në Shqipëri, si dhe për 7 rajonet që përfshijnë 31 komunat në Kosovë. Pësha e barrës fiskale paraqitet në studim edhe në krahasimin midis vendeve të Ballkanit Perëndimor duke bërë klasifikimin për barrën më të lehtë dhe barrën fiskale më të rëndë të regjistruar në vitin 2018 dhe të krahasuar me klasifikimin e një viti më përpara. Një vend të veçantë mban barra fiskale për Kosovën. Ajo trajtohet në nivel shteti, si dhe rajonesh. Qendra ALTAX e publikon për herë të shtatë barrën fiskale, si dhe ditën e lirisë fiskale. Llogaritja e peshës që ato mbajnë në raport me buxhetin dhe prodhimin e brendshëm rajonal është një tregues që synon të prezantojë disproporcionet midis rajoneve në dy shtetet shqiptare të Ballkanit, por edhe midis vetë vendeve të Ballkanit, ku një pjesë të veçantë mbajnë 7 vendet e Ballkanit Perëndimor. Ballkani është pjesë e Evropës, gjeografikisht i rrethuar nga anëtarë të BE-së. Popujt e BE-së dhe të rajonit kanë një trashëgimi të përbashkët dhe histori e të ardhme të përcaktuar nga mundësitë dhe sfidat e përbashkëta. BE ka kohë që është angazhuar fort në rajon.

Me përfshirjen e indeksit GINI në studim rritet analiza ku përfshihet efekti bashkëveprues i barrës fiskale, shpërndarjes së të ardhurave dhe përdorimit të taksave për shpenzime nga buxheti.

Qëllimi i prezantimit të këtij studimi është prezantimi i implikimeve të rëndësishme për qytetet dhe shtetet e përfshira në objektin e studimit, sepse tatimet, taksat dhe tarifat janë një pjesë kyçe e barrës së taksave dhe si një burim për mundësimin e shërbimeve publike, që ndikojnë në konkurrencën dhe në cilësinë e jetës, ekonomisë dhe mirëqenies së vendeve dhe qyteteve. Të dhënat e përdorura për llogaritjet janë marrë nga burime statistikore zyrtare, nga financat, tatimet dhe organizata që mbajnë të dhëna dhe publikojnë, si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një pjesë e të dhënave janë përpunuar dhe përdorur për të krahasuar dhe shërbyer si referencë kryesore për prezantimin. Me anë të studimit tentohet të tërhiqet vëmendja e politikës dhe studiuesve, medias fiskale, politikës fiskale dhe administrimit, si dhe kritikëve që mund të rezervojnë komente për vlerësimin apo kanë pyetje në lidhje me llogaritjet dhe faktet e prezantuara në dokument.

ABSTRACT

(ENGLISH) The thematic series of publications that are already a tradition about the debate of the tax burden in Albania and other countries of region as well, are presented by ALTAX Center again this year, with the lowest tax burden and highest tax burden indicators in 2017, for each region in Albania and Kosovo, which mean the classification for every of 12 albanian regions and the Saranda city in Albania, as well as 7 regions of Kosovo, which include 31 communes in total. The share of the tax burden is also presented in the comparison between the countries of the Western Balkans by making the classification for the highest burden and the lowest tax burden recorded in 2018 and compared with the previous year's rating. A special place of study also is the tax burden in Kosovo, which is published for the 7th time by ALTAX Center. Calculation of the share they have in relation to budget and domestic regional production is an indicator that aims to present disproportion between the regions in the two Albanian states, but also between the Balkan regions themselves, where a special part holds the seven Western Balkan countries. The Balkans are part of Europe, geographically surrounded by EU members. The peoples of the EU and the region have a common heritage and future history determined by common opportunities and challenges. The EU has long been strongly committed to the region.

With the inclusion of the GINI index in the study is added a depth analysis, including the interactive effect of fiscal burden, revenue distribution, and the use of taxes on spending from the budget.

The purpose of presenting this study is to present important implications for the cities and countries involved in the study, since taxes, and fees are a key part of the tax burden and a source for enabling public services that impact on competitiveness and quality of life, economy and welfare of countries and cities. The data used for the calculations are obtained from official statistics sources, from finances, taxes and organizations that keep data and publish them, both domestically and externally. Part of the data was processed and used to compare and serve as the main reference for the presentation. The study aims to attract policymakers and scholars attention, fiscal media, fiscal policy analysts and tax administration authorities, as well as critics who can reserve comment reviews or have questions about the calculations and facts presented in the document.

Terma dhe përkufizime

AKB	Të ardhura Kombëtar Bruto
Barrë Fiskale (Tatimore) (BF)	Shuma totale e tatimeve dhe taksave të paguara, si dhe tarifave doganore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas bazës të të ardhurës të tatimit përkatës (tatimet mbi kapitalin, mbi punën dhe tatimet mbi konsumin) nga një grup i caktuar tatimpaguesish, industrie, rajoni, shteti etj., të krahasueshme me çfarë paguajnë grupet, industrinë, rajonet, shtetet, etj.
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
Norma Tatimore në Total	Shkallët tatimore gjithsej llogariten si ngarkesë e tatimeve, taksave dhe kontributeve të detyrueshme për tu llogaritur dhe paguar nga bizneset dhe individët. Kjo barrë tregon më së miri peshën që vendos politika fiskale e një vendi mbi rezidentët dhe jorezidentët. Tatimet në burim (të tilla si tatimi mbi pagën) ose taksat dhe tatimet e mbledhura me agjent tatimor (të tilla si TVSH, tatimi mbi shitjen) janë të përjashtuara.
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
Tatimi mbi të ardhurat	<p>Tatim direkt mbi të ardhurat. Megjithëse termi përgjithësisht zbatohet për një tatim mbi individët (ku ai mund të përcaktohet si tatim mbi të ardhurat personale ose tatim mbi të ardhurat individuale), ai gjithashtu përdoret në disa vende për një tatim mbi personat juridikë, si p.sh. shoqëritë.</p> <p>Tatimi përgjithësisht zbatohet në bazë vjetore, d.m.th. mbi të ardhura të nxjerra në, ose lidhur me, një vit fiskal të caktuar.</p> <p><i>Mund të dallohen dy sisteme kryesore të tatimit mbi të ardhurat: një sistem tatimor global dhe një sistem tatimor tabelar mbi të ardhurat. Megjithatë, edhe në sistemet e tatimit global, në pikëpamjen e përkufizimeve të ndryshme teorike të të ardhurave, shumica e vendeve i specifikojnë postet që përbëjnë të ardhura për qëllime tatimore. Shkallët e tatimit mbi të ardhurat mund të zbatohen me shkallë progresive ku shkalla e tatimit rritet me rritjen e të ardhurave ose me shkallë fikse. Mund gjithashtu të vendoset një mbipagesë.</i></p> <p><i>Shumica e vendeve vendosin tatim mbi të ardhurat për totalin e të ardhurave në shkallë botërore të rezidentëve dhe për të ardhurat nga burime brenda vendit në rastin e jorezidentëve. Disa vende, megjithatë, e kufizojnë tatimin mbi të ardhurat në të ardhurat me burim të brendshëm si për rezidentët ashtu edhe për jorezidentët sipas parimit të territorit.</i></p>
Tatim mbi kapitalin	Termi përdoret për qëllime statistikore nga Kombet e Bashkuara për t’u referuar “detyrimeve kapitale (d.m.th. ato tatime të vendosura në intervale të parregullta dhe shumë të rralla mbi vlerat e aktiveve ose pasurinë neto në pronësi të njësive institucionale) dhe tatimeve mbi transferimet e kapitalit (d.m.th. tatimet mbi vlerat e aktiveve të transferuara ndërmjet njësive institucionale si rezultat i trashëgimisë, dhurimeve me gjallje (inter vivos) (d.m.th. kur donatori është gjallë) ose transferime të tjera”.
Tatimi mbi punën	Në këtë grup përfshihen tatimet që lidhen drejtpërdrejt me të ardhurat e krijuara nga puna. Të ardhura të tilla janë tatimi mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
Investimet e Huaja Direkte	Investimet e Huaja Direkte janë hyrjet neto të investimeve për të marrë një fitim në një ndërmarrje që vepron në një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit.
SNK	Standarte Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standarte Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
TVSH	Tatimi i vlerës së shtuar

PËRMBAJTJA

	Hyrje	Faqe 8
	Burimi të dhënave	Faqe 9
	Barra Fiskale në 4 vitet e fundit	Faqe 10
1	Ballkani Perëndimor, Ekonomia, Buxheti dhe Barra Fiskale, 2014-2018	Faqe 11
1.1	Ekonomia në Ballkanin Perëndimor	Faqe 11
1.2	Taksat dhe shpenzimet buxhetore në Ballkanin Perëndimor, 2014-2018	Faqe 14
1.3	Barra Fiskale në Ballkanin Perëndimor, 2014 -2018	Faqe 15
1.4	Struktura e tatimeve dhe taksave në Ballkan	Faqe 17
1.5	Barra fiskale në shtetet me taksim progresiv dhe ato me taksim të sheshtë	Faqe 18
1.6	Normat Tatimore Totale në Ballkan	Faqe 19
1.7	Normat tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe në Ballkan Perëndimor	Faqe 20
1.8	Ndryshimi i normave tatimore dhe indeksi GINI	Faqe 23
1.9	Investimet e Huaja Direkte dhe ndikimi nga barra fiskale	Faqe 25
1.10	Ndikimi i rritjes së investimeve nga ulja e normave të tatimit mbi kapitalin	Faqe 27
1.11	Efekti i Marrëveshjeve të eliminimit të taksimit të dyfishtë në Ballkan	Faqe 29
1.12	Efekti i politikës fiskale dhe qasja e administrimit	Faqe 30
2	Barra Fiskale në Shqipëri 2018	Faqe 32
2.1	Performanca e barrës së buxhetit dhe barrës fiskale	Faqe 32
2.2	Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacionit të buxhetit	Faqe 33
2.3	Barra e të ardhurave fiskale të bashkive	Faqe 35
2.4	Barra fiskale rajonale ndaj PBB-së në Shqipëri	Faqe 37
2.5	Qarqet me barrën fiskale më të ulët	Faqe 40
2.6	Qarqet me barrën fiskale më të lartë	Faqe 41
3	Barra Fiskale në Kosovë 2018	Faqe 43
3.1	Barra e të hyrave komunale dhe rajonale	Faqe 43
3.2	Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacionit të buxhetit	Faqe 45
3.3	Rajonet me barrën fiskale më të lartë dhe më të ulët	Faqe 46
3.4	Krahasimi i barrës fiskale midis rajoneve të Shqipërisë dhe Kosovës	Faqe 46
4	Barra Fiskale në Ballkanin Perëndimor 2018	Faqe 47
4.1	Barra fiskale sipas taksave	Faqe 47
4.2	Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacioneve të buxhetit	Faqe 49
5	Liria Fiskale 2019	Faqe 52
	Indeksi i Lirisë Fiskale dhe Metodologjia	Faqe 53
5.1	Dita e Lirisë Fiskale në Ballkan	Faqe 53
5.2	Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri	Faqe 54
5.3	Dita e Lirisë Fiskale në Kosovë	Faqe 54
	Përmbledhje	Faqe 55
SHTOJCA	Regjimet fiskale dhe ndryshimet ligjore fiskale në 2018 në vendet e Ballkanit	Faqe 57
	Kutia 1. Llogaritja e barrës fiskale për Qarqet	Faqe 37

Hyrje

Zhvillimi i politikave fiskale në funksion të modeleve ekonomike dhe sociale është i varur në korrektësinë e politikës, si reflektim i ambjentit ekonomik dhe social. Në rajonin e Ballkanit, ashtu si në gjithë botën nevojitet që buxhetet e qeverive të mbështeten nga sisteme tatimore që promovojnë rritjen e të ardhurave për frymë nëpërmjet stimulimit të konkurrencës ekonomike.

Së pari, kjo arrihet duke miratuar një politikë që adreson situatën reale të rajonit, si dhe të secilit vend të tij. Si rrjedhojë, sistemet tatimore kanë nevojë të rakordojnë kapacitetet dhe teknologjinë me realitetet të tilla si: barra fiskale, rishpërndarja e saj dhe rikuperimi i barrës të taksapaguesit, sipas peshës dhe kontributit të tyre me investimet publike. Ky ekuacion duhet të bazohet mbi parimin e se çfarë merret duhet të kthehet si kompensim.

Së dyti, është e natyrshme se politika fiskale ka ndikim direkt në buxhet, nëpërmjet politikës tatimore, doganore, lokale dhe më gjerë në aspektin social. Nisur nga ky efekt, politika fiskale duhet të nxitë reagimin e ambjentit ekonomik, ku rritja e të ardhurave të buxhetit të stimulojë zhvillimin e aktivitetit të biznesit, si rrjedhojë të nxitë rritjen ekonomike, si mund të ndodhë edhe e kundërta.

Llogaritja, matja dhe prezantimi i barrës fiskale dhe si dhe paraqitja e Indeksit të Ditës së Lirisë Fiskale janë në edicionin e shtatë të shfaqjes së tyre për ambjentin ekonomik dhe politik shqiptar dhe më gjerë. Studimi fiskal i prezantuar mbi rezultatet e metodologjisë së përdorur nga ekspertët e Qendrës ALTAX për llogaritjen e Ditës së Lirisë Fiskale, 2019 është bërë një referim, që po synon të krijojë një model në ambientin ekonomik e politik shqiptar.

Matja e barrës fiskale tregon efektin, se si politika e mirë/keqe e taksave plotëson një nga qëllimet parësore, rritjen e të ardhurave duke ruajtur barazinë e tatimpaguesve në barrën që ata mbajnë. Nga ana tjetër politika duhet të synojë efektin që bie barazia lidhur me shpërndarjen e barrës që duhet të mbajnë tatimpaguesit sipas aftësisë për të paguar.

Nëpërmjet llogaritjes së barrës fiskale synojmë të analizojmë efektet e sistemit të taksimit në shpërndarjen e mirëqenies ekonomike në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Studimi është realizuar për të treguar nivelin e barrës fiskale për qarqet/rajonet shqiptare, duke komentuar për mundësitë që duhet të analizojnë politikën fiskale dhe administrimin në rritjen e të ardhurave nëpërmjet krahasimit me qarqe të ngjashme. Paraqitja e saj shihet

në funksion të financimit të shpenzimeve për investime lokale dhe qendrore dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve, pa harruar se politika fiskale nëpërmjet barrës vendos mbi rishpërndarjen e të ardhurave.

Nga ana tjetër, nisur nga fakti ku secili qytetar është kontributor në buxhetin e shtetit nëpërmjet pagimit të një takse në formë direkte apo indirekte, atëherë është me interes që secili të dije se sa është barra fiskale që mban në raport me qytetarët në qarqet e tjera shqiptare, Në Kosovë si dhe në vendet e tjera të Ballkanit.

Renditja e qarqeve/rajoneve brenda Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe shteteve brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor, sipas barrës fiskale jep mundësinë biznesit për të shqyrtuar efektshmërinë e politikave dhe nismave të qeverisë për zhvillimin ekonomik, si dhe mundet të ndikojë në momentin e analizës për alokimin e shpenzimeve publike në kuadër të transparencës së financave publike.

Kjo analizë, sipas zonave administrative shërben për të parë se kush grup apo zonë gjeografike është ngarkuar më shumë, dhe nga ana tjetër një analizë më e detajuar orienton politikën për të parë se cila industri apo zonë duhet të ketë një barrë të ndryshme nga ajo që rezulton.

Objekti i krahasimit të të dhënave janë të ardhurat e paguara për llogari të buxhetit të shtetit nga rezidentët dhe jo rezidentët. Fjalori i përdorur në këtë dokument i referohet termave të ligjit të procedurave tatimore. Tatimet dhe detyrimet doganore, që përfshihen në këtë analizë janë tatimet që administrohen nga administrata tatimore qendrore (përfshirë edhe kontributet e sigurimeve sociale), taksat dhe tarifatat që administrohen nga administratat tatimore vendore, si dhe detyrimet doganore sipas rajonit ku janë arkëtuar.

Rezultatet e këtij studimi janë të bazuara mbi të ardhurat e realizuara nga rezidentët sipas rezidencës ku ata janë, pa përfshirë edhe të ardhurat tatimore nga tatimpaguesit e mëdhenj të vendit (të përfshira sipas adresës së rezidencës), të cilët plotësojnë afër 50% të gjithë totalit të të ardhurave tatimore për të dy nivelet e administrimit tatimor.

Të dhënat statistikore për qarqet janë objekt i analizave, sipas krahasimit të të dhënave të programeve buxhetore, niveli i realizimit dhe burime të ndryshme.

Struktura e këtij dokumenti përbëhet nga kater pjesë. *Pjesa e parë* është prezantim i të dhënave statistikore në për Ballkanin Perëndimor. *Pjesa e dytë* është një analizim dhe komentim i renditjes së rajoneve në Shqipëri dhe Kosovë, sipas nivelit të barrës fiskale. Te *Pjesa e tretë* dhe e katërt sqarohen respektivisht metodologjia e llogaritjes së Indeksit të Lirisë Fiskale dhe prezantohet Kalendari i Ditës së Lirisë Fiskale së Ballkanit Perëndimor, dhe specifikisht të Shqipërisë dhe Kosovës bashkë me analizat sipas renditjes.

Burimi të dhënave

Të dhënat e përdorura për Shqipërinë i përkasin realizimit të treguesve buxhetorë paraprakë të vitit 2018 dhe në analiza të caktuara edhe të dhëna të viteve përpara. Të dhënat e përdorura për vendet e tjera i përkasin vitit 2015 - 2018. Ato janë marrë nga raporte të publikuara nga Fondi Monetar, Banka Botërore, Institute dhe qendra statistikore e studimore te vendeve anëtare të Bashkimit Europian, si dhe nga publikime zyrtare të financave të vendeve të Ballkanit.

Një vend të veçantë në të dhënat dhe informacionet e administruara dhe përpunuara janë raportet publike të miratuara nga këshillat e Bashkive të Shqipërisë, si dhe raporte të komunave të Republikës së Kosovës në dy vitet e fundit.

Prezantimi i të dhënave mbi Prodhimin e Brendshëm, pagimin e tatimeve dhe taksave janë bazuar mbi kryqëzimin e informacionit, që gjendet i publikuar në raportet e Fondit Monetar (*Country Reports*), dhe Trading Economics, te të cilët gjenden tabela, komente dhe projeksione për të dhënat makro për vitet e fundit përfshirë edhe vitin më të fundit 2018.

Për Shqipërinë, të dhënat për prodhimin e brendshëm rajonal janë marrë nga Ministria e Financave ne publikimet e borxhit publik, po ashtu edhe për Kosovën janë marrë nga publikimi i Agjensisë së Statistikave të Kosovës. Ndërsa të dhënat makro për tatimet dhe taksat e paguara janë nxjerrë nga përpunimi i statistikave dhe buletineve të Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe agjensive të të hyrave publike për të dy shtetet.

Barra fiskale në vitet 2014 - 2017

Treguesi i barrës fiskale i viteve 2014 – 2017, sipas edicioneve Nr. 3 – 6 të publikuara nga Qendra ALTAX, në këtë publikim të ri vjen i azhurnuar

Tab.1 Barra tatimore në Ballkan në vitet 2014 - 2017 në %

Nr.	SHTETI	BARRA TATIMORE			
		2014	2015	2016	2017
1 ↑	KOSOVË	23.9	25.1	26.3	26.2
2 ↑	SHQIPËRI	24.1	23.7	24.8	25.7
3 ↑	MAQEDONI E VERIUT	24.5	25.2	25.3	25.5
4 ↑	SERBI	35	34.6	35.1	36.1
5 ↑	BOSNJË-HERCEGOVINË	37.6	37.5	37	37.9
6 ↑	KROACI	36.3	36.9	37.6	38.6
7 ↓	MALI I ZI	39.1	36	36.1	36.5

Burimi: IMF, MoF

lidhur me barrën fiskale reale. Ndryshimet kanë marrë në konsideratë të dhëna të reja për treguesin e PBB-së dhe për taksat e paguara në buxhetin e shtetit. Treguesit e korigjuar të barrës fiskale paraqiten në Tab. 1. në krah dhe janë të dhëna që konfirmohen edhe sipas raporteve të Fondit Monetar.

Barra fiskale përgjatë viteve 2014 deri në 2017 ka patur një evolucion në rritje , përveç Malit të Zi, që ka patur një tendencë në ulje. Rritjen më të madhe të barrës fiskale e mban Kosova me 2.3% rritje ndaj PBB-së. Ndërsa Mali i Zi ka një ulje të barrës fiskale me 2.6% të PBB-së.

Barra mesatare e Ballkanit Perëndimor për 5 vitet së bashku është në nivelin 32% të PBB-së. Në vitet 2014-2016 barra fiskale ka qenë midis niveleve 31.3% deri në nivelin 31.7% të PBB-së. Në ecurinë e barrës fiskale tre shtete kanë ruajtur një nivel të barrës fiskale nën mesataren 5 vjeçare (32%). Ndërsa, katër shtete të tjera kanë mbajtur një nivel barre mbi këtë mesatare.

Rritja më e madhe është te tatimet direkte në ndryshim nga ato indirekte (Tab.2).

Tab.2 Peshë e barrës fiskale ndaj PBB në Ballkanin Perëndimor, 2014 - 2018 % PBB

	2014			2015			2016			2017			2018		
	DIREKTE	INDIREKTE	SIGURIME, TE TJERA	DIREKTE	INDIREKTE	SIGURIME, TE TJERA	DIREKTE	INDIREKTE	SIGURIME, TE TJERA	DIREKTE	INDIREKTE	SIGURIME, TE TJERA	DIREKTE	INDIREKTE	SIGURIME, TE TJERA
KOSOVË	3,4	17,4	3,1	3,4	18,5	3,2	3,9	19,6	2,8	3,7	19,6	2,9	4	20,5	2,3
SHQIPËRI	4,6	12,2	7,3	4,6	11,8	7,3	5,1	11,9	7,8	5,3	12,3	8,1	6,1	11,6	7,7
MAQEDONI E VERIUT	3,3	12,4	8,8	4,4	11,8	9	4,2	12,2	8,9	4,4	12,2	8,9	5,7	11,7	9,2
SERBI	7,8	15,9	11,3	7,6	16,1	10,9	7,5	15,9	11,7	7,5	16,7	11,9	8,5	16,7	12,8
BOSNJË-HERCEGOVINË	3,4	18,5	15,7	3,5	18,5	15,5	3,7	18,4	14,9	4,1	18,6	15,2	4,1	19,2	15,1
KROACI	5,7	16,40	14,20	5,5	17,1	14,3	5,6	17,5	14,5	5,7	18	14,9	9	18,5	12
MALI I ZI	8,4	18,9	11,8	7,9	17,2	10,9	8,1	17,3	10,7	5,8	19	11,7	6,2	20,4	11,8

Burimi: IMF, MoFE

Barra Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019 <>>><><><> Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor 2019

Përjashtim i tendencës shikohet vetëm në Malin e Zi, i cili ka rënie të peshës së tatimeve indirekte me të paktën 1% të PBB-së.

Kosova ka rritje të peshës së tatimeve direkte në 2016, por një rënie të tyre në 2017. Ndërkohë, tatimet indirekte mbas rritjes së vitit 2016, për arsye të rritjes së shkallës së TVSH-së mbajnë peshën kryesore në barrën fiskale.

Shqipëria ka një rritje të barrës së tatimeve direkte, si dhe të tatimeve indirekte dhe kontributeve e taksave të tjera.

Maqedonia e Veriut ka rritje të barrës së tatimeve direkte, si dhe tatimeve indirekte. Por, kontributet e sigurimeve dhe taksat e tjera janë pa ndryshuar për dy vitet e fundit në tabelë.

Serbia ka rritje vitin e fundit të barrës së tatimeve direkte, si dhe tatimeve indirekte dhe kontributeve.

Bosnjë-Hercegovina ka rritje të vogël të barrës së tatimeve direkte. Barra kryesore mbahet nga tatimet indirekte dhe kontributet dhe taksat e tjera.

Kroacia, i vetmi shtet anëtar i BE-së ka një barrë të tatimeve direkte, të ulët dhe që nuk ka ndryshuar, por ka një rritje të barrës së tatimeve indirekte dhe kontributeve të sigurimeve dhe taksave të tjera.

Mali i Zi ka një rritje të barrës së tatimeve direkte edhe pse aplikon prej vitesh shkallë tatimore të ulët. Barra e tatimeve indirekte është rritur, pas uljes në vitet 2015 – 2016. Kontributet dhe taksat e tjera kanë një rritje të barrës së tyre.

1. Ballkani Perëndimor, Ekonomia, Buxheti dhe Barra Fiskale, 2014-2018

Gjithë vendet e Ballkanit kanë mbështetur stabilizimin ekonomik dhe kanë vazhduar në rrugën e filluar më herët për të përfunduar modernizimin, që nxit rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia tani janë në pikën ku ata kanë një shans për të ndjekur këtë rrugë më shumë se vendet e tjera të Ballkanit perëndimor. Kjo do të kërkojë zgjerimin dhe thellimin e axhendës së reformës.

Në Shqipëri, ka disa arsye imediate për të ecur përpara me reformën fiskale. Financat publike sigurisht janë në një udhë që tregon për konsolidim të tyre.

Por, borxhi publik mbetet i lartë. Nevojitet një përpjekje e fortë e qeverisë për të krijuar një hapësirë të nevojshme për shpenzimet në fusha kyçe, si infrastruktura, shëndetësia dhe arsimiti. Vonesa në vijimësinë e reformës së energjisë mund të vendosi përsëri stabilitetin e buxhetit në rrezik.

Tab. 3. RITJIA E PRODHIMIT TË BRENDSHËM, 2015-2018 në %

SHTETI	2015	2016	2017	2018*
SHQIPËRI	2.2	3.4	3.8	4.1
BOSNJË - HERCEGOVINË	3.1	3.2	3.2	3
MAQEDONI E VERIUT	3.9	2.8	0.2	2.7
KOSOVË	4.1	4.4	4.2	4.2
MALI I ZI	3.4	2.9	4.7	4.4
SERBIA	2.7	3.3	2	4.2
KROACI	2.4	3.5	2.9	2.7
BALLKANI PERËNDIMOR	3.2	3.3	3.0	3.8

Burimi: IMF, WB

* Vlerësim

Rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor ka ecur drejt forcimit të saj duke arritur një vlerësim mesatar për vitin 2018 në rreth 3.6 për qind. Në pjesën më të madhe të rajonit, parashikimet e rritjes për 2019 janë vlerësuar se do të jenë më të larta se viti paraardhës.

Reformimet e sistemeve tatimore dhe rritjet e disa sektorëve kanë krijuar hapësira fiskale për buxhetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor, të cilën disa vende nxituan ta përdornin për shpenzimet aktuale dhe investime infrastrukturore.

1.1. Ballkani Perëndimor dhe panorama makroekonomike në 2018

Prodhimi i Brendshëm në BP ka patur një ecuri me ulje – ngritje. Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Kosova kanë një rritje pozitive më të lartë se vendet e tjera të BP-së. Rritja ekonomike e BP-së ka patur ulje vetëm në Bosnjë-Hercegovinë. Ekonomia e rritur në shumicën e vendeve të BP-së është mbështetur nga investimet publike dhe të huaja, si dhe nga një rritje e konsumit.

Konsumi edhe pse me luhajtje në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kosovë është rikthyer me rritje në shumicën e shteteve. Kosova, Kroacia dhe Shqipëria kanë një nivel konsumi mbi mesataren e konsumit të Ballkanit Perëndimor.

Në ballafaqimin e rritjes ekonomike të BP-së¹ me rritjen ekonomike të Kroacisë, (që është vend anëtar i BE-së) duket se tendenca e rritjes ekonomike në këto shtete (përveç Maqedonisë së Veriut) është pak më e lartë se rritja ekonomike e Kroacisë.

Megjithatë kjo tendencë rritje është e pamjaftueshme për të shërbyer si një shtytje e duhur për të mbyllur në një periudhë afatmesme boshllëkun e mirëqenies dhe standardeve të jetesës midis rajonit dhe BE.

Tab.4. KONSUMI GJITHSEJ NDAJ PBB, 2015-2018 në %

SHTETI	2015	2016	2017	2018*
SHQIPËRI	0.8	2.7	2.6	3.1
BOSNJË - HERCEGOVINË	2.5	2.8	3	2.8
MAQEDONI E VERIUT	4.3	2.1	0.1	2.5
KOSOVË	4.7	4.7	1.5	5.6
MALI I ZI	2.5	5.1	1.1	0.8
SERBIA	0.1	1.2	2.2	3
KROACI	0.5	2.7	3.4	4.1
BALLKANI PERËNDIMOR	2.5	3.1	1.8	3.0

Burimi: IMF, MF

* Vlerësim

Në vitin 2018, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Kosovës sipas metodës Atlas të Bankës Botërore, u klasifikuan si vende me të ardhura të nivelit të sipërm të grupit me të ardhura të mesme. Kategoria e vendeve me të ardhura të nivelit të sipërm përfshin vendet me të ardhura kombëtare bruto (AKB) për frymë

¹ Përfshihen Shqipëria, Serbia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina

ndërmjet 3,956 \$ dhe 12,235 \$². Megjithatë, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë në fund të këtij grupi të ardhurash, pra midis 4.250 \$ në Shqipëri dhe 5.990 \$ në Serbi. Edhe Mali i Zi me AKB-në më të lartë të rajonit për frymë (7,810 \$), regjistroi përafërsisht vetëm një të pestën e të ardhurave për frymë në BE. Kosova, vendi më i varfër i rajonit me të ardhura për frymë prej 3,850 \$, i përket nivelit të poshtëm të grupit me të ardhurave mesatare.

Në pamje të parë, importet dhe eksportet e vendeve të Ballkanit Perëndimor duket se përfaqësojnë vlera të larta të PBB-së. Megjithatë, një vëzhgim i tillë nuk paraqet gjithë panoramën e tregtisë.

Përqindjet e larta të eksporteve dhe importeve në raport me PBB-në janë një fenomen natyror në ekonomitë e vogla. Në krahasim me ekonomitë ballkanike dhe ato të Europës Lindore që ju bashkuan BE-së në vitet 2007 – 2013 (Sllovenia, Kroacia, Sllovakia, Polonia, Estonia dhe Çekia) dallimet, sidomos në pjesën e eksportit janë të dukshme. Edhe nëse hendeku është zvogëluar në dekadën e fundit, ekziston ende një rrugë e gjatë për të arritur në përqafrim me këto vende referuese, sidomos për Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën.

Në disa vite të dekadës së fundit, importet dhe eksportet në raport me PBB-në në Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri kanë qenë të paqëndrueshme. Krahasimi mes importeve dhe eksporteve në Ballkanin Perëndimor tregon një deficit të madh tregtar, të cilat janë kompensuar në ekonomi nga efektet e remitancave dhe faktorët pozitivë të balancës së të ardhurave³. Produktet kryesore me të cilat konkurojnë në BE disa shtete të BP-së janë konfeksionet (këpucë dhe tekstile) si dhe energjia elektrike dhe mineralet.

Niveli i inflacionit ka ecur sipas targeteve të parashikuara të Bankave Qendrore vetëm në Shqipëri dhe Serbi. Shqipëria gjatë këtyre viteve ka regjistruar inflacionin më të ulët, por dhe më të qëndrueshëm në rajon. Bosnjë – Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi përjetuan paqëndrueshmëri të konsiderueshme të presionit inflacionist. Në një nivel më të vogël, ky presion ishte i pranishëm edhe në Maqedoni. Kjo do të thotë që ekonomitë e vogla të hapura ndaj tregut global,

të cilat kanë hequr dorë nga sovraniteti i tyre monetar, përjetojnë më shumë inflacion të paqëndrueshëm për shkak të karakterit të tij ekzogjen, të nxitur nga tronditjet reale dhe financiare ndaj tregjeve të jashtme dhe ndryshimeve në kurset e këmbimit midis monedhave kryesore. Sidoqoftë, është e drejtë të thuhet që nga 2014- 2018, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë në gjendje të konvergojnë në nivele më të larta të inflacionit.

Regjimet monetare mund të kenë rëndësi për stabilitetin financiar. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht regjimeve të tyre të deklaruara dhe aktuale monetare, janë tepër të euroizuara. Ky nuk është një problem vetëm në Kosovë dhe Mal të Zi, ku euro është tashmë prej vitesh një monedhë zyrtare kombëtare, por është një dobësi serioze edhe në vende të tjera të Ballkanit. Strategjitë për de-euroizim po punojnë të nxisin kreditime në monedha vendase, të cilat zvogëlojnë rrishtun për huamarrësit e pambrojtur. Pas disa përpjekjeve për të ulur kreditimin në monedhë të huaj, në janar 2018 Banka e Shqipërisë lançoi një fushatë gjithëpërfshirëse me një strategji për uljen e përdorimit të valutës së huaj. Progresi në de-euroizimin gjithsesi ka qenë gradual. Kreditë e papaguara në monedhat e huaja ende variojnë nga 45 përqind e totalit të kredive në Maqedoninë e Veriut e deri në mbi 60 përqind në Serbi apo 50 përqind në Shqipëri.

Fqinjët Ballkanit Perëndimor janë vendet e BE-së dhe partnerët dominues tregtarë të çdo vendi me 70 përqind të tregtisë së tyre totale. Për eksportet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, kjo dominancë është edhe më e fortë. Tashmë rajoni është integruar me shumë me vendet e BE në terma tregtarë edhe pse ato kanë rënie në krahasohen me një dekadë më parë.

Shqipëria ka qenë vendi me performancën më të mirë përse lidhet me indeksin e punësimit, me një normë mesatare papunësie të barabartë me rreth 12.3 përqind të fuqisë punëtore në fund të tremujorit IV të 2018.

Megjithatë është e dukshme që arsimimi më i mirë nuk ka rritur gjasat për të rritur punësimin në Ballkanin Perëndimor (ndryshe nga sa ndodh p.sh. në Gjermani, ku arsimimi mbetet një pikë referimi), përveç një rënie të nivelit të papunësisë veçanërisht në Kosovë dhe Bosnjë – Hercegovinë për individët me arsim të lartë dhe post universitarë. Në Shqipëri, shkalla e papunësisë e forcës për punë me arsim bazë

² Raporti “Doing Business 2019”

³ specifikisht në Mal të Zi, ato kanë qenë të financuara nga investimet e huaja direkte dhe subvencionet e buxhetit

është sistematikisht më e ulët se sa shkalla e papunësisë për forcat e punës me arsim të mesëm dhe të lartë.

Këto gjetje mund të sugjerojnë një rol thelbësor për tregun joformal të punës (pavarësisht nivelit të arsimimit) dhe një mospërputhje midis profilit të arsimimit, cilësisë dhe kërkesës aktuale për punë.

Ndërkohë, disa veçori që janë të rëndësishme për Ballkanin Perëndimor, por veçanërisht për dy shtetet shqiptare përmbledhen në këta faktorë:

Një ngadalësim në ekonominë e BE-së dhe sidomos ngadalësimi i ekonomisë së aktorëve kryesorë tregtarë me Shqipërinë, si: Italia, Turqia dhe Greqia mund të ulin objektivin e eksportit të mallrave shqiptare për 2019 dhe më tej. Edhe pse kjo situatë tranzitore për një rritje më të ulët ekonomike është bërë i njohur, ekziston rreziku që ngadalësimi i ekonomisë në Itali dhe Turqi mund të jetë më i avashte se sa pritej.

Nga ana tjetër, nëse stimuli i ri në vendet e BE është efektiv, ai synon aktivitete relativisht më pak intensive dhe jo në funksion të rritjes së investimeve jashtë BE-së. Kështu që, pjesa tjetër e Ballkanit mund të ndjejë e para një ngadalësim të rritjes ekonomike, për sa kohë partnerët nuk janë në pozitat që mendohej të ishin. Kështu, Gjermania ka disa vështirësi në sektorin e automobilëve dhe kërkesa prej tregut të eksportit është më e ulët. Ky fakt i ri do të ndikojë në rritjen e saj ekonomik të vitit 2019. Për Italinë, rrisqet e borxhit publik po shkojnë drejt rritjes. Në përgjithësi, parashikimi i rritjes për vitin 2019 në Eurozonë është 1.6 përqind, me një reduktim prej 0.3 përqind krahasuar me parashikimin e bërë vetëm pak muaj më parë.

Shumë nga sfidat me të cilat ballafaqohen vendet e BP-së kalojnë kufijtë kombëtarë dhe kërkojnë përgjigje të koordinuara. Disa vende në Ballkanin Perëndimor nuk kanë bërë progres të mjaftueshëm gjatë vitit 2018 në uljen e deficiteve dhe vendosjen e borxheve të tyre në një tendencë rënieje. Reduktimi i riskut në nivel kombëtar është më të vërtetë i nevojshëm për parashikueshmërinë e riskut rajonal bazuar te realiteti, se të gjitha vendet së bashku ndërveprojnë nga njeri vend në tjetrin dhe ndikojnë në zbatueshmërinë dhe efektivitetin ekonomik e fiskal të secilit vend.

Rritja e barrierave tregtare. Lëvizja e fundit nga qeveria e Kosovës rreth pengesave tregtare

mund të ndikojë nga 0.2-0.5 përqind të rritjes ekonomike të Shqipërisë, meqë zinxhirët e furnizimit përkeqësohen dhe mjedisi për investime bëhet më i pasigurt për arsye të acarimit të marëdhënieve politike rajonale. Kjo situatë, edhe pse duket për Shqipërinë si një mundësi e mirë për të rritur eksportet, në fakt nuk është e lehtë të realizohet në praktikën tregtare.

Problemi më kryesor për të zëvendësuar partnerët tregtarë serbo-boshnjakë janë barrierat tarifore dhe jotarifore, si dhe logjistika për të arritur deri në tregun konsumator kosovar. Ky realitet duket edhe nga statistikat e tregtisë me jashtë për Shqipërinë që nga statistikat zyrtare, por edhe konfirmimet e eksportuesve shqiptarë nuk rezultojnë të ketë një mbushje të boshllëkut tregtar të shkaktuar nga taksimi me 100% për mallrat serbo-boshnjake.

Ndërkaq, Shqipëria në dy-tre vitet e fundit ka një trend rritjeje të bilancit tregtar me Serbinë. Kështu, shkëmbimet tregtare me Serbinë në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor zënë 34 % të totalit. Kjo marëdhënie e vështirë mes tre shteteve të Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Serbi, Bosnjë), e cila është krijuar pas aplikimit të taksës së jashtëzakonshme prej qeverisë së Kosovës (edhe pse ka natyrë politike) do të rrisë mundësinë për bashkëpunim tregtar midis Serbisë-Malit të Zi dhe Maqedonisë Veriore duke e kthyer de facto në një zinxhir të ri të ardhshëm të qarkullimit të mallrave i devijuar nga një lëvizje politike, por që pritet të ketë efekt domino në rajon.

Nisur nga kjo situatë, ekonomia shqiptare do të kalojë nëpër sfida ekonomike që do i dalin përpara. Kjo situatë e ndryshuar, që ka gjasa të zgjasë më shumë se disa muaj do të kërkojë nga udhëheqësit shqiptarë të kenë një ndjenjë të qartë drejtimi dhe vullnet të qëndrueshëm, por dhe vendimtar për produktivitetin e ardhshëm ekonomik duke marrë në konsideratë rrethanat e krijuara. Mjedisi aktual ende ofron mundësi për të avancuar me politikën dhe reformat për të ndërtuar skenarë fiskalë dhe financiarë për rritje të qëndrueshme, të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse. Ndërkohë, gjithë liderët shqiptarë duhet të përfitojnë nga ky moment, pavarësisht pozicionimit aktual në raport me fqinjët e tyre dhe ekonominë.


Reformat strukturore janë problem shumë serioz për ekonominë për të rritur kursimet, investimet

dhe produktivitetin. Të gjitha këto elemente bazë të ekonomisë janë thelbësore për të rritur standardet e jetesës duke ndihmuar në rritjen ekonomike në mënyrë cilësore, duke reduktuar dobësitë ekzistuese dhe rrisqet e jashtme. Hapat kryesorë në këtë drejtim duhet të përfshijnë akses më të shpejtë dhe më të lehtësuar në tregun e punës, thjeshtim të rregullave dhe përmirësim të efikasitetit të proceseve gjyqësore për të drejtën tregtare. Këto reforma mund të synojnë në një mënyrë që mbrojnë më të varfrit në shoqëri dhe të zvogëlojnë pabarazinë, e cila në vitet e fundit është rritur në Shqipëri, Kosovë dhe vendet e tjera.

Një afat kohor nevojitet për përshtatjen e ekonomisë dhe jetës lidhur me teknologjinë e

1.2. Taksat dhe shpenzimet buxhetore në Ballkanin Perëndimor, 2014-2018

Ballkani Perëndimor karakterizohet nga një balancë buxhetore me deficite apo suficite buxhetore, që tregojnë për forcimin e disiplinës fiskale, por edhe për një menaxhim më të kujdesshëm të shpenzimeve buxhetore.




Produktiviteti efektiv i menaxhimit fiskal dhe buxhetor shikohet në 2-3 vitet e fundit fiskale (2016-2018) në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi. Sipas grafikut, në të tre shtetet vërehen surplus që rezultojnë nga pakësimi i shpenzimeve buxhetore dhe rritja e të ardhurave buxhetore. Në fund të vitit 2018 i krahasuar me 2014, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia shënojnë një ulje të shpenzimeve buxhetore me -8% dhe Kroacia me -2%. Ndërsa, të ardhurat buxhetore për të njëjtën periudhë krahasimi tregojnë rritje në Kroaci, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë, respektivisht me 12%, 9% dhe 1%.

Shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor edhe pse kanë pasur balanca primare pozitive duket se kanë një produktivitet më pak efektiv të menaxhimit fiskal dhe buxhetor.


ardhshme. Të gjitha vendet po kalojnë një periudhë të shpejtë ndryshimi teknologjik, i cili do të riformësojë mënyrën se si jetojmë dhe punojmë. Këto ndryshime nuk mund të shpërfillen dhe është e rëndësishme që shqiptarët të përgatiten, duke filluar nga kuadri rregullator dhe infrastruktura, të cilat do t' i ndihmojnë konsumatorët dhe ekonominë të jenë me fitime më të larta nëpërmjet uljes së kostos, por dhe konkurrese me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Zhvillimi i një sistemi arsimor, i ngjashëm me sistemin zinxhir të qarkullimit të mallrave do të vlejë shumë për të përshtatur nevojat e fuqisë punëtore me kërkesat e tregut të punës në të ardhmen e afërt.

Në harkun kohor 2014-2018, Kosova dhe Mali i Zi kanë një rritje të nivelit të shpenzimeve buxhetore me 17% dhe 15%, ndërsa Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut me 5% dhe 4%.


Për të njëjtën periudhë kohore 2014-2018, rritjes së shpenzimeve në Kosovë dhe Malin e Zi i korrespondon një rritje të ardhurash buxhetore, respektivisht me 13% dhe 4%. Ndërsa, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë rritje të ardhurash buxhetore, respektivisht me 5% dhe 9%.



Sipas grafikut më lart, shtetet që kanë surplus të buxhetit kanë diferencën më të madhe midis vlerave skajore, që tregon se politika e konsolidimit fiskal është shoqëruar edhe me një politikë kufizimi për shpenzimet buxhetore. Tre shtetet me surplus (Bosnja, Kroacia dhe Serbia)



shikohet të kenë ulur shpenzimet sociale më shumë nga gjithë shtetet e tjera të rajonit, respektivisht me -10%, -15% dhe -5%. Nga ana tjetër, ato kanë rritur (Serbia dhe Kroacia), apo e kanë barrën fiskale të lartë (rasti i Bosnjë-Hercegovinës, shih pikën 1.3. më poshtë) për taksat mbi punën (të ardhurat sociale) ⁴. Nisur nga kjo politikë, e cila plotëson me efektivitet boshllëkun midis shpenzimeve dhe arkëtimeve



lidhur me zëra me peshë në buxhet mund të kuptohet logjika e politikës që duhet të zbatohet për të arritur produktivitet të lartë buxhetor.

Nëse krahasojmë tendencën përgjatë 2014 – 2018 për shpenzimet kapitale me taksat mbi kapitalin, siç shihet në grafikun në vijim vërehet se shtetet që kanë rritur investimet kapitale nuk kanë rritur domosdoshmërisht arkëtimet nga taksat mbi kapitalin, pasi kanë shfrytëzuar për këto investime të ardhura nga taksa të tjera duke mos synuar të rëndojnë investitorët me taksa të larta për investimet e tyre.


Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut, që kanë arkëtime në rritje nga taksat mbi kapitalin për periudhën 2014-2018 (+12%, +15%, +67%) nga ana tjetër kanë pakësime apo vlera minimale rritje të shpenzimeve kapitale (-17%, 2%, -24%).

Rasti i Shqipërisë duket se është në një rast përputhje dhe ekuilibri midis rritjes së barrës së taksave mbi kapitalin me rritjen e shpenzimeve kapitale (+10%), përfshirë edhe investimet e huaja.

Për të patur një perceptim më të plotë të përdorimit me efektivitet të shpenzimeve buxhetore marrim në shqyrtim edhe tendencën e shpenzimeve për personelin që paguhet nga të ardhurat e buxhetit.

⁴ kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi pagat

Shpenzimet për personelin e shtetit, 2014-2018



Shpenzimet më të ulëta në raport me PBB-në gjenden në buxhetet e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, në nivelet mesatare sa 4.8% dhe 4.3% e PBB-së. Ndërsa, nëse vijojmë më tej me këtë kërkim shikohet se Kosova dhe Serbia kanë shpenzuar për punonjësit buxhetorë në nivelet e 8.8% dhe 9.3% të PBB-së.


Kroacia (11.7% e PBB), Bosnjë-Hercegovina (11.5% e PBB) dhe Mali i Zi (11.1% e PBB) janë shpenzues në nivele më shumë se dy herë më lartë në raport me shpenzimet për administratën në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut.

Ky tregues paraqitet me këto nivele pasi lidhet me nivelin e pagës që për të tre shtetet me nivel të lartë shpenzimesh administrative mbajnë edhe tre vendet e para për nivelin e pagave të larta në raport me shtetet e tjera.

1.3. Barra Fiskale dhe specifikat në Ballkanin Perëndimor, 2014 – 2018

Barra fiskale në vendet e BP-së është treguesi real i asaj çfarë merr buxheti nga qytetarët e vet në respekt të kthimit të tyre në të mira dhe shërbime publike. Në Ballkanin Perëndimor, BF-ja ka qenë me rritje në këto 5 vitet e fundit, përveç Malit të Zi, i cili është me ulje.

Barra Fiskale në Ballkanin Perëndimor, 2014 - 2018 (% e PBB)



Shqipëria ka barrën fiskale më të ulët në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor. Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Kroacia kanë pagesa fiskale në buxhet në nivele mbi 10 pikë përqind se tre vendet e tjera të BP-së.

Në krahasimin e barrës fiskale në Ballkan në vitet 2014-2018 shikohet se vendet me barrë të mesme fiskale (Maqedoni, Shqipëri, Kosovë) kanë tendencë të rritjes së saj në vite, edhe pse me ritëm të ngadaltë dhe me ulje-ngritje nëpër vite.

Barra fiskale ende e ulët është e ndikuar kryesisht nga politikat lehtësuese në legjislacionet fiskale, ku përfshihen norma tatimore me ulje edhe pse nuk është zbrapsur ende informaliteti. Por, ndikimin më të lartë në barrën e ulët e ka kapacitetet dhe niveli i ulët i administrimit, që krijon një boshllëk midis nivelit të llogaritur nga buxheti për tu mbledhur dhe arkëtimeve faktike nga administratat fiskale.

Normat tatimore mbi kapitalin, të ardhurat dhe pagat (Tab.5) për vitet 2014 - 2018 nuk kanë pësuar ndryshime, përveç Kroacisë, e cila ka ulur normat tatimore mbi kapitalin dhe tatimin mbi pagën. Në zbatim edhe të rekomandimeve të gjithë institucioneve monitoruese ndërkombëtare kanë prezantuar një stabilitet të politikës së normave tatimore.

Tab. 5 NORMAT TATIMORE PER TATIMIN MBI PAGAT DHE TATIMIN MBI FITIMIN, 2009-2018

SHTETET	2014	2015	2016	2017	2018	TATIMI
SHQIPËRI	13,23	13,23	13,23	13,23	13,23	TAP
	15	15	15	15	5,15	TF
KOSOVË	10	10	10	10	10	TAP
	10	10	10	10	10	TF
BOSNJË-HERCEGOVINË	10	10	10	10	10	TAP
	10	10	10	10	10	TF
KROACI	40	40	40	36	36	TAP
	20	20	20	20	18	TF
MAQEDONI E VERIUT	10	10	10	10	10	TAP
	10	10	10	10	10	TF
MALI I ZI	9	9	9	9	9	TAP
	9	9	9	9	9	TF
SERBI	15	15	15	15	15	TAP
	15	15	15	15	15	TF

Burimi: KPMG, MFE

Barra fiskale në vitin 2018 në Ballkanin Perëndimor është sa 32.1% e PBB-së në Ballkan. Nëse krahasohet me nivelin e PBB-së në BE ka një diferencë me 10.1 pikë përqind.

Kur i analizojmë këto norma tatimore (Tab.5), si tregues të barrës fiskale sipas këndvështrimit të të ardhurave fiskale që kanë hyrë në buxhetin e

Tab.6 Barra e tatimeve direkte ndaj PBB në Ballkanin Perëndimor, 2014 - 2018

	2014					Ndryshimi 2018/2014
	DIREKTE	DIREKTE	DIREKTE	DIREKTE	DIREKTE	
KOSOVË	3.4	3.4	3.9	3.7	4	18%
SHQIPËRI	4.6	4.6	5.1	5.3	6.1	33%
MAQEDONI E VERIUT	3.3	4.4	4.2	4.4	5.7	73%
SERBI	7.8	7.6	7.5	7.5	8.5	9%
BOSNJË-HERCEGOVINË	3.3	3.5	3.7	4.1	4.1	24%
KROACI	5.7	5.5	5.6	5.7	9.1	60%
MALI I ZI	8.4	7.9	8.1	5.8	6.2	-26%

Burimi: IMF, MoFE

secilit vend të BP-së (Tab.6), vërehet se normat e ulëta për tatimet direkte nuk kanë ndikuar në uljen e barrës fiskale, por përkundrazi barra fiskale ka ardhur në rritje. Kjo tregon se administrimi dhe lufta ndaj informalitetit bëjnë

ndryshimin dhe janë dominues ndaj politikës fiskale.

Tab.7 Barra e TVSH ndaj PBB në Ballkanin Perëndimor, 2014 - 2018

SHTETI	TATIMI VLERES SE SHTUAR					NDRYSHIMI 2018/2014
	2014	2015	2016	2017	2018	
KOSOVË*	12.4	12.8	19.6	19.6	20.5	65%
SHQIPËRI	8.9	8.7	8.7	9	8.8	-1%
MAQEDONI E VERIUT	7.4	7.5	7.7	7.8	7.7	4%
SERBI	10.5	10.3	10	10.1	10.6	1%
BOSNJË-HERCEGOVINË*	18.5	18.5	18.4	18.6	19.2	4%
KROACI	12.4	12.8	13	13.3	13.8	11%
MALI I ZI	14.4	12.5	12.7	13.6	14.7	2%

Burimi: IMF, MoFE

* Barra përfshin TVSH dhe akcizë

Barra e Tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) e krahasuar me normat e TVSH (akciza takson një kategori specifike mallrash) përsëri, ashtu si në rastin e tatimit mbi fitimin dhe pagës evidenton problemin që ka më së shumti administrimi fiskal, se sa politika fiskale.

Tab.8 NORMAT* PER TATIMIN E VLERES SE SHTUAR, 2014-2018

SHTETI	2014	2015	2016	2017	2018	në %
SHQIPËRI	10,20	20	20	6,20	6,20	
KOSOVË	16	8,18**	8,18	8,18	8,18	
BOSNJË-HERCEGOVINË	17	17	17	17	17	
KROACI	5,13,25	5,13,25	5,13,25	5,13,25	5,13,25	
MAQEDONI E VERIUT	5,18	5,18	5,18	5,18	5,18	
MALI I ZI	7,19	7,19	7,19	7,19	7,21	
SERBI	10,20	10,20	10,20	10,20	10,20	

Burimi: KPMG, MFE

* Normat e TVSH paraqiten me nivelin e reduktuar dhe nivelin standard

** Aplikimi prej Shtator 2015

E gjithë barra e TVSH nuk ka tendencë që përkon me normën e TVSH. Në rastet kur Norma e TVSH është mbi 18% (Shqipëri, Kroaci, Mali i Zi dhe Serbi) barra fiskale më e lartë nuk ndodhet në Shqipëri, por në Malin e Zi.

Shqipëria me normën më të lartë të TVSH ka barrën më të ulët pas Maqedonisë së Veriut. Politika fiskale në këtë rast duket se ka nevojë të përqaset më nga afër me modelimin e taksimit, pasi produktiviteti i saj është ndjeshëm ulët.

Tab.9 NORMAT PER KONTRIBUTET E SIGURIMEVE, 2014-2018

SHTETI	2014	2015	2016	2017	2018	në %
SHQIPËRI	27.9	27.9	27.9	27.9	27.9	
KOSOVË	10	10	10	10	10	
BOSNJË-HERCEGOVINË	41.5	41.5	41.5	42	42	
KROACI	35.2	37.2	37.2	37.2	37.2	
MAQEDONI E VERIUT	27	27	27	27	27	
MALI I ZI	33.3	33.3	34.3	34.3	34.3	
SERBI	36.25	37.8	37.8	37.8	37.8	

Burimi: KPMG, MFE

Normat e Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kanë patur stabilitet. Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi kanë rritur normat e taksimit në dy-tre vitet e fundit me 0.5 deri 1 pikë përqind. Barrën më të lartë të normave të taksimit e mban Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia. Barrën më të ulët të normave e mban Kosova dhe Maqedonia

e Veriut. Megjithatë edhe Shqipëria është vetëm 0.9 përqind më lart se Maqedonia e Veriut (Tab.9).

Tab.10 Barra e Sigurimeve Shoqërore ndaj PBB në Ballkanin Perëndimor, 2014 - 2018

SHTETI	Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore					NDRYSHIMI 2018/2014
	2014	2015	2016	2017	2018	
KOSOVË	3,1	3,2	2,8	2,9	2,3	-26%
SHQIPËRI	7,3	7,3	7,8	8,1	7,7	5%
MAQEDONIA E VERIUT	8,8	9	8,9	8,9	9,2	5%
SERBI	11,3	10,9	11,7	11,9	12,8	13%
BOSNJË-HERCEGOVINË	15,7	15,5	14,9	15,2	15,1	-4%
KROACI	14,2	14,3	14,5	14,9	12	-15%
MALI I ZI	11,8	10,9	10,7	11,7	11,8	0%

Burimë: IMF, MoFE

Barra reale e sigurimeve është më e lartë në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi dhe Kroaci (Tab.10). Ndërsa, qytetarët në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri mbajnë barrë reale më të ulët, nisur nga pagesat që kanë bërë në buxhet në këto 5 vitet e fundit.

Por, kur krahasojmë barrën e punës ku përfshihen taksimi mbi pagën dhe pagesat e kontributeve rritja e barrës së kontributeve varion në nivelet e 2-2.6 për qind për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Bosnjë - Hercegovinën. Ndërsa, në Kroaci, Serbi dhe Malin e Zi, barrës së kontributeve i shtohet një barrë

taksimi ndaj pagës sa 3.2 deri 4.3 përqind të PBB-së.

Nisur nga kjo llogaritje e përbashkët e dy pagesave që përbëjnë barrën e taksimit të punës, duket se barra fiskale ndaj punës është midis 4.5 përqind (Kosova) deri në 17.5 përqind (Bosnjë-Hercegovina).

Në vendet e BE-së barra e taksimit të punës është 44.5% në vitin 2018 me një ulje prej 1.5% nga 4 vite më parë. Edhe pse me ulje barra fiskale ndaj punës në vendet e BE-së është mbi dy herë më e madhe se në vendet e Ballkanit Perëndimor.


Nëse krahasohen normat tatimore midis vendeve të BP-së që aplikojnë një taksim me shkallë progresive mbi punën (Kroaci, Shqipëri) me vendet që aplikojnë një taksim me një shkallë tatimore (Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova, Serbia, Bosnjë-Hercegovina) ka një boshllëk të dukshëm midis tyre lidhur me barrën që është paguar për buxhetin.

Barra e taksimit progresiv nisur nga efektiviteti i saj garanton më shumë të ardhura në buxhet në raport me barrën që garanton taksimi i sheshtë.

1.4. Struktura e tatimeve dhe taksave në Ballkanin Perëndimor 2014- 2018


Pesha kryesore e të ardhurave të buxhetit në vendet e Ballkanit Perëndimor mbahet nga tatimet mbi konsumin⁵, si shihet edhe në grafikun në krah, si dhe më të detajuara janë edhe në Tabelën 11 te Shtojca.

Në analizën e përbërësve të barrës fiskale, pesha e **tatimeve mbi konsumin** (indirekte) ndaj tatimeve, taksave dhe sigurimeve të paguara gjithsej është mesatarisht në nivelin 52%. Pesha mesatare e tatimeve mbi konsumin ka ardhur në rënie në 5 vitet e fundit me 1%.



Peshën mesatare më të madhe në këtë grup e mban Kosova me 74% të totalit të të ardhurave fiskale. Peshën mesatare më të ulët e mbajnë Serbia dhe Kroacia, respektivisht me 45% dhe 46% të totalit të të ardhurave fiskale. Shqipëria, dhe Maqedonia e Veriut e kanë ulur peshën e barrës së tatimeve indirekte me 1% deri 4% në harkun kohor të 5 viteve të fundit. Ndërsa, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina e kanë rritur peshën e barrës së tatimeve indirekte me 2% në fund të 2018 krahasuar me 2014.


Pesha e **tatimeve mbi kapitalin dhe të ardhurat personale** (direkte) ndaj tatimeve, taksave dhe sigurimeve të paguara gjithsej është mesatarisht



⁵ Tatimet Indirekte (TVSH, Akciza)

në nivelin 17%. Peshë mesatare e tatimeve mbi kapitalin dhe të ardhurat personale ka ardhur në rritje në 5 vitet e fundit me 2%.

Peshën mesatare më të madhe në këtë grup e mban Serbia, Shqipëria dhe Mali i Zi me një peshë sa 1/5 e barrës fiskale gjithsej, respektivisht në vendet tyre. Peshën më të ulët e mbajnë Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia, të cilëve barra e tatimeve direkte zë më pak se 20% të barrës fiskale gjithsej, respektivisht në vendet e tyre.




Nga krahasimi midis vitit 2018 me 2014 Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Shqipëria kanë shënuar rritje të peshës së tatimeve direkte respektivisht me +8%, +7% dhe +5%. Maqedonia në vitin 2018 ka arritur një nivel 21% në raport me barrën fiskale gjithsej, Kroacia ka arritur një nivel 23%, ndërsa Shqipëria një nivel 24%.

Peshë e **kontributeve të sigurimeve dhe taksave të tjera** (Sigurimet) ndaj tatimeve, taksave dhe sigurimeve të paguara gjithsej është mesatarisht në nivelin 31%. Peshë mesatare e **këtij grupi** ka ardhur në rënie në 5 vitet e fundit me 2%. Peshën mesatare më të madhe në këtë grup e mban Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia, respektivisht me 41%, 37% dhe 35% të totalit të të ardhurave fiskale. Peshën mesatare më të ulët e mban Kosova me 11% të totalit të të ardhurave fiskale.

1.5. Barra fiskale në shtetet me taksim progresiv dhe ato me taksim të sheshtë.


Të ardhurat fiskale të arkëtuara nga shtetet që aplikojnë taksimin progresiv (Shqipëria dhe Kroacia) të krahasuara me shtetet që zbatojnë taksimin e sheshtë (Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Bosnjë-Hercegovina) shikohet se ka një barrë më të lartë me 2% të PBB-së. Modeli i taksimit për të ardhurat mbi kapitalin dhe ato personale shikohet se ka ndikim edhe në barrën e kontributeve të sigurimeve, nëse i referohemi grafikut më poshtë.

TATIMET DIREKTE - TAKSIMI PROGRESIV VS. TAKSIMI I SHESHTË, MESATARJA 5-VJEÇARE



Shtetet që zbatojnë taksimin progresiv kanë barrë të kontributeve mesatarisht për 5-vjetëshin 2014-2018 më të lartë se shtetet që zbatojnë taksimin e sheshtë me 4% më shumë. Pra, midis dy modeleve ka një boshllëk tatimi me nivelin 4%.


Ndërsa, kur krahasojmë normat tatimore mesatare progresive me ato të sheshta hendeu midis tyre është me një diferencë prej 7.7%.



Ky fakt midis krahasimeve për të njëjtin model, ku nga njëra anë krahasohen politikat fiskale nëpërmjet normave tatimore (hendeu 7.7%), ndërsa nga ana tjetër krahasohen barra fiskale, që i është paguar buxhetit (hendeu 4%) tregon se administrimi është ende duke punuar nën kapacitetet që i jep legjislacioni fiskal në shtetet përkatëse, që nënkupton praninë e lartë të evazionit fiskal.

Në barrën fiskale gjithsej, sipas kurbave të grafikut më poshtë duket se shtetet që kanë produktivitet të ulët në arkëtimet e një grupi përbërës të barrës fiskale gjithsej (p.sh. sigurimet, dhe taksat e tjera në Kosovë) kompensohen nga arkëtime më të larta nga një grup tjetër përbërës (tatimet Indirekte në Kosovë).

STRUKTURA E BARRËS FISKALE - MESATARJA 5-VJEÇARE



Ndërkohë, përgjatë 5 viteve barra e tatimeve indirekte është më e lartë në shtetet që zbatojnë taksimin e sheshtë me +6%.

Nga studimet e ndryshme të kryera për informalitetin në tregun e punës në Ballkan është gjithnjë prezent shqetësimi i një informaliteti në tregun e punës që ndryshon dhe ulet me ritme më të ngadalshme se parashikimet dhe programet e qeverive ballkanike.

1.6. Normat Tatimore Totale⁶ në Ballkan, 2018

Barra fiskale e llogaritur për vendet e Ballkanit Perëndimor është kontributi direkt i taksapaguesve në raport me PBB-në e krijuar për vitin 2018, që tregon se sa të ardhura fiskale kanë hyrë në arkën e qeverisë si rrjedhojë e zbatimit (vullnetar ose jo) të legjislacionit fiskal dhe kontabël, të vendeve të Ballkanit.

Tab. 11 NORMAT TATIMORE TOTAL (% e Fitimit), NË BALLKANIN PERËNDIMOR, 2018

Nr.	SHTETI	Norma Tatimore, si % e fitimit			
		TOTALI	Tatim Fitimi	Tatimet mbi punën	Tatimet e tjera
1	MAQEDONI E VERIUT	13.0	11.0	0.0	2.0
2	KOSOVË	15.2	9.3	5.6	0.3
3	KROACI	20.5	0.05	19.3	1.15
4	MALI I ZI	22.2	8.1	13.4	0.7
5	BOSNJË-HERCEGOVINË	23.7	8.4	13.5	1.8
6	SERBI	36.6	13.2	19.9	3.5
7	SHQIPËRI	37.3	14.0	18.8	4.5

Burimi: WB, PwC

Në Tabelën 11 është prezantuar llogaritja e kryer nga ekspertët e Bankës Botërore, të cilët e llogarisin barrën fiskale duke marrë parasysh nivelin e normave tatimore sipas modelit të politikës fiskale, të miratuar.

Normat tatimore të shprehura si ngarkesë e tatimeve, taksave dhe kontributeve të detyrueshme për tu llogaritur dhe paguar nga bizneset dhe individët, si përqindje e fitimit të biznesit japin panoramën e një barre që teorikisht duhet të paguhet sipas ligjeve në fuqi (përfshirë tatimet mbi konsumin).

Norma tatimore Totale është shuma që llogaritet dhe miratohet për t'ja deleguar administratës fiskale qendrore dhe lokale, në mënyrë që ata ta

⁶ Norma tatimore total llogarit shumën e tatimeve dhe kontributeve të detyrueshme për tu paguar nga bizneset (pasi bën zbritjet e shpenzimeve të njohura dhe përjashtimeve tatimore), në raport me fitimin.

Nëse e krahasojmë nivelin e BF për tatimet direkte të Ballkanit Perëndimor me mesataren për BE-28 diferenca është më shumë se dyfishi.

Një bazë e ngushtë e tatimeve direkte tregon ende një tranzicion ende të pambyllur përsa lidhet me kontributin më të madh që duhet të mbajnë në buxhet tatimet direkte mbi të ardhurat nga kapitali dhe puna (kompanitë dhe individët) arkëtojnë nga bizneset dhe individët, nëpërmjet punonjësve të taksave.

Maqedonia (13%) dhe Kosova (15.2%) vijnë të ruajnë edhe në 2018 nivelin më të ulët të normave tatimore ndaj fitimit në Ballkanin Perëndimor⁷. Nivelin më të lartë në raport me fitimin e ruajnë Serbia (36.6%) dhe Shqipëria (37.3%) që mbajnë nivelet e vitit të mëparshëm.

Nga krahasimi midis barrës fiskale (përfaqëson arkëtimet në buxhet të tatimeve dhe taksave) dhe normës tatimore në total shikohet, se:

- barra fiskale shfaqet me një tendencë që tregon për shpërndarje të saj në të gjithë ekonominë
- normat tatimore në total tregojnë se sa tatime janë paguar nga kompanitë dhe bizneset që mbajnë kontabilitet në raport me fitimet që ka biznesi në vitin 2018 (përfshirë TVSH). Po të krahasojmë Maqedoninë e Veriut (ku raporti i tatimeve të paguara në raport me fitimin e rezultuar është i ngushtë), me Shqipërinë (ku ky raport është i lartë) shikohet se kjo barrë vjen nga norma e tatimit mbi fitimin dhe tatimeve të tjera mbi kapitalin, por edhe nga normat e kontributeve sociale.

Por, treguesi nuk është real pasi barra për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore me 27% të vlerës së pagës në Maqedoninë e Veriut nuk përfshihet si barrë e punëmarrësit, por e punëdhënësit, duke mos u pasqyruar në të njëjtën mënyrë si Shqipëria dhe shtete të tjera.

Në shtetet e grupit ku bën pjesë dhe Shqipëria shihet se ka një qasje më agresive politike tatimore. Vende që kanë strukturë tatimore të ngjashme (p.sh. Shqipëria me Malin e Zi apo Maqedoninë), por me treguesin e normës tatimore të ndryshëm janë ngushtësisht të lidhur kryesisht me performancën e administrimit tatimor, por veçanërisht me nivelin e informalitetit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë.

⁷ Shiko <http://altax.al/al/publikime-te-altax/product/barra-tatimore-ne-shqiperi-dhe-ballkan-2017>


Natyrshëm, që përse kohë fitimi rezulton i vogël edhe raporti tenton të dalë më i lartë.

Ky tregues nuk merr parasysh normën e evazionit fiskal. Në rastin e vendeve ballkanike, ku në administratën fiskale deklarohen fitimet që nuk përfshijnë edhe evazionin, ky tregues reflekton një barrë që nuk përkon me atë që mund të konsiderohej si një barrë reale e normave tatimore.

Sa më i lartë mund të jetë niveli i evazionit në tatimet direkte (pavarësisht se ato nuk janë të veçuara nga efekti i evazionit edhe te tatimet mbi konsumin dhe tatime të tjera), aq më joreal mundet të jetë ky tregues i përpunuar prej Bankës Botërore.

Në grafik shihen normat tatimore total në Ballkan. Nëse i shikojmë në projeksionin horizontal të 4 viteve (2014 – 2017) bie në sy se Shqipëria pas vitit 2014 deri në 2015 ka hyrë në grupin e vendeve ballkanike me norma tatimore totale në rritje duke patur shkëputje nga grupi i vendeve të tjera me treguesin e normës tatimore totale të ulët.

Mali i Zi, Kosova, Bosnja dhe Serbia kanë një linjë horizontale të pandryshueshme të normës tatimore totale përgjatë 4 viteve të fundit lidhur me normën tatimore totale.




Ky tregues edhe pse nuk ka ndryshuar, mbetet e pranueshme se vetë barra fiskale, duke qenë se në nivelin 38% – 77% të saj është e përbërë nga tatimet mbi konsumin nuk ndikohet shumë nga norma tatimore totale (përfaqësojnë tatimet direkte dhe kontributet mbi fitimin tregtar).

1.7. Normat tatimore në Shqipëri, Kosovë, Ballkanin Perëndimor, 2018

Për vitin 2018, Ballkani është karakterizuar në politika fiskale që janë fokusuar në stabilitet të normës së tatim fitimit, ulje të lehta të normës së kontributeve sociale, si dhe rritje të saj për TVSH-

në në rastin e Malit të Zi. Vendet e Ballkanit nuk kanë patur zhvillime të dukshme të politikës fiskale me kuadër reformues të sistemit tatimor. Politika fiskale e ndjekur ka synuar në stabilizimin dhe konsolidimin fiskal, si dhe në disa ndryshime të vogla që kanë patur për qëllim harmonizimin e politikave sociale, apo lehtësira për segmente të caktuara të aktiviteteve të ekonomisë kombëtare.



Ndryshimet e ndodhura në 2018 kanë reflektuar me rritje të normës standarde të TVSH në Malin e Zi (21%), si dhe në Shqipëri janë përfshirë me normën standarte apo të reduktuar shërbimi i reklamave për median elektronike, furnizimin e librave, reduktim të normës së TVSH për autobuzët elektrikë. Ndryshimet e miratuara kanë për qëllim rritjen e të hyrave të buxhetit me objektivin për të mos u prekur në tërësi të ardhurat e buxhetit dhe stabiliteti fiskal.

Norma standarte mesatare e TVSH-së në vitin 2018 për Ballkanin është nga 17% në Bosnjë-Hercegovinë, 18% në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, 20% në Serbi dhe Shqipëri, 21% në Malin e Zi dhe 25% në Kroaci. Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina zbatojnë normë standarte të TVSH nën mesataren e rajonit (19.9%). Të gjithë vendet e tjera të Ballkanit, përveç Bosnjë-Hercegovinës aplikojnë edhe norma të reduktura të TVSH, kryesisht për konsumin jetik, shëndetësi, furnizimin e popullatës me energji, transport urban, si dhe për edukimin, librat, revistat dhe veprimtari kulturore, sportive (shih grafikun në vijim).

Sipas ndryshimeve ligjore për TVSH-në në 2018, Mali i Zi ka filluar zbatimin e normës standarte 21%, e cila rezulton mbi mesataren e rajonit. Kosova ka filluar të zbatojë një normë të reduktuar të TVSH, në fund të vitit 2015, si dhe ka rritur normën standarte me 2%, për qëllime të ruajtjes së stabilitetit fiskal të buxhetit. Mali i Zi dhe Serbia miratuan në 2016 normë të reduktuar të TVSH, respektivisht me 7% dhe 10%. Ndërkohë, Mali i Zi prej Janarit 2018 ka rritur normën

standarte me 2% më shumë nga sa e kishte më përpara.

Shqipëria dhe Serbia zbatojnë prej disa vitesh një normë standarte të TVSH në nivelin 20%.


Në 2018, përveç Shqipërisë nuk ka ndryshime të normës së tatimit mbi fitimin në Ballkanin Perëndimor. Në shikimin e ligjit për tatimin mbi fitimin (korporativ) vërehet, se Kroacia, Shqipëria, dhe Serbia zbatojnë norma tatimore mbi mesataren e rajonit (12.5%). Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina zbatojnë norma tatimore nën mesatare e rajonit. Normën më të lartë të tatimit mbi fitimin e mban Kroacia me nivelin 18% mbi fitimin tregtar. Normën më të ulët vijon ta mbajë prej 2005 Mali i Zi me nivelin e 9% të fitimit tregtar. Shqipëria ruan një normë tatimore (15%), e cila është mbi mesataren e rajonit. Ndërsa, Kosova mban një normë tatimore të ulët prej 10% të fitimit tregtar, që zbatohet në disa vende (Maqedoni, Bosnjë), si pjesë e politikës së taksimit të sheshtë (me një normë tatimi gjithpërfshirëse).

Në vitin 2018, në Shqipëri u fut një normë e reduktuar e tatimit mbi fitimin me 5% për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetet për prodhimin apo zhvillimin e softëare-ve, ndërkohë që aplikon normë të reduktuar (5%) edhe për kategorinë e biznesit të mesëm, me xhiro deri 14 milionë lekë në vit.

Të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor zbatojnë një normë të sheshtë të tatimit mbi fitimin, përveç Shqipërisë.

Norma mesatare e Ballkanit për tatimin mbi fitimin (korporativ) në vitin 2017 ka patur një ulje me 4% në Kroaci.

Norma tatimore mesatare e Ballkanit Perëndimor për tatimin mbi të ardhurat individuale/paga⁸ është 16.9%.



⁸ përfshirë tatimet në burim, si: tatimi mbi dividendin, tatimi mbi interesa bankarë dhe tatimi mbi të ardhurat nga pasuria

- Kroaci (36%), Shqipëri (23%) dhe Serbi (20%) zbatojnë norma mbi këtë mesatare; Kosovë (10%), Bosnjë-Hercegovinë (10%), Maqedoni e Veriut (10%), Mali i Zi (9%) zbatojnë norma nën këtë mesatare.


Tatimin progresiv për pagat (të ardhurat nga puna) e zbatojnë Kroacia (dy shkallë tatimore), Shqipëria (dy nivele tatimore), Serbia (dy nivele tatimore).

Ndërkohë, për të ardhurat individuale, që taksohen në burim, secili shtet zbaton politika progresivi të shkallëzuara sipas segmenteve të të ardhurave personale.

Normat tatimore për tatimet në burim janë:

- poshtë mesatares së Ballkanit i mbajnë 5 vende; **Mali i Zi** (taksë e sheshtë 9% për tatimet në burim), **Kosova** (taksë e sheshtë 10%, kurse dividendi nuk taksohet), **Maqedonia e Veriut** (taksë e sheshtë 10% për gjithë të ardhurat personale), **Bosnjë-Hercegovina** (taksë e sheshtë 10%, ku vetëm dividendi tatóhet me 5%);
- mbi mesataren e Ballkanit i mbajnë 5 vende; **Shqipëria**⁹ (taksë e sheshtë 15% për tatimet në burim), **Serbia** (taksë progresive 20% për tatimet në burim), **Kroacia** (taksë e sheshtë 15% për tatimin mbi interesat bankare dhe për tatimin mbi pasurinë dhe 12% për tatimin mbi dividendin).

Shqipëria, Kroacia, por pjesërisht edhe Mali i Zi dhe Serbia, Maqedonia e Veriut (nga viti 2019) aplikojnë sistem progresiv të tatimit mbi të ardhurat personale. i cili mbart mbi vete ende propblemin e mprehtë dhe ende të pa adresuar për zgjidhje lidhur me zgjerimin e bazës së ngushtë të tatimeve mbi kapitalin dhe punën.



⁹ Rasti i normës tatimore për këtë grupim në Shqipëri ka spjegim, për arsye se norma tatimore 13% mbi të ardhurat personale përfshin mbi 95% të bazës tatimore të tij.

Norma mesatare gjithsej e kontributeve sociale¹⁰ në Ballkan për vitin 2018-2019 është te 30.9%.

Poshtë kësaj norme mesatare renditen 3 vende¹¹:

- **Kosova (10%), Maqedonia e Veriut (27%), Shqipëria (27.9%), Bosnjë - Republika Serbe (23%);**

Mbi këtë normë mesatare renditen 4 vende:

- **Kroacia (37.2%), Mali i Zi (34.3%), Bosnjë - Federata (41.5%), Serbia (37.8%).**

Shtetet e grupit me barrë të normave tatimore të larta kanë një diferencë të dukshme që varion nga 7% deri 14%. Ndërkohë, nisur nga politikat për rritje pensionesh, për transferata ndaj shtresave në nevojë, por edhe për edukimin profesional dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve vijnë në rritje si nevojë e përbaljes së rritjes së konkureshmërisë së kapaciteteve njerëzore, por edhe ekonomisë.

Nevojitet që politika e barrës së kontributeve të rishikohet për të ngushtuar këtë boshllëk në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri. Nivelet e ulta të normave të kontributeve rrezikojnë në terma afatmesëm dhe afatgjatë edhe zbatimin e skemave aktuale nisur vetëm nga fakti i rritjes së moshës për përfitim nga pensionistët.

Në diagramën më poshtë shikohet se edhe në 2019 pesha kryesore e barrës fiskale në vendet e Ballkanit Perëndimor do të mbahet prej tatimeve mbi konsumin dhe më pak barrë u lihet tatimeve direkte. Ndërkohë, politika për fondet sociale shikohet se nuk ka synuar të jetë konkurruese duke ruajtur të njëjtën barrë si viti i mëparshëm.

Në kontekstin e zbatimit të normave tatimore, nëse analizojmë në tërësinë e tyre këto norma me nivelin e barrës fiskale shihet se kapacitetet e administrimit për tatimet indirekte janë poshtë nivelit të barrës së normave tatimore në secilin vend ballkanik. Por edhe për tatimet direkte, kapacitetet e administrimit mbeten ende të porealizuara plotësisht. Ky ballafaqim kërkon një rishikim të modelit të përshtatjes së normave tatimore me forcim kapacitetesh, përshtatje me ambjentin ekonomik dhe social të tatimpaguesve.


¹⁰ për punëdhënësin dhe punëmarrësin

¹¹ Republika Srpska është përfshirë si Federatë (pjesë e shtetit) dhe jo në nivel shteti

Nga këndvështrime bazuar në raste praktike nuk ka dyshim se politika fiskale ndikon në zgjedhjet ekonomike të biznesit. Nëse uljet e normave të tatimeve nuk harmonizohen mes tyre duke konsideruar edhe zgjerimin e bazave tatimore, atëherë krijohet një situatë buxhetore që ndikon negativisht te konsolidimi fiskal, si dhe te forcimi i vullnetarizmit në pagimin e tatimeve dhe rritjen e kulturës fiskale.

Nga krahasimi horizontal i normës së kontributeve sociale gjithsej ka një tendencë rajonale të mbajtjes së tyre në nivele të njëjta me vitin 2017. Mosndryshimi i normave të kontributeve sociale tregon se politika po relakson tregun e punës dhe po synon të ndihmojë politikat buxhetore, pavarësisht se për disa vende si Shqipëria, Kosova e ndoshta edhe Maqedonia e Veriut ka nevojë për një rritje të kontributeve për disa politika sociale të mprehta në lidhje me politikat e aftësisht të punësimit dhe për disa kategori të tilla, si: personat e paaftë për punë, të rinjtë që hyjnë rishtas në tregun e punës, si dhe të varfërit.

Nëse shikojmë faktin e përmbushjes në buxhet të objektivave të politikës fiskale, provohet se normat tatimore aktuale nuk e plotësojnë dot politikën fiskale në asnjë prej shteteve të Ballkanit Perëndimor. Nëse anaizojmë më thellë, konstatohet se disa shtete kanë një barrë fiskale të ulët (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni). Ulja e një norme tatimore të një tatimi të caktuar nuk është zgjidhja e kërkesavë të qytetarëve dhe buxhetit. Një sistem kompleks tatimor, i cili vitet e fundit po zbatohet në një ekonomi e cila ka nevojë për të qenë konkurruese në tregun rajonal ka nevojë për një harmonizim të politikës fiskale me normat tatimore. Por, nga ana tjetër



kompleksimi i sistemit fiskal rrit vështirësinë e bashkëpunimit vullnetar me ligjin nga tatimpaguesit e vegjël dhe të mesëm, të cilët janë shumica e bazës së taksimit.

Edhe pse studimet e fundit nga organizata dhe kërkuesë të ndryshëm konfirmojnë se

ndryshimet e normave të tatimeve mbi konsumin dhe kapitalin janë më pak ndikuese në ekonomi, se ndryshimet e normave të tatimeve mbi individin dhe punën, vlen të theksohet se zhvendosja e barrës fiskale nga konsumi dhe kapitali te individit dhe puna është një detyrë mjaft e vështirë për çdo qeveri.

Gjithsesi, politika fiskale lidhur me normat tatimore të ulëta për kapitalet nuk ka patur ndikimin e pritshëm në thithjen e investimeve dhe si rrjedhojë edhe në rritjen ekonomike. Kjo tregon se politika fiskale është instrument mjaft i fortë stimulues/frenues për lëvizjen e kapitaleve dhe konsumit, por nuk mund të anashkalohet fakti se buxheti ka nevojë për para të mjaftueshme që të bëjë politikën për rritjen e tregut të punës nëpërmjet stimulimeve dhe forcimit të kapaciteteve, por edhe nëpërmjet rritjes së infrastrukturës dhe krijimit të ambientit për futjen e teknologjisë bashkëkohore.

P.sh. Le të shikojmë rastin e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë aplikuar normat tatimore mbi kapitalin ndër më të ultat në Ballkanin Perëndimor.

PBB në këtë vend për periudhën prej vitit 2008 – 2017 nuk ka shënuar një rritje të qëndrueshme, por ka shënuar ulje – ngritje gjatë këtij harku kohor. Po kështu ka ndodhur edhe me Maqedoninë, e cila mbahet për normat tatimore më të ulta edhe madje në nivel evropian. PBB-ja e këtij vend ka mbetur në nivelet rreth 10 miliard Euro, me ulje ngritje të vlerës së shtuar kombëtare.

Aplikimi i një politike reformuese gjithpërfshirëse duhet të mbështetet te një nivel administrimi dhe me kapacitete të forta. Përmirësimi i sistemit tatimor duhet të trajtojë njëkohësisht si politikën e normave tatimore, por edhe forcimin e administrimit duke u konsideruar gjithnjë një kusht i nevojshëm për funksionimin e zhvillimit të sistemit fiskal në përshtatje me objektivat për zhvillimin e ekonomisë.


1.8. Ndryshimi i normave tatimore dhe indeksi GINI (pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare)

Rishpërndarja e të ardhurave të buxhetit pasqyron nivelin e taksave për kryerjen e shpenzimeve për transfertat e parave drejt popullsisë në moshë pune dhe jo vetëm. Ajo

gjithashtu synon edhe të arrijë që taksat mbi të ardhurat personale të arkëtohen në mënyrë progresive sipas niveleve të të ardhurave dhe orientimin në të cilën transferimet në para shkojnë aty ku nevojat e popullsisë janë më të domosdoshme në raport me përmirësimin e jetesës.

Niveli i lartë në rritje i pabarazisë në të ardhura në Ballkan vazhdon të marrë vëmendje në rritje nga qeveritë, pavarësisht krahut politik. Ajo kuptohet nga qeverisjet se pabarazia është një sfidë që secili vend duhet ta adresojë, por tashmë është domosdoshmëri që rishpërndarja e të ardhurave të adresohet qartësisht nëpërmjet politikës dhe administrimit fiskal.

Përpara se të trajtohet si një difekt në zmadhim i sistemit kapitalist, nevojitet që së pari vendet të përditësojnë të dhënat dhe të ndërgjegjësojnë



gjithë segmentet lidhur me mjetet për korigjimin e polarizimit social. Matja e pabarazisë në të ardhurat individuale, sipas indeksit (koeficientit) GINI¹² duhet parë i lidhur me faktin se pabarazia ndikohet prej tatimeve dhe taksave. Një nga studimet e kryera¹³ i publikuar nga OECD së fundmi, pabarazia e të ardhurave kryesisht pasqyron ndikimet që vijnë prej pabarazisë së tregut të punës, por jo vetëm. Pabarazia e të ardhurave prej punës është kontribuesi kryesor i shpërndarjes në të ardhurat e familjeve. Nëse shikojmë rastin e Shqipërisë, pjesa më e madhe e të ardhurave nga puna shkon në nivelet e pagave të larta për një pakicë më pak se 1% e punëmarrësve.

Gjithashtu, rënia e efektit të rishpërndarjes sipas politikës fiskale aktuale është shoqëruar me rritje

¹² Indeksi Gini ose Koeficienti Gini mat shpërndarjen e të ardhurave, apo shpërndarjen e pasurisë në popullsinë e një vendi e më gjerë. Koeficienti shkon nga 0 (ose 0%) në 1 (ose 100%), ku me 0 kuptohet barazia perfekte dhe me 1 kuptohet pabarazia në nivelet më të larta.

¹³ <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/3b63e61c-en.pdf?expires=1553334091&id=id&accname=guest&checksum=48884A0F71A77F8FFFB0CFE640F527>

të pabarazisë në tregun e punës, por dhe në të taksimin e të ardhurave që qarkullojnë në tregun informal. Në disa raste, ky i fundit qarkullon më shumë të ardhura, se sa vetë tregu formal i punës.

Në periudhën 2009-2017, deri 96% e individëve kanë zotëruar 40% deri 48% të totalit të parasë në banka. Ndërsa, 4% e individëve kanë zotëruar 52% deri 60% të depozitave.

Në vitin 2018¹⁴, depozitat e individëve shqiptarë në banka arrijnë në shumën 979.3 mld lekë (79% e parasë në qarkullim), ku paraja jashtë sistemit bankar është në shumën 267 miliard lekë (21% e parasë në qarkullim), duke përbërë 78.5% të totalit të parave në qarkullim.

Depozitat e sigurueshme nën nivelin 2.5 milion lekë ishin sa 38% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme, kurse depozitat mbi nivelin këtë nivel arritën sa 62% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme. Sipas shumës që disponohet nga individët në depozita shikohet se 96.4% e individëve zotërojnë 42.5% të shumave të depozituara, apo mesatarisht 185 mijë lekë depozita për individ. Në fakt, nga këta 40% e individëve kanë llogari që kanë lekë deri në vlerën 100 lekë. Pra, pjesa tjetër e këtij grupi (56.4%) ka kursime individuale në shuma që arrijnë deri 2.5 milionë lekë. Ndërkohë, 5.6% e depozituesve zotërojnë 57.5% të totalit të depozitave, ku çdo individ i këtij grupi i takon mesatarisht 5.7 milion lekë.


Transfertat e parave nga buxheti në grupet e ndryshme të popullsisë, siç janë pensionistët, të papunët dhe shtresat e paafta për punë dhe në nevojë përbëjnë 12.6% të shpenzimeve buxhetore në vitin 2018 në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto transfertat, kryesisht kanë për qëllim rishpërndarjen e të ardhurave gjatë gjithë jetës së individëve duke ndjekur parimin e shpërndarjes së tyre sipas nivelit historik të kontributit të individëve në buxhet. Edhe pse vlerat e këtyre transfertave për individ përfaqësojnë shuma parash modeste ose shumë të vogla në raport me konsumin individual, ato mbeten një instrument permanent i rishpërndarjes së të ardhurës për periudha afatgjata apo të përhershme.

Sipas Grafikut më lart, Indeksi GINI në Ballkanin Perëndimor, tregon nivelin më të lartë të pabarazisë të të ardhurave në Maqedoninë e Veriut (0.36), e pasuar nga Serbia (0.34). Në vend

të tretë renditet Bosnjë-Hercegovina (0.33). Në vend të katërt është Mali i Zi (0.32). Kroacia mban vendin e pestë (0.31) dhe vendin e parafundit e mban Shqipëria (0.29) dhe Kosova (0.27) mban nivelin më të ulët të pabarazisë, megjithëse duhet përmendur fakti se të dhënat për të dy shtetet e fundit janë respektivisht të viteve, 2012 dhe 2013.

Është e nevojshme, që të qartësohet niveli real i Indeksit GINI bazuar te fakti se sa të ardhura u mbeten individëve pas pagesës së taksave. Por, qartësimi ka nevojë njëkohësisht të njihet me nivelin e informalitetit dhe kjo e dhënë zyrtarisht nuk është e mundur.

P.sh., kur shikojmë situatën e shpërndarjes së të ardhurave në Shqipëri dhe pabarazisë, nëpërmjet pozicionimit sipas Indeksit GINI shikohet një nivel relativ i pabarazisë, por i pozicionuar më mirë se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Por, kjo e dhënë nuk mund të argumentojë gjithë treguesin e pabarazisë, pasi indeksi GINI ndikohet edhe nga elementë të tjerë, si: informaliteti, barra e taksave, mosha mesatare e popullsisë. Megjithatë, nëse shikojmë rastin e Shqipërisë, pas aplikimit të tatimit progresiv mbi pagat, vërehet se prej vitit 2014 progresiviteti i tatimit mbi pagat duket se e ka zvogëluar pabarazinë e vërejtur në të ardhurat bruto dhe neto të raportuara. Kjo shpjegohet me faktin se vendet që ushtrojnë presion fiskal të drejtë kanë ndikim në uljen e pabarazisë. Këtë fakt e gjejmë në raportet e FMN, OECD, Bankës Botërore.



Nëse fokusohemi te rishpërndarja e të ardhurave sipas barrës fiskale dhe tipit të taksave të aplikuar mund të thuhet se barra e taksave tregon pak progresivitet në rishpërndarjen e të ardhurave sipas zonave gjeografike dhe segmenteve të punëmarrësve sipas sektorëve ekonomikë, pasi vetë zhvillimi i sektorëve ekonomikë dhe zonave gjeografike ka diferenca historike, ekonomike, kulturore, edukative dhe ambientaliste. Por edhe lëvizjet demografike bashkë me ndryshimin e moshës mesatare janë faktorë që ndryshojnë barazinë e të ardhurave.

¹⁴ Raporti tremujor i politikës monetare, 2018/IV

Ndërkohë transfertat e qeverive në këto 5 vitet e fundit, p.sh. në Shqipëri kanë ruajtur të njëjtin nivel prej 11.8% të PBB-së.

Ndryshimi i progresivitetit në shkallët e sipërme të taksimit të pagave është më efektiv në uljen e pabarazisë sesa ndryshimet e ngjashme në fundin e shkallës së të ardhurave. Në veçanti, sa më e lartë të jetë barra fiskale, aq më i ulët është Indeksi Gini. Kjo mund të argumentohet nga shpjegimi pse vende si Suedia, Gjermania dhe Franca, të cilat kanë norma të larta tatimore për të pasurit, vuajnë më pak nga pabarazia në krahasim me SHBA, e cila ka relativisht barrë të ulët fiskale.

Megjithëse nuk është e mundur të gjenden të dhëna zyrtare për secilin vend të Ballkanit, në mënyrë eksplicite ky konkluzion mendojmë se është gjithashtu i qëndrueshëm edhe për Ballkanin Perëndimor nisur edhe nga rasti i Kroacisë. Për arsye se evazioni fiskal është kaq i përhapur në vendet e Ballkanit Perëndimor, treguesit e barrës dhe produktivitetit fiskal nga gjetjet e studimit mund të qartësojmë se shtetet përballen me kosto më të ulëta të efikasitetit në drejtim të ngushtimit të pabarazisë nëpërmjet taksave.

1.9. Investimet e Huaja Direkte dhe ndikimi nga barra fiskale

Nxitja e IHD-ve prej politikës së taksave konkurruese me norma të ulëta është më efektive nëse tërhiqen IHD-të, që kërkojnë efikasitet të bazuar te kostot e ulëta të prodhimit, që do të thotë barrë fiskale e ulët mbi punën. Por, nëse në lidhje me koston e punës Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut i mbajnë në nivele të ulëta në raport me shtetet e tjera të BP-së, si shihet dhe nga grafiku, çfarë duhet mbajtur parasysh është edhe transparencja dhe administrimi i fortë i zbatimit të politikës fiskale. Nëse shikojmë investimet e huaja neto si % e PBB-së, sipas të dhënave mesatare të katër viteve (2014-2017), rezulton se kostoja e punës nuk ka një lidhje reflektive me IHD-të. Nga ky krahasim edhe pse duhet parë i idhur edhe me barrën fiskale mundet të konstatohet se përtej koston së ulët dhe barrës fiskale nevojitet që të ketë një ekonomi të ekuilibruar, administratë me kosto të ulët dhe politikë transparente.

Në Ballkanin Perëndimor, Serbia mbetet vendi më i rëndësishëm për sasinë e IHD-ve, me hyrje të ngjashme tyre si vitin e kaluar. Shqipëria përfitoi sasinë e dytë më të madhe të investimeve të huaja direkte në rajon, kryesisht në projekte të energjisë dhe shërbimeve. Në të kundërt, Bosnjë - Hercegovina ishte më e dobët se në vitet e mëparshme, ndoshta për shkak të mjedisit ekonomik gjithnjë e më të segmentuar. Maqedonia e Veriut dhe Kosova morën më shumë IHD se një vit më parë, pavarësisht nga debatet politike në rritje në këto vende. Furnizuesit e industrisë së automobilave dhe të elektronikës e bëjnë Maqedoninë e Veriut vendin unik në rajon, me pjesën e lartë të IHD-ve në prodhim.

Analiza e realizuar në shembullin e vendeve të Ballkanit, identifikon marrëdhënie të ndryshme të investimeve të huaja direkte, eksporteve dhe importeve në PBB-të e këtyre vendeve, si dhe përbërjen e ndryshme të PBB-ve të tyre. Sipas analizës së kryer, konstatohet se ndikimi i IHD-ve në zhvillimin ekonomik të Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi në vitet e fundit nuk kanë qenë faktor kryesor. Përkundrazi, në Shqipëri, Serbi IHD-të kanë patur impakt në PBB-të e vendeve duke u reflektuar në nivelet e rritjes ekonomike. Ky qëndrim nuk përjashton rëndësinë specifike investimeve të huaja direkte, por sigurisht që ato nuk janë faktori vendimtar në zhvillimin e këtyre vendeve. Nëse analizohet periudha prej rreth njëzet vitesh, pothuajse të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor mund të vërehen mjaft të dobëta.

Ka rëndësi, që IHD-të, të trajtohen si një nga faktorët që kanë nevojë të integrohen me elementët e brendshëm dhe në kushte specifike të caktuara, ku nga sinergjia e tyre mund të përmirësojnë zhvillimin ekonomik të vendeve ballkanike.

Megjithatë, për të qenë konkurrues në tregun e Ballkanit dhe atë European me synimin, që të tërhiqen një sasi e konsiderueshme investimesh është e pashmangshme që të realizohen reformat e nevojshme, ku më kryesoret janë: të reduktohet korrupsioni, të përmirësohet efikasiteti i administratës për të ulur kostot indirekte. Nga ana tjetër duhet të krijohen strategji efektive për tërheqjen e drejtpërdrejtë dhe të personalizuar të investimeve që kanë gjasa të ndodhin, dmth. krijojnë një mjedis tërheqës dhe familjar biznesi për investime.

Por, është e rëndësishme të mbahet një model i qëndrueshëm ekonomik dhe financiar, si dhe një sistem konkurrues taksash, por me përmbajtje dhe duke marrë parasysh plotësimin e objektivave buxhetorë, përpara se të mendohet konkurrueshmëria.

Niveli i IHD-ve Neto në Ballkan në 2017 është mesatarisht sa 4.61% e PBB-së së rajonit. Nivelin më të lartë të fluskit sipas PBB-së vendore e mban Mali i Zi me nivelin 12.3%. Shqipëria ka një hyrje të IHD neto në 2017 sa 9.4 % e PBB-së, ndër më të lartat në Ballkan dhe vjen menjëherë pas Malit të Zi. Vendi e tretë për tërheqje të investimeve të huaja në përqindje të PBB-së e mban Serbia.

Shqipëria edhe për vitin 2017, por edhe 2018 vijon me nivel të lartë të investimeve të huaja direkte duke arritur shumat e 908 milionë euro dhe mbi 1 miliard euro. Ndërkohë, Bosnja, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi kanë tërhequr vlera neto investimesh të huaja poshtë shumës 500 milionë euro. Vlera gjithsej e IHD-ve neto për Ballkanin në 2017 llogaritet të jetë në shumën 15.5 miliardë Euro.

Investimet e huaja direkte mesatare në Ballkan në 5 vite janë 3% - 5% e PBB-së në nivel rajoni. Kur analizojmë efektin e barrës fiskale sipas statistikave të investimeve neto në përqindje të prodhimit të brendshëm, vërehet se vendet me IHD më të lartë nuk kanë të njëjtën tendencë me barrën fiskale. Arsyeja e mospërkimit të barrës fiskale dhe investimeve të huaja është treguesi më i fortë i rolit që ka në radhë të parë klima për investime në një vend të caktuar. Politika fiskale ka efektin për të nxitur investimet, por kjo ndodh pasi kushtet dhe rregullat për tregun perceptohen nga investitorët sipas indekseve për investim me situata pozitive dhe mbi nivelet mesatare të tyre.

Nga ana tjetër, nevoja për sisteme të zhvilluara të tregjeve financiare, infrastrukturës rrugore dhe energjetike, kapaciteteve dhe aftësive të mangëta të tregut të punës bashkë me nivelin e korrupsionit kanë një tjetër efekt me ndikim në tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin e tregut të brendshëm.

Pas reagimit nga indekset përfaqësuese të treguesve më lart, në përputhje me planifikimin për thithjen e investimeve të huaja vlen të hartohet politika fiskale që përshtat normat e taksimit të kapitalit dhe punës sipas nivelit të

tregut dhe vizionit për kapitalin dhe tregun e ardhëm.

Perceptimi se vetëm normat e ulta të tatimeve mund të tërheqin IHD-të ka ndikuar jo pak politikëbërjen në Ballkanin Perëndimor në dekadën e fundit.

Në teori, nëse një vend aplikon norma të ulta të tatimit mbi fitimin dhe përgjithësisht mbi kapitalin bëhet më tërheqës për tu zhvendosur fitimet e kompanive investitore, pasi ndikon mbi dividendin që mbetet si fitim pas tatimit. Riatdhesimi i fitimit të kompanitë që kanë hapur këto degë të tyre në vendet me norma të ulëta tatimore ndikon edhe në instalimet e shumëkombsheve.

Është pikërisht, kjo politikë e normave të ulta tatimore që është kthyer në një garë të fortë midis shteteve të Ballkanit, duke diktuar mbi to të zbatojnë edhe politikat për shmangien e taksimeve të dyfishta dhe adoptimin e parimeve të OECD mbi transferimin e fitimit nëpërmjet çmimit.

Shqipëria dhe Kosova janë të krahasueshme në politikat e tyre me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Por, problematikat e korrupsionit dhe kapaciteteve jo të përshtatshme administrative, mungesa e transparencës, si dhe mekanizmat që përdoren në sisteme me tatime të ulta me dobësitë që mbartin i bëjnë këto dy shtete ende larg investimeve cilësore dhe afatgjata.

Gjithsesi, nga kryqëzimi i treguesve të investimeve, me normat tatimore mbetet e paqartë nëse duhet ulur realisht një normë tatimore me qëllimin për të tërhequr vëmendjen e investitorëve, pasi treguesit e barrës fiskale në këto dy shtete tregojnë se janë shumë më poshtë se vendet e tjera fqinje me to.

Nëse nisemi nga logjika e vendeve të zhvilluara ekonomike, si dhe atyre që po ecin me ritme të përshpejtuara zhvillimi, mund të theksohet se nëse ekonomia mbështetet mbi një infrastrukturë të zhvilluar, shërbime dhe administratë publike efektive, rritja e produktivitetit për të synuar një treg relativisht më të madh, atëherë konkurrenca e normave tatimore dhe barrës fiskale fiton avantazhe vetëm kur garantohen apo egzistojnë këto kushte. Këto kushte janë më së shumti të arritura në numrin më të madh të vendeve anëtare të OECD, që edhe pse kanë një barrë të lartë fiskale, ata janë shumë më efektivë në tërheqjen e investimeve të huaja.

Një barrë e ulët tatimore nuk mund të kompensojë nga ana tjetër një ambient ekonomik jo tërheqës për investitorët. Nxitjet tatimore mund të përdoren në një mënyrë më të orientuar drejt dhe që të jenë me kosto efektive për shpenzimet që do të kryejnë investitorët, por dhe për të përmbushur nevojat e buxhetit.

Taksat janë vetëm njëri nga elementet që edhe në kushtet e një oferte me norma të ulëta nuk arrin dot të kompensojë infrastrukturën e dobët, aksesin e dobët në treg si dhe kushte të tjera mbi të cilat bazohet në vendimarrjen e tij një investitor, si: hapësira për të lëvizur lirisht në tregun financiar. Nëse bizneset (sidomos SME) nuk do të kenë kreditim të mjaftueshëm dhe me kosto të ulët, atëherë rritja e tyre do të vijojë të jetë e dobët dhe natyrisht që do të çënohen investimet dhe tregu i punës.

Qeveritë ballkanike u janë përgjigjur këtyre presioneve të konkurrencës në mënyrë ta ndryshme. Shumë nga vendet kanë ulur normat e tatimit mbi fitimin, si rruga më e shkurtër dhe e monitorueshme lehtësisht për të arritur objektivat për investimet.

Në fakt, ajo që duhet të bëjnë është bashkëpunimi tatimor mes tyre. Bashkëpunimi dhe koordinimi i politikave nxitëse fiskale, por edhe ekonomike duhet të konceptohet për tu zbatuar brenda kufijve të Ballkanit Perëndimor, pa ju rikthyer politikës së mosbashkëpunimit. Konkurenca e politikave fiskale nuk funksionon brenda Ballkanit Perëndimor. Por, nëse shtetet do të ishin pjesë e tregut të madh të do të kishin mundësi reale për të konkuruar edhe me politikën e uljes së normave tatimore. Konkurenca mes njeri-tjetrit ndihmon shtete dhe kompani të fuqishme të hyjnë lehtësisht nëpërmjet politikës së përçarjes së shteteve Ballkanike.


Gjithsesi, uljet e normave tatimore kanë tendencën të jenë me kosto të lartë për buxhetin, pasi të ardhurat që i hiqen buxhetit nga politika e uljes së normave të tatimeve në fakt prish konkurrencën e ndershme në vend, por kthehet edhe në një barrë të shtuar për segmente dhe grupe të caktuara të tatimpaguesve.

Nga ana tjetër, ulja e normave tatimore kthehet në një kulturë për qytetarët për ti bërë presion qeverive për mbajtjen e një politike të tillë në mënyrë permanente, pa patur efekt në nevojën

për zgjerim të bazës dhe shpërndarjen e barrës në mënyrë të barabartë.

1.10. Ndikimi i rritjes së investimeve nga ulja e normave të tatimit mbi kapitalin

Vendet pritëse të IHD-ve në Ballkanin Perëndimor kanë aplikuar për mbi 10 vitet e fundit norma të ulëta të tatimit mbi fitimin dhe përveç Shqipërisë zbatojnë modelin e taksimit të sheshtë, me synimin për ta mbajtur të thjeshtë mekanizmin tatimor. Megjithatë, përsëri shihet se tërheqja e investimeve nuk ka patur prirje të ketë rritje të dukshme, madje edhe në shtetet kur kjo ulje ka qenë ndër më të ulëtat në Ballkan.



Konkurenca e normave tatimore për IHD është një realitet në mjedisin e sotëm global, si dhe atë ballkanik. Është e vërtetë, që investitorët në mënyrë rutine krahasojnë barrën e taksave në vende të ndryshme, ashtu siç bëjnë hartuesit e politikave në mënyrë tipike për vende që janë të ngjashme në lidhje me vendndodhjen dhe madhësinë e tregut.

Një pikëpamje gjerësisht e përhapur është se taksat kanë gjasa të kenë më shumë rëndësi në zgjedhjen e një vendi pritës investimesh, nëse barrierat jo-tatimore hiqen dhe nëse ekonomitë kombëtare konvergojnë me kërkesat për rimarrjen e investimit në formën dhe mënyrën më konkurruese midis vendeve. Ndërsa tatimi mbi fitimin njihet si një faktor i rëndësishëm në vendimet për të investuar, në fakt praktika tregon se nuk është përcaktues kryesor.

Nga historiku i konkurrencës midis shteteve të Ballkanit Perëndimor për norma tatimore sa më të ulta faktet e investimeve të realizuara në vite tregojnë, se nuk është e qartë nëse reduktimi i barrës së tatimit mbi fitimin është në gjendje si instrument i vetëm që të tërheqë investitorë të mëdhenj, por edhe ata të mesëm.

IHD janë tërhequr nga vendet që kanë ofruar qasje në tregje dhe mundësi fitimi; një kornizë ligjore dhe rregulatore të parashikueshme dhe jo diskriminuese; stabilitet makroekonomik; tregje pune të aftë dhe të përgjegjshëm; infrastrukturë të mirëzhvilluar.

Ndërkohë, Kroacia por edhe vendet e Ballkanit pjesë e BE-së edhe pse kanë një barrë më të lartë të tatimit mbi fitimin, fakti që janë pjesë e një tregu me rregulla të tjera, por edhe nisur nga garancia e një infrastrukture të zhvilluar, shërbime publike dhe ambjent mikpritës dhe tërheqës për biznesin, kosto transporti të arsyeshme, duke përfshirë edhe madhësinë e tregut, atëherë është e kotë të kërkohet të konkurrohen nga vendet e Ballkanit Perëndimor vetëm me norma tatimore të ulëta, pa mos ofruar edhe avantazhe të ngjashme si ato të vendeve ballkanike anëtare të BE-së.

Një barrë fiskale e ulët nuk mund të kompensojë një mjedis përgjithësisht të dobët ose jo tërheqës për IHD-të. Gjithashtu, ndërkohë që vëmendja shpesh përqendrohet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave, rëndësia e taksave të tjera duhet të njihet.

Një faktor tjetër është se sa miqësore është me biznesin administrata tatimore dhe doganore, qendore dhe lokale. Nga anketimet dhe raportet e shumta të organizatave ne mbrojtje të të drejtave të biznesit shihet si një konkluzion i përbashkët, se në ato vende të rajonit ku investitorët gjejnë sigurinë, parashikueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe afatet kohore në zbatimin e rregullave tatimore, si dhe një normë efektive tatimore, atëherë ai mjedis konsiderohet si miqësor me biznesin.


Mjedisi mikpritës fiskal duhet të ndikohet gjithashtu edhe nga nevoja që lind si detyrë për politikën për të ndërmarrë masa kundër keqpërdorimit të sistemit fiskal nga skema agresive tatimore ndërkombëtare, që shfrytëzojnë dallimet mes sistemeve.

Vendet e Ballkanit duhet që gjithashtu të shqyrtojnë trajtimin tatimor të IHD-ve jashtë vendit. Disa vende sot ofrojnë një trajtim tatimor që lejon lehtësim nga tatimi në vendin e origjinës që shkon shumë më larg se argumenti i vjetër në funksion të konkurrencës, i cili kërkon një përjashtim tatimor të vendit të origjinës ose një shtyrje të të ardhurave të pashpërndara të aktivitetit të huaj, duke favorizuar rritjen e tatimit

për të ardhurat e krijuara jashtë vendit të rezidencës fiskale.

Qeveritë ballkanike duhet të përpiqen të përmirësojnë vullnetarizmin e biznesit për pagimin e detyrimeve të tyre ndaj buxhetit, duke përmirësuar transparencën dhe sigurinë për një trajtim korrekt tatimor. Duke parë vetëm përpara, kufijtë e konkurrencës tatimore mund të testohen më tej, me ulje të mëtejshme të barrës së tatimeve korporative për investimet e huaja, por edhe duke mos rënë prapa e modës së uljes së taksave, kur shihen nga hartuesit e politikave si të panevojshme për të tërhequr investime, për shkak të cilësive të papërbushura për tërheqje investimesh nga vendi pritës dhe mungesës së një kuptimi të kontekstit lokal për investime të suksesshme të huaja.

INVESTIMET PUBLIKE DHE PRIVATE, 2016 - 2018 (% e PBB)



Në analizën e ndikimit të normave të tatimit mbi fitimin të investimit, nëse shikojmë edhe investimet që kryhen në buxhet me fonde të brendshme, si dhe ato me fonde të huaja vërehet fakti se në 2015 dhe 2018 realizimi më i lartë si % e PBB-së ka ndodhur në Mali i Zi dhe Kosovë, që kanë normë të ulët tatimore.

Kroacia që ka normën më të lartë të tatimit mbi fitimin (18%) mban vendin e fundit. Por, vendin e parafundit për investimet e zë Serbia, e cila ka norma të njëjta me Kosovën por, edhe duke operuar si një ekonomi konkurruese, ambjent mikpritës dhe pa paragjykitime mbi investitorët si dhe një administratë më të kualifikuar se shtetet e tjera.

Ndërkohë, Shqipëria si një vend me normë tatimi më të lartë se Mali i Zi dhe Kosova, por edhe shtet kufitar me to mban vendin e tretë për nivelin e realizimit të tyre për 4 vitet e fundit. Në këtë interpretim të fakteve vlen të përmendet, se përpara normës tatimore (për investitorët e mëdhenj, si ka ndodhur në rastin e Shqipërisë me projektin TAP dhe projektet energjetike) zbatohen skema të veçanta lehtësuese, të cilat falë

pozicionit gjeostrategjik, por edhe nisur nga nevoja për investime ka një realizim në nivel të lartë në raport me PBB-në, edhe pse në vlerë absolute investimet janë modeste krahasuar me peshën që zbatohet në vendet e reja anëtare të BE-së, por pjesë e Ballkanit, si: Rumania, Greqia e Kroacia.

1.11. Efekti i Marrëveshjeve të eliminimit të taksimit të dyfishtë në Ballkanin Perëndimor

Shumica e Marrëveshjeve dypalëshe të eliminimit të taksimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin (MTD) bazohen në pjesën më të madhe në (a) Modelin e Konventës Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin (Modeli i OECD) dhe (b) Modelit të Konventës së Taksimit të Dyfishtë midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim (Modeli i OKB-së).

Ndërkohë, secili shtet i Ballkanit Perëndimor, për secilin nga investimet me rëndësi strategjike nënshkruan edhe Marrëveshje tatimore me investitorin strategjik duke e kthyer këtë model Marrëveshje midis palëve (shtetit dhe grupit/kompanisë ndërkombëtare investitore) të ngjashme për nga përfitimet me MTD midis shteteve. Dallimi midis dy modeleve të Marrëveshjeve është si lidhur me taksat që përfshihen apo përjashtohen nga to, por edhe nga shtrirja e efektit të saj bazuar mbi parimin e rezidencës fiskale.

Studime të ndryshme tregojnë se pas nënshkrimit të një MTD midis dy ekonomive me pozicione reciproke të investimeve të huaja të ndërsjellta nuk përbën problematikë rishpërndarja e të drejtave tatimore ndaj vendit të rezidencës. Megjithatë, kur një Marrëveshje e tillë nënshkruhet ndërmjet dy vendeve me pozicione investimi asimetrike, atëherë vendi importues i kapitalit rrezikon të humbasë tatimin mbi të ardhurat. Vendet burimore mund të përfitojnë nga ndikimi i IHD-ve. Por, efektet pozitive në IHD kanë më shumë gjasa për vendet me të ardhura mesatare dhe më pak gjasa për vendet me të ardhura të ulëta. Nëse një vend importues i kapitalit përfiton nga nënshkrimi i një MTD-je varet edhe nga dimensionet e bazës tatimore të tij. Përfitimi primar që vendet në zhvillim kërkojnë nga nënshkrimi i një MTD është rritja e ofertës për tërheqjen e investimit të huaj.

Por, një nga problemet që janë bërë të njohura nga praktikatat e zbatimit të Marrëveshjeve është se Marrëveshjet tatimore mund të paraprijnë investimeve, jo sepse nxisin ato, por sepse ato mund të konkludohen vetëm kur ekziston pritshmëria e një investimi.

Në gjithë sa më lart, por pa u kufizuar në arsyetimet dhe logjikën e përfitimeve nga nënshkrimi i MTD një rëndësi të veçantë merr momenti i nënshkrimit të tyre dhe mosvënja e sistemit fiskal dhe buxhetit në kushte të disfavorshme konkurrence me vendet fqinj.

P.sh. nënshkrimi i Marrëveshjes fillestare midis grupit ndërkombëtar, që zotëron projektin e gazsjellësit TAP dhe shtetit shqiptar, si vend pritës i investimit ishte për shtetin e disfavorshme, pasi norma e tatimit mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat në momentin e nënshkrimit ishte në nivelet e ulëta historike 10%. Ndërkohë, cdo rritje e ardhme e normave tatimore nga shteti shqiptar do të ishte subjekt rimbursimi për atë sa do të ishte rritja në raport me bazën e normës kur ishte firmosur Marrëveshja. Pas rinegociimit të Marrëveshjes fillestare duke shfrytëzuar klauzola që krijojnë mundësinë e rinegociimit, shteti shqiptar e rivendosi pozicionin e vet fiskal njësoj si shteti fqinj grek, i cili kishte nënshkruar të njëjtin model Marrëveshje më parë, por duke patur në zbatim norma tatimore që i përgjigjeshin një barre fiskale të lartë, në raport me Shqipërinë. Prandaj, studimet që matën në këtë rast ndikimin e MTD, por edhe Marrëveshjes midis palëve lidhur me fluksin e këtij investimi në vend u treguan "të ndjeshme" ndaj shqetësimit se vlera e vërtetë e përfituesve të MTD ishte të mos shkaktoje deformim të barazisë tatimore Brenda sistemit shqiptar tatimor, por edhe të shërbente si këndvështrim i ri lidhur me ndryshimin e modelit për investime të tjera në të ardhmen.

Me nënshkrimin e një MTD, nxitja e biznesit ndërkombëtar është të marrë fitimin duke u taksuar pak ose aspak me tatimin në burim për fitimet që do të transferojë në vendin e tij të rezidencës. Nga ana tjetër, duke u mësuar vetëm me lehtësira, investitorët bëjnë presion te qeveritë në momentet e nënshkrimit të Marrëveshjeve me ta edhe për kehtësira të tjera shtesë, krahas atyre që ju garantohen paraprakisht nga MTD dhe ligji specifik për investitorin.

Problem kryesor i nënshkrimit të një MTD midis një vendi të zhvilluar dhe një vendi të Ballkanit

Perëndimor është përpjekja për të zhvendosur lehtësirat fiskale të investimeve që do të ndodhin drejt vendit mikpritës të investimeve.

Përfitimi i vendeve të zhvilluara në këtë rast janë arkëtimet nga tatimet mbi të ardhurat, të cilat janë baza kryesore e të ardhurave buxhetore në vendet e tyre. Ndërkohë, që vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili bazohet mbi taksat e konsumit nuk i jepet mundësia për të rritur bazën e të ardhurave buxhetore me rritje të arkëtimeve të tatimeve mbi të ardhurat për të ndryshuar tendencën e buxheteve që pjesën më të madhe të arkëtimeve e kanë nga taksat mbi konsumin.

Ashtu si ka ndodhur me normat e tatimit mbi fitimin, po ashtu edhe normat e tatimeve mbi të ardhurat kanë qenë objekt konkurrence në vijimësi në rajonin e Ballkanit për të nxitur tërheqjen e investitorëve. MTD e instrumentalizojnë dhe e inkurajojnë më tej këtë politikë që po zbatojnë shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Por, në fakt secili shtet i Ballkanit Perëndimor ka hartuar edhe paketa për zona të lira ekonomike duke shtuar dozën e nxitjes edhe me lehtësira fiskale për segmente të caktuara të ekonomisë, apo zona gjeografike brenda secilit shtet. Ndërkohë, me miratimin e këtyre lehtësive, bashkë me Marrëveshje që në disa raste kopjohen nga modele të këqia të nënshkruara më parë çojnë në krijim të shtrembërimeve të parimeve fiskale, por edhe ndikim në performancën e buxhetit me raste të caktuara.

Një përvojë mund ta përmendim nga Shqipëria. Megjithëse, investitorë të mëdhenj kanë mbi një dekadë që shfrytëzojnë burimet natyrore shqiptare, nisur nga përfitimet nga MTD, por edhe nga Marrëveshje specifike që kanë qenë objekt lobimi nuk kanë kontribuar pothuajse asnjëherë në buxhet me tatim mbi dividendin, apo qoftë edhe me tatime të tjera, të cilat janë objekt debati në vijimësi, mes tyre dhe administratës fiskale shqiptare.


1.12. Efekti i politikës fiskale dhe qasja e administrimit

Edhe pse rritja e barrës fiskale duket si rruga më e lehtë për ngushtimin e deficitit buxhetor, kjo nuk është e vërtetë. Argumenti kryesor është se barra fiskale planifikohet të rritet në të njëjtën kohë me investimet private (të huaja dhe

vendase). Ky planifikim ka ndikuar që presioni buxhetor të jetë më pak i ndjeshëm dhe në anën tjetër investitorët janë ndier më të relaksuar lidhur me kthimin e investimeve të tyre.

Niveli aktual i barrës fiskale jo gjithmonë vjen nga normat e ulta, por në rastin e Ballkanit ndikimi i normave të ulta përkthehet me një rrjedhojë direkte të një barre të ulët. Arsyeja qëndron te niveli i informalitetit, korrupsioni dhe sistemi tatimor ende i paharmonizuar me ekonominë dhe tregun. Por edhe lehtësirat fiskale dhe përjashtimet tatimore kanë një ndikim deri në 1-2% të PBB-së në rajon duke ulur *de facto* barrën fiskale, të secilit shtet, që zbaton politikat lehtësuese dhe përjashtuese nga taksat.

Rritja e barrës së tatimit mbi vlerën e punës (tatimi mbi të ardhurat personale) dhe ndaj kapitalit (tatimi mbi fitimin) në një qasje progresive kryesisht mbi pjesën formale të të ardhurave janë efekti më i madh në barrën fiskale, që ka prurë tatimi progresiv i pagave dhe tatimit mbi fitimin, përveç lehtësimit në tërësi të pagave për punëtorët e pakualifikuar me paga të ulëta, të cilat kanë ndikim si në rritjen e bazës së tatimit, po ashtu edhe në rritjen e fitimit nga bizneset. Ky fakt rezulton kur shikojmë në grafikun më poshtë tendencën e të ardhurave nga TAP dhe TF për periudhën 2014-2018 me një rritje respektive të tyre me 26.7% dhe 60.7% (edhe pse gjysma e kësaj rritje për tatim fitimin i shkon rritjes së normës tatimore në 2014).



Viti 2018 është i katërti vit i zbatimit të ligjit të TVSH-së. Kjo periudhë konsiderohet një periudhë e konsolidimit të këtij tatimi që ruan një peshë sa 35% e të ardhurave të buxhetit gjithsej. Përgjatë 5 viteve të fundit, për kategori të caktuara aktivitetesh normat e TVSH janë reduktuar në nivelin e 6% dhe 10%. Rritja e të ardhurave nga TVSH gjithsesi ka patur një rritje me 18.4%, që përkon me rritjen e PBB-së për 5 vitet e fundit.

Viti 2018 është i katërti vit fiskal i zbatimit të politikës fiskale të progresivitetit të normave

tatimore¹⁵ në Shqipëri i orientuar për tatimin e kapitaleve dhe të punës edhe pse në fakt është zbatuar përgjithësisht mbi pagat. Nisur nga rezultatet e mbledhjes së tatimit mbi të ardhurat personale arrijmë të krahasojmë efektet e tij në performancën buxhetore duke kuptuar edhe diferencat që vijojnë të jenë midis politikës dhe administrimit fiskal.

Efekti i ndryshimeve ligjore ka patur një efekt të dobët të lufta ndaj informalitetit, në raport me rritjen e nivelit nominal të të ardhurave. Më shumë angazhim duhet të bëhet për të shqyrtuar efektin e ndryshimeve të prejdurura nga politika tatimore që konkurron me atë rajonale, si për normat e tatimeve, po ashtu edhe me tarifatat doganore. Por, ajo që nevojitet për politikëbërjen është përshtatja e barrës fiskale me kurbën e performancës së ekonomisë.

Një nivel i lartë i barrës fiskale duket se është i vështirë të aplikohet në Shqipëri, nisur nga fakti se tradita e trashëguar para viteve '90 me nivelin e barrës 46% deri 48% duhet të justifikohet tashmë me barrën që po zhvendoset në avancë për të ardhmen nëpërmjet aplikimit të partnershit privat-publik. Edhe pse këto projekte perceptohen se do të rritin kontributin në ekonomi, një ndërlidhje më të mirë të rajoneve dhe ulje të kostos së transporti, por edhe një penetrim më të madh të nivelit të teknologjisë, ende ka shumë elementë që mbeten pa sqaruar dhe nuk përfshihen në transparencën lidhur me fatin e barrës fiskale.

Në vendet e Ballkanit me produktivitet të ulët të ekonomive, mosrritja e barrës fiskale ka efekt negativ në rritjen e PBB-së. Ulja e barrës fiskale do të rezultonte në uljen e PBB-së, pasi nxitja që japin taksat për ekonominë konsiderohet se kanë ende një efekt me peshë për zhvillimin e kapitaleve dhe tregut të brendshëm.

Ofertat populiste për ulje të normave tatimore të disa politikaneve ballkanike, ku më e theksuar kjo frymë është te shqiptarët me deklarata se bëhen për qëllime të rritjes së ekonomisë dhe nxitjes së investimeve kanë rezultuar në realitetin ekonomik dhe social si jo të vërteta dhe me efekt regresiv në funksion të objektivave të shpallura.

Këto oferta politike pa bazë dhe mbështetje në realitetin ekonomik të vendeve ballkanike kanë pakësuar produktivitetin ekonomik dhe

investimet kapitale duke luhatur besimin e investitorëve. Në këtë mënyrë, uljet e normave tatimore, të konceptuar si të palidhura me politikat dhe reformat e tjera të ndërmarra apo të filluara nga qeveritë kanë ndikuar përgjithësisht në rritjen e deficiteve buxhetore.

Administrimi fiskal në 2019, si në Shqipëri dhe në Kosovë duhet të fokusohet te segmenti i individëve me të ardhura të nivelit të lartë.

Kjo kategori taksapaguesish është më pak e rënduara nga tatimet dhe taksat në dekadat e fundit. Ulja e barrës së taksave duhet të lirojë familjen me të ardhura të mesme. Menaxherët e kualifikuar dhe punonjësit e mirëpaguar duhet të jenë segmenti për normën më të lartë tatimore duke marrë realisht pagesat e larta. Norma më e lartë e tatimit është tashmë e në zbatim, nëse të ardhurat e një individi arrijnë 1.8 herë më lart se të ardhurat mesatare.

Për të realizuar lehtësime të konsiderueshme tatimore, norma më e lartë e taksave duhet të jetë vetëm për të ardhurat e tatueshme mbi nivelet që vërtet konsiderohen si të ardhura përtej raportit paga e lartë/ pagë mesatare me 1.8 herë. Nevojitet që pragu i pagës së patuar prej 30.000 lekë të hiqet dhe të gjenden forma të tjera kompensuese për vlerën e tatimit që mund të mbahet për pagat nën këtë nivel.

¹⁵ Niveli i sheshtë mbi tatimin e fitimit dhe tatimit mbi të ardhurat personale u zëvendësua në 2014 me tatimin progresiv.


2. Barra Fiskale në Shqipëri

Barra e buxhetit përfshin gjithë pagesat tatimore e doganore, kontributet e sigurimeve, por edhe tarifatat dhe derdhjet në buxhet nga institucionet publike dhe shoqëritë publike pagesat që kanë detyrim për mallra dhe shërbime të ndryshme.

Barra fiskale është pjesë e barrës së të ardhurave të buxhetit.

2.1. Performanca e barrës së buxhetit dhe barrës fiskale

Buxheti ka marrë nga kontribuesit në vitin 2018 të ardhura sa 27.5% e PBB-së. Barra e të ardhurave të buxhetit ka një rritje të vogël me vetëm 1.2% të PBB-së në 5 vitet e fundit (shih grafikun).



Struktura e të ardhurave në mënyrë më të detajuar shihet më lart në tabelën 12.

Tab. 12

PESHA SIPAS STRUKTURËS	2014	2015	2016	2017	2018
Ndihmat	3%	3%	4%	3%	2%
Tatimet dhe Doganat	69%	68%	68%	68%	68%
Pushtetit Vendor	3%	3%	4%	4%	5%
Sigurimi Shoqëror	17%	16%	16%	17%	18%
Sigurimi Shëndetësor	2%	3%	3%	3%	3%
Jotatimore	6%	7%	6%	5%	5%
Për kompensim në vlerë të pronarëve	0.1%	1%	0.4%	0.3%	0.3%
Ndryshimi midis viteve		3.4%	7.3%	5.7%	4.4%

Nga krahasimi i dy treguesve buxhetorë më lart, barra fiskale në 2018 përbën 93% të gjithë të ardhurave buxhetore. Pjesa tjetër e mbetur përbëhet nga të ardhurat jotatimore (5%) dhe Ndihmat (2%).

Barra fiskale, në të cilën përfshihen kontributet e individëve taksapagues dhe bizneseve të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit është sa 25.4% e PBB-së. Për vitin 2019 kjo barrë

synohet të rritet me 0.1% të PBB dhe të arrijë në nivelet e një barre fiskale sa 25.5% e PBB.

Ashtu si barra fiskale e ulët në Shqipëri mund të pengojë rritjen, po ashtu edhe mangësitë në kapacitetet fiskale shërbejnë si shkak kryesor i një qeverisje të dobët.

Barra fiskale përgjatë viteve 2014 - 2018 është rritur 25%. Rritja më e madhe është ndikuar nga politika fiskale e taksimit progresiv, reforma e decentralizimit fiskal, si dhe nga zgjerimi bazës kontributive të TVSH, që ka rritur kontributin e saj e shoqëruar edhe me një rritje 50% të vlerës së rimbursimit të TVSH.

Tab.13

PESHA SIPAS STRUKTURËS	2014	2015	2016	2017	2018
Tatimet dhe Doganat	75.5%	76.1%	74.9%	73.8%	72.8%
Pushtetit Vendor	3.7%	3.4%	4.1%	4.6%	5.2%
Sigurimi Shoqëror	18.3%	17.7%	18.1%	18.6%	19.0%
Sigurimi Shëndetësor	2.4%	2.8%	2.9%	2.9%	3.0%
Ndryshimi midis viteve		5.3%	8.2%	7.9%	5.2%

Detajet e ndryshimit të peshës së gjithë përbërësve të barrës fiskale ashtu si shihen në

Tab.14

PESHA SIPAS STRUKTURËS	2014	2015	2016	2017	2018
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	52.6%	51.6%	50.9%	52.3%	51.9%
nga administrata tatimore	14.2%	14.6%	15.5%	11.9%	16.7%
nga administrata doganore	38.4%	36.8%	35.4%	35.6%	35.2%
minus Rimbursimi TVSH	3.8%	3.0%	3.2%	4.7%	4.7%
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto)	48.8%	48.6%	47.6%	47.6%	47.2%
Tatimi mbi Fitimin	8%	10%	10.6%	10.8%	11.3%
Akcizat	16%	15%	15.2%	15.4%	14.8%
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	11%	11%	11.4%	10.9%	12.0%
Taksa Nationale dhe të tjera	13%	13%	13.0%	13.1%	12.7%
Taksa Doganore	2%	2.2%	2.2%	2.2%	2.0%
Ndryshimi midis viteve		2.2%	6.5%	6.4%	3.7%

tabelën 13 veçojnë ndryshimin e madh në 5 vite të peshës së taksave vendore (ritje 76%), kontributit të sigurimeve shëndetësore (ritje 50%) dhe atyre shoqërore (ritje 29%). Ndërkohë, të ardhurat nga tatimet dhe doganat kanë rritje që shkon njësoj me rritjen ekonomike dhe inflacionin.

Ndërsa në Tabelën 14, shihet se struktura e të ardhurave tatimore (pa taksat vendore dhe kontributet e sigurimeve) dominohet mbi gjysmën nga TVSH, e cila në mbi 2/3 e saj mbledhet nga importet në dogana.

Edhe pse kanë kaluar 5 vite nga skema e taksimit progresiv nuk është zgjeruar një bazë të konsiderueshme, e cila të fillojë të bëjë ndryshimin e varësisë së të ardhurave tatimore nga importi. Kjo mbetet sfida më e madhe për politikën fiskale, por edhe për administrimin që duhet të shfrytëzojë burimet në funksion të zgjerimit të bazës tatimore.

2.2. Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacionit të buxhetit

Barra fiskale është një tregues që merr një kuptim të veçantë për Shqipërinë, nisur nga konteksti ekonomik dhe social me variacione të luhatshme, si dhe me probleme të stabilitetit politik, social dhe fiskal. Nga ana tjetër, një arsye pse ndodhin është edhe transparenca për mënyrën si shpërndahen taksat dhe kontributet që dalin nga buxheti i shtetit.

Tab.15


PESHA SIPAS STRUKTURËS	2014	2015	2016	2017	2018
Shpenzimet për pagat dhe kontributet	16%	17%	16%	16%	15%
Shpenzime për mirëmbajtje	8%	10%	10%	9%	10%
Shpenzimet për kontributet, pronarët	31%	32%	35%	35%	35%
Shpenzime papunësi, ndihmë, ish-përndjek	6%	5%	5%	5%	5%
Shpenzime investime kapitale	14%	14%	14%	15%	16%
Shpenzime për buxhetin vendor	8%	8%	10%	10%	10%
Pagesat e borxhit dhe interesat	9%	9%	8.4%	6.9%	7.7%
Subvencione, Huadhënie, Shpronësime, etj	9%	6%	1.7%	2.5%	0.5%
Ndryshimi midis viteve	11.3%	-0.3%	-0.8%	6.1%	3.5%

Në një panoramë përmbljedhëse të shpërndarjes së shpenzimeve të buxhetit 2018¹⁶, sipas tabelës 15, destinacioni kryesor i përket:


- **Fondeve sociale**, pagesave për të papunët, për shtresat sociale, për ish-të përndjekurit, si dhe pagesat për pronarët (40% e buxhetit);
- **Shpenzimet kapitale** (për investime) në 2018 zënë vendin e dytë në destinacionin e përdorimit nga buxheti (16% e buxhetit);
- Në vend të tretë janë **shpenzimet për pagat dhe kontributet e sigurimeve** të administratës së institucioneve të shtetit (15% e buxhetit);
- Destinacionet e radhës janë (a) shpërndarja e fondeve **për pushtetin vendor** (10% e buxhetit), si dhe (b) fondet **për mirëadministrimin dhe mirëmbajtjen e pronës publike** (10% e buxhetit);
- Destinacioni i parafundit i shpërndarjes së fondeve të buxhetit shkon për **pagesat e borxheve të qeverisë** (8% e buxhetit), si dhe;
- **1% e buxhetit** shkon për **shpronësimet e projekteve publike, subvencione dhe hua** bazuar në vendimet e qeverisë.

Në grafikun ku paraqitet shpërndarja e fondeve sociale (40% e buxhetit), sipas 6 destinacioneve


të ndryshme¹⁷ pesha kryesore i takon fondit të sigurimeve shoqërore (66%) për pagesat e përfitimeve për pensione, barrë lindje, aksidente në punë, sëmundje. Tjetër zë ku destinohen këto shpenzime janë për fondin e kujdesit shëndetësor (21%). Ndërsa ndihma ekonomike merr 11% të fondeve sociale. Pjesa e mbetur shkon për papunësinë, kompensimin për ish të përndjekurit politikë, si dhe kompensimin për pronarët (të treja bashkë 2% të fondeve).



Në grafikun më poshtë paraqitet destinimi i shpenzimeve kapitale (16% e buxhetit). Këto shpenzime financohen në 2/3 e tyre nga financimet e buxhetit me fondet e veta dhe 1/3 me fondet e huaja.



Shpenzimet për administratën e shtetit (15% e buxhetit) shpërndahen në mbi 4/5 e tyre për pagat dhe afër 1/5 për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.



Fondet për pushtetin vendor si transferta dhe financime të projekteve zhvillimore janë me rritje 50% përgjatë 5 viteve të fundit¹⁸.

¹⁶ Në vitin 2014 buxheti i shtetit për shpenzime ishte 3.1 miliard Euro. Në 2018 ky buxhet është 3.8 miliard.

¹⁷ 1.Sigurime Shoqërore; 2.Sigurime Shëndetësore; 3.Ndihma ekonomike; 4.Kompensime për ish të përndjekurit politikë; 5.Kompensime për pronarët; 6.Pagesa e papunësisë
¹⁸ nga 8% e buxhetit në 2014 janë 10% e buxhetit në 2018

Por, si janë të planifikuara shpenzimet në raport me të ardhurat e arkëtuara në këto 5 vite e fundit?

Tab.16

Shpenzimet ndaj të ardhurave	2014	2015	2016	2017	2018
Shpenzimet për personelin	19%	19%	17%	17%	16%
Shpenzime sociale	44%	43%	43%	43%	42%
Shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes	9%	11%	11%	10%	10%
Shpenzimet kapitale	17%	17%	15%	16%	17%
Shpenzime për buxhetin vendor	9%	9%	11%	11%	11%
Shpenzimet e borxhit dhe të tjera	21%	17%	11%	10%	9%
Subvencionet, borxhet e paguara kanë ndikuar në uljen e deficitit	20%	15%	7%	7%	5%

Nga tabela 16 shihet se shpenzimet për administratën kanë pësuar rënie në 5 vite. Në vitin 2018, shteti paguan:

- **42%** të të ardhurave për destinacionet sociale;
- **17%** të të ardhurave buxhetore për investimet kapitale që përfshijnë kontrata të lidhura që zgjasin disa vite buxhetore, por edhe investime të reja;
- **16%** të të ardhurave të buxhetit për personelin e punësuar;
- **11%** të të ardhurave të buxhetit për pushtetin vendor transferohen;
- **10%** të të ardhurave për shpenzimet operative dhe mirëmbajtjen e pronës shtetërore;
- **4%** të të ardhurave dhe **5.6%** nga borxhe të reja shkojnë për pagesën e borxhit dhe interesave të tij.

Nga ky ballafaqim i përpunuar për qëllime krahasimi se si destinohen të ardhurat nga taksat dhe të ardhurat jotatimore dhe ndihmat shihet se pjesa më e madhe e shpenzimeve të buxhetit ka filluar të administrohen efektivisht, pasi shihet se diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve është ulur me 14% për 5 vite.

Tabela 17 është një pjesë e shkëputur nga buxhetet e shtetit të 5 viteve (2014-2018), për të ilustruar idenë se si financohet nga buxheti një shpenzim, që nuk mbulohet dot nga të ardhurat që janë destinuar për ta financuar atë shpenzim.

Tab.17

Të ardhurat sociale ndaj shpenzimeve sociale	2014	2015	2016	2017	2018
Taksat mbi punën (sociale)	98,544	99,404	108,920	117,703	128,383
Shpenzimet sociale*	171,807	171,407	184,612	195,564	200,557
Diferenca e pambuluar nga taksat mbi punën (mbulohet nga taksat të tjera)	-73,263	-72,003	-75,692	-77,861	-72,174
Raporti të ardhurave sociale ndaj shpenzimeve sociale	57%	58%	59%	60%	64%
<small>* përfshihen edhe kontributet për pagat e administratës shtetërore</small>					
Pesha e kompensimit në shpenzimet gjithësej të buxheti	-20%	-19%	-19%	-18%	-16%
Pesha gjithësej e shpenzimeve sociale në buxhet	37%	37%	40%	40%	40%

Shpenzimet sociale, që destinohen për 6 kategoritë e përmendura më përpara arrijnë në shumën 200.5 miliard lekë për tu destinuar nga buxheti i vitit 2018. Ndërkohë, të ardhurat e arkëtuara nga buxheti, nëpërmjet taksave për punën¹⁹ arrijnë në shumën 128.4 miliard lekë.

Vetëm 64% e të ardhurave mbulojnë shpenzimet me destinim fondet sociale. Në këtë rast, Ministria e Financave alokon burime shtesë që në fillim të planifikimit buxhetor, me qëllim që të mos cënohet zbatimi i politikave sociale. Këto fonde shtesë në nivelin e 16% të të ardhurave gjithësej të buxhetit të vitit 2018 do të merren nga taksa që duhet të përdoren për tjetër shpenzim dhe alokohen për të mbyllur gjithë fondin e planifikuar nga buxheti për politikën sociale.

Tab.18

Të ardhurat e pushtetit vendor ndaj buxhetit vendor	2014	2015	2016	2017	2018
Të ardhurat nga taksat vendore	12,447	11,700	14,951	18,448	21,862
Shpenzimet për buxhetin vendor	32,985	34,066	43,580	46,487	49,607
Totali buxhetit vendor	45,432	45,766	58,531	64,935	71,469
Raporti i taksave vendore ndaj buxhetit vendor	38%	34%	34%	40%	44%

Në tabelën 18 paraqitet një tjetër moment i alokimit të shpenzimeve buxhetore lidhur me financimin e pushtetit vendor nga fondet e buxhetit të shtetit. Në vitin 2018, pushteti vendor (61 bashki) kanë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit 21.8 miliardë lekë. Ndërsa, shpenzimet gjithësej të realizuara janë 49.6 miliardë lekë, të ndara sipas kërkesave për kryerje shpenzimesh në (a) shpenzime për personelin e administratës, (b) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje të pronës, (c) për transfertat në shtresat në nevojë dhe politika lokale, (d) për investime kapitale.

Totali që shpenzoi pushteti vendor në 2018 ishte 71.4 miliard lekë, që përfshin arkëtimet nga taksat dhe tarifatat dhe të ardhura nga qeradhënie etj., si dhe fondet që përfitohen si transfertat nga secila bashki. Sipas raportit midis të ardhurave të arkëtuara nga pushteti vendor me shpenzimet që ka realizuar në vitin 2018, mesatarisht vetëm 44% të tyre arrijnë të mbulojnë bashkitë nga fondet e veta.

Ndërkohë, pjesa e transfertës nga buxheti për të merret nga taksat e paguara pa një destinacion të caktuar (p.sh. të ardhurat nga TVSH). Në këtë formë komunikimi të buxhetit me destinimin e shpenzimeve shikohet se transparenca duhet të synojë pikërisht përtej këtyre vlerave. Pra, synimi

¹⁹ taksat sociale, që përfshijnë tatim mbi të ardhurat nga paga, si dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

për një transparencë të mundshme duhet të arrijë në ballafaqime në nivel vendor, për të arritur më tej edhe në ballafaqimin e shpenzimeve që kryhen në nivel qendror dhe sa mbulohet nga e ardhura që nevojitet për tu mbledhur për tu kryer shpenzimi.

Tab.19

Tejkalimi shpenzimeve ne raport me te ardhurat	2014	2015	2016	2017	2018
Shpenzimet për personelin	-3%	-3%	-1%	-1%	-1%
Shpenzime sociale	-7%	-6%	-3%	-3%	-2%
Shpenzimet operative dhe mirëmbajtje:	-1%	-1%	-1%	-1%	-1%
Shpenzimet kapitale	-3%	-2%	-1%	-1%	-1%
Shpenzime për buxhetin vendor	-1%	-1%	-1%	-1%	-1%
Shpenzimet e borxhit dhe të tjera	-4%	-2%	-1%	-1%	-0.5%

Në tabelën 19 është paraqitur ballafaqimi i të ardhurës me destinacion për kryerjen e shpenzimit që i përket asaj të ardhure. Sinjalizimi i parë është rënia e nivelit të shpenzimit në raport me të ardhurën për kryerjen e shpenzimit. Më e dukshme është për shpenzimet sociale, si dhe për shpenzimet e borxhit. Të dy këto grupe shpenzimesh tregojnë si për performancë më të mirë në të ardhurën e dedikuar për to, ose jo, si dhe për uljen e kostove për shërbimet publike, njësoj si në rastin e uljes së kostos së shërbimit të borxhit, nëpërmjet daljes në tregjet ndërkombëtare me Eurobondin.

Por, përtej analizës së treguesve të buxhetit nevojitet një verifikim i thelluar lidhur me

- (a) cilësinë e shpenzimeve,
- (b) moskrijimin e borxheve të reja për buxhetet e ardhme, që do të thotë një rritje e barrës së ardhme
- (c) dhe verifikimin nëse shpenzimet janë të mirëorientuara për zhvillimin e ekonomisë apo përfaqësojnë interesa klienteliste dhe lënë hapësirë për abuzim me fondet e buxhetit, e të tjera argumenta.

Debati për barrën fiskale duhet të fillojë të ndërtohet si një kulturë e re e opinionit publik. Në fakt duhet të jenë organizatat dhe shoqëria civile e organizuar, të cilat në kuadër të nismës globale për qeverisje të hapur duhet të synojnë të marrin si jë të drejtë të tyre nga qeveria transparencën e buxhetit. Kjo kulturë duhet të mbajë të hapur kanalën e dialogut social me qeverinë, e cila nga njëra anë të japë llogari për vendimet e saj dhe nga ana tjetër taksapaguesit të mos ndihen të lidhur me vullnetin e qeverisë për çdo hap të jetës. Për shkak se të ardhurat tatimore janë relativisht të parashikueshme, qeveritë mund të planifikojnë përpara me siguri më të madhe.

2.3. Barra e të ardhurave fiskale të bashkive

Të ardhurat nga tatimet, taksat, tarifatat dhe shërbime të lidhura me pronë publike apo biznese publike janë pjesë e të ardhurave që administrohen direkt nga pushteti vendor. Në një analizë të strukturës së të ardhurave buxhetore të 61 bashkive në Shqipëri, 44% e të ardhurave vijnë nga tatimet, taksat dhe tarifatat dhe 8% vijnë nga të ardhurat e tjera. Pjesa e mbetur prej 48% kompletohet nga transfertat nga buxheti i shtetit sipas formulës së përcaktuar në ligjin e buxhetit, si dhe nëpërmjet alokimit të të quajturave Grante konkurruese, për projekte specifike në bashki të veçanta.

Në analizën e taksave vendore që paguajnë banorët për llogari të pushtetit vendor, politika fiskale e ka orientuar barrën fiskale kryesisht mbi individët që janë rezidentë në qytete dhe më pak mbi individët që janë rezidentë në fshat. Nisur nga fakti që 52% e popullsisë është me rezidencë fiskale në njësitë bashkiake të fshatrave, atëherë ky grup social i popullsisë është edhe më i lehtësuari nga barra fiskale e pushtetit vendor.

Pesha e barrës së tatimeve, taksave dhe tarifave vendore përbëhet kryesisht nga dy zëra kryesorë: (a) grupi i taksave vendore, që është e drejtë e Këshillave Bashkiakë për të bërë uljet-ngritjet në masën 30% mbi normat zyrtare, (b) tatimi mbi pasurinë, i cili nga viti 2019 do të ndryshojë mënyrën e llogaritjes dhe taksimit duke kaluar si një tatim që aplikohet mbi vlerën e pasurisë. Në gjithë këto afër 3 dekada ky tatim është orientuar të taksojë sipërfaqen me tarifa që kanë qenë të ndryshme nga njera bashki në tjetrën, sipas kategorisë që ato mbajnë. Taksat vendore dhe tatimi i pasurisë së bashku përbëjnë 44% të të ardhurave në dispozicion të Bashkive.

Tab.20

Pesha ndaj totalit të të ardhurave buxhetore	2014	2015	2016	2017	2018
Pushteti Vendor	3%	3%	4%	4%	5%

Pesha e të ardhurave që arkëton pushteti vendor nëpërmjet administratës së taksave që ka çdo bashki zë 5% të gjithë të ardhurave të Buxhetit dhe shpenzon 10% sa 10% e të ardhurave të buxhetit.

Pjesa tjetër e të ardhurave në dispozicion të bashkive, e cila është sa 5% e buxhetit të shtetit u alokohet, sipas ligjit të buxhetit nga të ardhurat që arkëtohen nga tatime dhe taksa që arkëtohen nga administratat fiskale qendrore. Nëse nisemi

nga logjika e rezidencës fiskale, rreth 30% e bizneseve në nivel vendi kanë vendodhjen e aktivitetit të tyre në zonat jashtë qyteteve. Kjo pjesë më së shumti i përket taksave dhe tatimeve që paguajnë këto biznese në buxhetin qendror, për llogari të DPT.

Barra fiskale për taksat & tarifatat vendore, që paguajnë bizneset e vogla, individët dhe familjet përbëhet nga:

1. Taksa mbi pasurinë (0.05% të vlerës së ndërtesave të banimit dhe 0.3% të banesave tregtare; mbi sipërfaqen e tokës bujqësore; mbi sipërfaqen e truallit të ndërtimit)
2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël (5% për bizneset me xhiro vjetore 5-14 milionë lekë dhe 0% për bizneset me xhiro vjetore 0-5 milionë lekë)
3. Taksa e fjetjes në hotel
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme
6. Taksa e tabelës
7. Taksa e përkohshme e tregut
8. Tarifa e gjelbërimit
9. Tarifa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave
10. Tarifa e plazheve private (për zonat bregdetare)
11. Tarife për leje për përdorim struktural
12. Tarifa e parkimit të automjeteve
13. Tarifa e ndricimit
14. Tarifa për zënien e hapësirës publike
15. Tarifatat e shërbimit administrativ të Bashkisë
16. Tarifa për transportin publik
17. Tarifa e autorizimeve për tregtim karburanti
18. Tarifa e autorizimeve për qarkullimin në qytet
19. Tarifa për dhënie të lejeve për ushtrim veprimtarie
20. Tarifa e shërbimit veterinar
21. Tarifa e urbanistikës
22. Tarifa e institucioneve të Bashkisë
23. Taksa të administruara nga agjentët tatimorë

Kur analizojmë se sa është barra fiskale, që paguajnë direkt individët dhe bizneset për llogari të pushtetit vendor duhet mbajtur në konsideratë që ata mbajnë edhe barrën nga tatimet dhe taksat e buxhetit të shtetit (tatime mbi konsumin dhe tatime mbi të ardhurat, si dhe kontribute të sigurimeve dhe taksa kombëtare).

Të ardhura Vendore, Viti 2018 000 Lekë		
Rnd.	Bashkia	Taksa dhe Tarifa Vendore/Banor
1	Mallakaster	28.0
2	Roskovec	27.0
3	Himare	24.8
4	Tirane	21.9
5	Delvine	19.6
6	Kamez	16.5
7	Pogradec	14.9
7	Sarandë	14.9
8	Vore	13.4
9	Vlore	12.8
10	Korçë	12.2
10	Lezhë	12.2
11	Elbasan	11.2
12	U.Vajgurore	10.4
13	Skrapar	10.3
14	Kukës	10.2
15	Klos	9.7
16	Gjirokaster	9.2
17	Berat	8.8
18	Maliq	8.4
19	Durrës	8.2
19	Konispol	8.2
20	Patos	8.0
21	Kolonjë	7.7
21	Polican	7.7
22	Permet	7.5
23	Belsh	7.1
23	Kavajë	7.1
24	Cerrik	7.0
25	Rrogozhinë	6.6
25	Dropull	6.6
26	Shijak	6.5
26	Divjake	6.5
27	Selenice	6.4
28	Fier	6.3
29	Krujë	6.0
30	Tepelene	5.8
31	Shkodër	5.7
31	Finiq	5.7
32	Kucovë	5.5
33	Prrenjas	5.1
33	Devoll	5.1
34	Vau i Dejës	5.0
34	Peqin	5.0
35	Pukë	4.6
35	Mat	4.6
36	Libohovë	4.4
37	Kelcyre	4.2
37	Librazhd	4.2
38	Gramsh	3.8
39	Fushë-Arrez	3.7
40	Memaliaj	3.5
40	Mirditë	3.5
41	Malesi e Madhe	3.1
42	Lushnjë	3.0
43	Bulqizë	2.9
44	Pustec	2.8
45	Tropojë	2.7
45	Kurbin	2.7
45	Dibër	2.7
46	Has	1.0
Mesatare		13.2

Burimi: Pushteti Vendor

Nga llogaritja e barrës fiskale nisur nga miratimet e buxheteve të bashkive për vitin 2018 në raport me numrin e banorëve, që ka të regjistruar secila nga 61 bashkitë rezultojnë një renditje e tyre në varësi të rezultatit në tabelën në krah.

Banorët e bashkisë së Mallakastrës²⁰ mbajnë vendin e 1^{erë}, si më të ngarkuarit me barrë fiskale vendore, me një ngarkesë vjetore 28 mijë lekë për banor. Roskoveci dhe Himara mbajnë vendin e 2^{te} dhe të 3^{te} për barrën fiskale të lartë, respektivisht me 27 mijë lekë/banor dhe 24.8 mijë lekë/ banor. Tirana mban vendin e 4^t për barrë vendore, 21.9 mijë lekë/banor. Delvina në vend të 5^{te}, Kamza në vend të 6^{te} dhe Pogradeci e Saranda në vend të 7^{te}, respektivisht me 19.6 mijë lekë/banor, 16.5 mijë lekë/banor dhe 14.9 mijë lekë/banor. Në vend të 8^{te} është Vora me 13.4 mijë lekë/banor. Në vend 9^{te} është Vlora me 12.8 mijë lekë/banor. Në vend të 10^{te} janë dy bashki, Korça dhe Lezha me 12.2 mijë lekë/banorë. Banorët e Bashkisë së Hasit mbajnë barrën vendore më të ulët në Shqipëri me 1 mijë lekë/banor.

Bashkitë e mëdha, si Fieri, Shkodra, Elbasani kanë barrë fiskale vendore të ulët, poshtë mesatares së barrës për 61 bashkitë (13.2 mijë lekë/banor).

²⁰ Migrimi i brendshëm dhe emigrimi jashtë vendit i popullsisë ndikon në rritjen e barrës për qarqet periferike dhe të vogla. Popullsia është më pak me 35%, se regjistri i gjendjes civile. P.sh. Mallakastra është pakësuar me 41% të popullsisë

Kutia 1. Llogaritja e barrës fiskale për qarqet

Llogaritja

Barra fiskale për qarqet e vendit është bazuar mbi të dhënat mbi bazë qarku. Në të ardhurat që llogariten si barrë tatimore përfshihen detyrimet e paguara nga biznesi i regjistruar në drejtoritë rajonale tatimore, si dhe për ato pagesa të taksave dhe tarifave vendore që bëjnë pjesë në të ardhurat tatimore, sipas përfshirjes që bëhet në buletin fiskale.

Të dhënat statistikore janë marrë nga buletini informativ i Instat, nga të dhëna të tjera të publikuara nga administratat tatimore, doganore dhe vendimet e raportet vjetore të miratuara nga pushteti lokal, të kryqëzuara me të dhënat e publikimeve të Fondit Monetar, Bankës Botërore, si dhe të studimeve të kryera për Shqipërinë nga projekte vendore, të cilat kanë shërbyer si referencë për llogaritjen e barrës fiskale dhe treguesve të tjerë krahasuesë.

Për llogaritjen e prodhimit të brendshëm të qarkut për vitin 2016 janë vlerësuar nga ekspertët tanë edhe botimi i Institutit të Statistikave si dhe tendenca rajonale e strukturës së prodhimit të brendshëm në tre vitet e mëparshme ndaj mesatares.

Për llogaritjen e detyrimeve doganore janë llogaritur arkëtimet e degëve doganore dhe alokimi i arkëtimeve prej tyre, sipas mallrave dhe pikave të hyrjes së tyre të kryqëzuara me konsumin dhe aktivitetet ekonomike në qark.

Ndërsa tatimet e paguara nga shoqëritë më të mëdha janë llogaritur si një barrë fiskale që i përket Tiranës, por dhe vendodhjes së tyre në disa nga qarqet ku kanë selitë e tyre të biznesit në qytete kryesore si: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë. Pas përcaktimit të tatimeve të paguara sipas qareve është bërë raporti me prodhimin e brendshëm sipas qarkut përkatës duke rezultuar në raportet e paraqitura në analizë.

Llogaritja e të ardhurave vendore për bashkitë është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacioni i përfituar nga programi buxhetor i taksave dhe tarifave vendore, në realizimin e tyre, si dhe në politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, sipas akteve ligjore për to.

Në këtë llogaritje gabimi arrin deri në $\pm 3\%$.

2.4. Barra fiskale rajonale ndaj PBB-së në Shqipëri

Në barrën fiskale në vlerë rezultati del nga raporti i tatimit/taksës së arkëtuar në buxhetin e shtetit me numrin e banorëve.

Barra Fiskale gjithsej, 2018		000 Lekë
Renditje	Qarku	Barra fiskale/ Banor
1	TIRANE	214.6
2	GJIROKASTER	206.7
3	DURRES	190.1
4	VLORE	127.3
5	FIER	111.3
6	SHKODER	104.4
7	KUKES	97.4
8	LEZHE	95.9
9	KORCE	93.9
10	DIBER	82.3
11	ELBASAN	81.4
12	BERAT	74.8

Burimi: MFE

Për të krijuar një perceptim të përgjithshëm përse lidhet me faktin se sa barrë fiskale mesatare i takon secilit individ, që është rezident fiskal në Shqipëri, pavarësisht nëse është taksapagues aktiv ose jo, nga tabela në krahasim shihet se në varësi të qarkut ndryshon edhe barra fiskale mesatare për banor. Kështu, barra

fiskale mesatare për banor në qarkun e Tiranës është 214.6 mijë lekë/vit. Ndërsa, në qarkun e Beratit është 74.8 mijë lekë në vit. Në këtë raport nuk janë përfshirë të ardhurat jotatimore dhe ndihmat. Këto vlera të barrës fiskale për banor janë të lidhura me kontributet e secilit qark në buxhet. Natyrisht që elasticiteti i barrës fiskale nga njeri qark në tjetër ka nevojë të nënshtrohet studimeve të posaçme për të marrë në shqyrtim faktorët ndikuesë dhe elementët përbërës të saj. Një konkluzion paraprak prej analizës mund të rezultojë faktori i administrimit fiskal, që ndryshon pasi ndikohet nga faktorë subjektivë dhe objektivë.

Një tregues interesant për shpërndarjen e barrës në Shqipëri është edhe barra e tatimit mbi vlerën e shtuar për secilin individ. Në vitin 2018 për këtë tatim ka kontribuar në buxhet secili individ rezident fiskal shqiptar, por dhe jorezidentët (të huajt), për pjesën e konsumit të shërbimeve dhe mallrave gjatë kohëqendrimit në Shqipëri me 45 - 50 mijë lekë në vit. Kjo llogaritje është më afër perceptimit korrekt, për arsye se ky tatim paguhet nga secili individ kur blen mallra apo shërbime.


Në këtë kontekst, paraqitet në vijim do t'i përgjigjen pyetjes kryesore, se cili qark paguan më shumë apo më pak tatime në buxhetin shqiptar²¹. Paraprakisht do të prezantojmë ndikimet e faktorëve që e bëjnë vlerësimin të

²¹ e shprehur si përqindje e tatimeve dhe taksave e tarifave të paguara ndaj PBB-së

mundshëm. Përpara se të trajtohet niveli i barrës fiskale sipas rajoneve (qarkut) të Shqipërisë do të shikohen elementët përbërës që përfaqësojnë këtë barrë në buxhetin e shtetit.

Kur marrim në konsideratë faktorët ndikuesë, matja e barrës fiskale nuk është matje e shtrirjes së efektit buxhetor të qeverisë apo administratës publike (përbërja e saj). Nga ana tjetër nuk është as matja e gjithë detyrimeve që mbart një tatimpagues në funksion të të ardhurave që ai realizon brenda një viti (pagesa për institucione jofiskale).

Të ardhurat tatimore në buxhetin e vitit 2018 zënë 93% të gjithë totalit të të ardhurave buxhetore. Ato kanë rritje të peshës së tyre me 2% në 5 vitet e fundit. Të ardhurat jo tatimore zënë 5% të totalit të të ardhurave të buxhetit, me një ulje në strukturë 9 përqind. Ndhimat zënë 2% të totalit të të ardhurave. Ato kanë pësuar ulje me 35% në 5 vitet e fundit.



Barra fiskale, si rezultat i aktivitetit të administratës tatimore qendrore dhe doganore, pushtetit vendor, si dhe një pjesë nga aktiviteti i instituteve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përbëjnë pjesën kryesore si raport ndaj PBB-së.

Tab.21

Të ardhurat tatimore ndaj PBB	2014	2015	2016	2017	2018
Tatimet dhe Doganat	18,2%	18,0%	18,7%	18,9%	18,5%
Pushteti Vendor	0,9%	0,8%	0,9%	1,3%	1,3%
Sigurimi Shoqëror dhe Shëndetësor	5,0%	4,9%	5,2%	5,5%	5,6%
Burimi: MF	24,0%	23,7%	24,8%	25,7%	25,4%

Barra fiskale nga tatimet dhe doganat ka një rritje të peshës së saj me 0.3% të PBB-së për 5 vitet e fundit. Në vitin 2018, forcimi i administrimit të taksave vendore, veçanërisht në Tiranë, si dhe ndikimi nga taksat që filluan të shfrytëzohen me kapacitet më të lartë se më parë çoi në nivele performimi më të mirë me 0.4 përqind të PBB-së krahasuar me 5 vite më parë. Barra e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mban një peshë në rritje në barrën fiskale me 5.6 përqind në 2018. Në 5 vitet e fundit pesha e saj është rritur me 0.6% të PBB-së.

Këto treguesë vlejné për transparencë në lidhje me peshën që mbajnë konsumatorët dhe investitorët duke kuptuar se tendenca në rënie e

peshës së tatimeve indirekte (presioni mbi çmimet e konsumit) dhe tendenca në rritje e tatimeve direkte (ndikimi mbi fitimin korporativ dhe të ardhurat personale) pasqyrojnë efektet pozitive të politikës fiskale të qeverisë, e cila synon një rishpërndarje të të ardhurave duke përfutur më tepër tatime nga fitimi mbi kapitalet. Barra fiskale e vitit 2018 e krahasuar me vitin 2017 paraqitet sipas rajoneve në tabelën 22.

Tab.22


Renditja	Barra fiskale* (% e PBB)	Viti Fiskal		Ndryshimi 18/17
		2017	2018	
1	TIRANE	27,8%	28,4%	0,6%
2	DURRES	26,1%	25,9%	-0,2%
3	SHKODER	24,0%	24,6%	0,7%
4	GJIROKASTER	24,5%	24,6%	0,1%
5	VLORE	24,0%	24,4%	0,4%
6	KORCE	24,2%	24,2%	0%
7	LEZHE	23,9%	23,9%	0%
8	BERAT	22,9%	23,1%	0,2%
9	ELBASAN	22,4%	22,6%	0,2%
10	KUKES	21%	21,5%	0,7%
11	DIBER	21,4%	20,1%	-1,2%
12	FIER	21,0%	19,8%	-1,2%

* Ilogaritjet sipas ALTA

Sipas renditjes së barrës si % e PBB, vendin e 1rë e mban qarku i Tiranës, i cili duke qenë edhe kryeqytet i vendit dhe me dendësi më të lartë të popullsisë (28.8% e popullsisë së vendit) e mban këtë vend për çdo vit. Vendine fundit në renditje në 2018 e mban qarku i Fierit (19.8%).

Raporti që kanë taksat e paguara apo të njësisë territoriale brenda shtetit në raport me PBB-në është një tregues që vlen për të parë se sa është kontributi real i taksapaguesve. Nga ana tjetër ai vlen për të kuptuar se sa duhet pretenduar për të përfutur mbrapsht në formën e shpenzimeve që bëhen nga buxheti shërbimet që kanë interes të madh publik.

Në grafik, është prezantuar llogaritja e barrës fiskale për 12 qarqet e Shqipërisë, për vitin 2017 dhe 2018.




Qarku i Dibrës, Durrësit dhe Fierit paraqiten me rënie të barrës fiskale në vitin 2018 në krahasim me 2017, respektivisht me -1.2, -0.2 dhe -1.2 % të

PBB-së. Kurse, qarku i Lezhës dhe Korçës nuk kanë ndryshim të barrës fiskale nga viti 2017 një vit më vonë. Qarku i Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës, Kukësit, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës paraqiten me rritje mjaft të lehta të barrës fiskale (0.1 – 0.7 % të PBB).


Pesha e barrës fiskale rajonale (tatimet dhe taksat qendrore dhe vendore) ndaj prodhimit të brendshëm, përfshin llogaritjen e tatimeve të paguara në buxhetin e shtetit nga secili qark ndaj PBB-së së vendit. Në këtë kategori të ardhurash përfshihen barra fiskale që mbajnë tatimpaguesit për llogari të administratës tatimore qendrore (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), si dhe administratat tatimore vendore (Bashkitë dhe njësitë).

Barra fiskale për gjithë qarqet në vitin 2018 peshon sa 25.4% e PBB-së. Peshën kryesore e mban qarku Tiranës me një barrë fiskale që është sa 11.4% e PBB-së së vendit, e ndjekur nga Durrësi dhe Fieri me një peshë respektive sa 3.5% dhe 2% e PBB-së. Qarku i Beratit dhe Dibrës kanë peshën më të vogël të barrës fiskale, ku secili nga ta ka



arkëtuar për buxhetin sa 0.6% e PBB. Më shumë se gjysma e barrës fiskale që është derdhur në formën e taksave dhe tatimeve në buxhet nga administrata tatimore dhe doganore i përket zonës së Tiranës dhe Durrësit.

Nga krahasimi i raportit të barrës fiskale së çdo qarku ndaj PBB kombëtare me shumën e transfertave të buxhetit për çdo qark ndaj PBB kombëtare (shuma e transfertave të çdo bashkie si pjesë e qarqeve), analiza eidenton se Tirana, Durrësi, Korça, Fieri dhe Lezha janë qarqet që kanë barrë fiskale më lart apo njësoj (Lezha) se sa shuma e transfertave të buxhetit për to, respektivisht me 8.5%, 2.3%, 0.8% dhe 0.1% të PBB.



Ky ballafaqim paraqet qartë faktin se buxheti i shtetit ka marrë më shumë se sa ka dhënë për to. Por, nëse përfshijmë në këtë analizë edhe investimet kapitale të buxhetit, për projekte infrastrukturore, arsimore, shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera atëherë situata e shpenzimeve që shpërndahen nga buxheti për gjithë qarqet tregon një rritje të peshës së tyre ndaj PBB, nisur nga projektet zhvillimore, por pa u ndikuar nga pagesat në buxhet nëpërmjet barrës fiskale. Kjo mospërputhje spjegohet, me përqëndrimin e konsumit dhe industrisë e tregtisë me shumicë në këto qarqe të mëdha. Por, nga ana tjetër dallimet e ndryshme zonale nëpër shumë dekada janë objekt i transferimit apo shpërndarjes së shpenzimeve sipas nismave për zhvillim.

Rast që mund të përmendet është Rruga e Arbërit, e cila me koston që përballohet nga shpenzimet e buxhetit është e barabartë me barrën fiskale të qarkut të Dibrës të 4 viteve, nëse e llogaritim me nivelet e arkëtimeve për buxhetin të vitit 2018.

Nga ana tjetër, një administrim fiskal lokal më i mirë duhet të justifikojë ngushtimin e diferencave midis konsumit dhe shpërndarjes së popullsisë dhe bizneseve në qark.

Ndryshimet ligjore të fundvitit 2018 në sistemin fiskal, nga njëra anë synojnë të lehtësojnë biznesin e vogël, të vetëpunësuarit, por edhe shpërndajnë barrë e taksave më harmonikisht midis atyre që taksohen nga puna dhe atyre që taksohen nga kapitali. Nga ana tjetër, ndryshimet e politikës fiskale tentojnë të normalizojnë situatën në shumë sektorë të ekonomisë lokale. Këto ndryshime, njëkohësisht, rritin të ardhurat në disa bashki ku përfitimi është më i madh për ato kryesore, p.sh. Bashkia Tiranë, duke bërë të mundur ofrimin e më shumë shërbimeve me një cilësi më të lartë.

Në politikat fiskale lehtësuese në drejtim të barrës së taksave lokale është “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin” për biznesin e vogël, i cili është shfuqizuar për kategorinë e bizneseve me xhiro 0 deri 5 milionë lekë në vit. Por, edhe rritja e pragut të xhiros vjetore deri 14 milionë lekë në vit për kategorinë tjetër të bizneseve që taksojnë fitimin me 5% në vit është një tjetër zhvendosje e barrës së këtij tatimi drejt bizneseve që fitojnë më shumë, duke lehtësuar kështu biznesin e vogël dhe sidomos të vetëpunësuarit. Biznesi me xhiro vjetore nga 8 milionë deri 14 milionë lekë, i cili është ndryshimi i fundit i paketës fiskale 2018 përbën 20% të numrit të bizneseve në vend.

Në të 12 qarqet, më shumë se gjysma e të ardhurave fiskale përbëhet nga barra fiskale që u mbledhet qytetarëve të bashkisë kryesore të qarkut.

Të ardhura nga Pushteti Vendor	2014	2015	2016	2017	2018
Taksë mbi Pasurinë(ndertesat)	3,682	3,921	4,678	4,879	5,192

min.leke

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për shtëpitë e banimit, trojet e ndërtimit dhe tokën bujqësore ka mbetur në më të shumtën e bashkive në nivele të njëjta si më parë edhe pse me rritje mesatare 9% në 5 vitet e fundit. Disa bashki kryesore e kanë administruar më mirë detyrimin e ligjit për taksat vendore në administrimin e taksës së pasurisë. Aplikimi për herë të parë në vitin 2016 e taksës së re mbi truallin, shtoi barrën fiskale të taksës mbi pasurinë me të paktën 10% mbi rritjen mesatare. Ajo aplikohet në vlera shumë më të ulëta se vendet e tjera qinje me Shqipërinë, ku p.sh. individët në Tiranë paguajnë vetëm 0.56 lek/m² në vit ndërsa bizneset vetëm 20 lekë/m² në vit. Ndërsa, aplikimi për herë të parë prej 2019 i taksës mbi ndërtesat bazuar mbi vlerën e tyre dhe jo mbi sipërfaqen ka pritshmëri të mëdha të zgjerojë bazën e taksimit, por edhe të ardhurat në buxhet që për vitin 2019 parashikohet të rriten me 33% krahasuar me 2018.

Pesha specifike që zënë qarqet e vendit, ka specifikat që përfshijnë numrin e tatimpaguesve që mbajnë barrën fiskale, karakteristikat industriale, përbërjet gjinore, strukturën e popullsisë, arsimimin, burimet natyrore nëntokë dhe mbitokë, pasuritë individuale të trashëguara dhe aktivet e krijuara në mbi dy dekada, si dhe elementëve të ambientit dhe investimeve me fonde publike dhe private duke përfshirë edhe planet e zhvillimit zonal.

Këto raporte orientojnë edhe shpërndarjen e segmentimit të tatimpaguesve, sipas madhësisë që ata kanë (mikro, të vegjël, të mesëm, apo të mëdhenj). Nga të dhënat e raporteve, mund të shihet se barra fiskale në rajone mbahet në nivelin sasior nga baza e tatimpaguesve rezidentë që përfshihen në kategoritë e bizneseve mikro (vetëpunësimet) dhe të vegjël, se sa nga baza e tatimpaguesve rezidentë që përfshihen në kategoritë e bizneseve të mesme dhe të mëdhenj.

Një faktor ndikues lidhet me shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve për konsum, të cilat kanë një prirje të konsumohen jashtë zonës ku

krijohen apo prodhohen drejt eksportit apo në zonat me dendësi popullesie.


Shembull kuptimplotë është rasti i zonave ku nxirren pasuritë natyrore nëntokësore. Zhvendosja e tyre drejt eksportit apo zonave me popullsi të dendur urbane bën në të njëjtën kohë edhe zhvendosje të barrës nga njëra zonë e qarkut në tjetrën. Nga ana tjetër, barra fiskale që mbajnë jorezidentët, edhe pse ka një peshë specifike jo më shumë se 4% në totalin e barrës fiskale ka një ndikim në zonat ku ata janë vendosur dhe krijojnë të ardhura brenda territorit të Shqipërisë.

2.5. Qarqet me barrën fiskale më të ulët

Barra fiskale në Shqipëri në vitin 2018 shënon një rënie të lehtë me 0.3% të PBB-së. Kjo rënie kryesisht vjen nga faktorë të përmendur më lart, por edhe nga një shfrytëzim nën kapacitetin e vet të administrimit fiskal. Ky realitet i administrimit shikohet nga mosrealizimi i programit të të ardhurave tatimore të buxhetit 2018 me 5.1 miliard lekë (-1.2%).

Qarqet me barrë fiskale të ulët janë konsideruar ata që janë më poshtë se mesatarja e barrës fiskale në 2018 (25.4%).

Sipas grafikut, Barra fiskale 2018 më e ulët është në qarkun Fier (19.8%). Një renditje pak më lart është qarku i Dibrës (21.5%). Qarku i Kukësit (21.5%), Elbasanit (22.6%) dhe Beratit (23.1%) kanë një renditje pak më lart si pozicione, por janë poshtë nivelit të Barrës fiskale kombëtare (25.4%).



Në krahasimin e barrës fiskale të vitit 2018 me vitin 2017, qarku i Kukësi ka zbritur një vend më poshtë në vitin 2018, ndërsa Fieri është ngjitur në vend të Kukësit. Edhe qarku i Dibrës ka zbritur një pozicion më poshtë. Qarku i Elbasanit dhe

qarku i Beratit mbajnë të njëtat pozicione në renditje si në vitin 2017.

Barra fiskale më e ulët vijon të jetë rrjedhojë e nivelit administrativ ende nën kapacitete të forcimit të mbledhjes së tatimeve dhe taksave, kryesisht për tatimet e konsumit, por edhe për taksat e pushtetit vendor. Peshën specifike të të ardhurave në disa nga qarqet me barrë të ulët fiskale e ka rritur volumi i të ardhurave doganore.

Qarku i **Fierit**, me një peshë në ekonominë e vendit me të paktën 10.2% të PBB-së ka një nivel të barrës fiskale të ulët në 2018 me 1.2% më pak. Ky nivel është poshtë kapaciteteve fiskale të mundshme dhe kryesisht vjen nga mosperformimi i taksave qendrore. Kjo situatë është tregues i pagimit të taksave sa në mënyrë jovullnetare, po aq edhe nga performanca e dobët e administrimit fiskal, që në historikun e këtij qarku ka qenë në nivele të ulta, për shkak edhe të nivelit të lartë të informalitetit.

Qarku i **Dibrës** është ulur 1 pozicion më poshtë në krahasim me një vit më përpara për shkak të një barre fiskale më të ulët me -1.2 % më pak. Arsyet kryesore janë te niveli i informalitetit dhe moszgjërimi i bazës së taksimit, por edhe te një shfrytëzim të dobët të kapaciteteve të administrimit.

Qarku i **Elbasanit** edhe pse ka një rritje të barrës fiskale me 0.2% nuk ka ndryshuar pozicionin në renditje. Në këtë qark mbeten mundësi të pashfrytëzuara forcimi i administrimit të barrës së taksave vendore, por edhe zgjerimi i bazës së taksimit për konsumin dhe individin.

Qarku i **Beratit**, ruan të njëjtin pozicion në renditje si në vitin 2017 dhe ka një rritje të lehtë të barrës fiskale me 0.1% në raport me vitin e mëparshëm. Megjithatë, një pjesë e madhe e ndikimit në këtë pozicionim vjen nga rritja e tregut turistik, por edhe ndikime nga projektet energjetike, përfshirë edhe gazsjellësin.

Qyteti i **Sarandës**, për specifikën e një qyteti të madh të rivierës turistike bregdetare është futur në llogaritjen dhe renditjen sipas barrës edhe pse nuk përfaqëson qark, por vetëm një Bashki. Me hyrjen e parë në këtë listë, Saranda mbante në 2017 pozicionin e 9^{të} duke u renditur si qytet me barrë të ulët fiskale.

Një problem që duhet të adresohet dhe që del më direkt për qarqet që pozicionohen dobët me barrën fiskale është ngushtimi i evazionit duke


luftuar informalitetin. Edhe pse është e vështirë të bëhet një zbardhje e ekonomisë në mënyrë të menjëhershme duhet që të parët, administratat rajonale në koordine me drejtorinë qendrore të dalin nga rrethi vicioz i informalitetit duke filluar të bëjnë detyrën në zbatimin e legjislacionit përditë, për të fituar terren ndaj evazionit.

Hapi i parë duhet të fillojë nga taksimi i individëve me të ardhura dhe pasuri më të mëdha se mesatarja dhe të cilët nuk kontribuojnë sa duhet në të ardhurat e buxhetit vendor dhe qendror.

2.6. Qarqet me barrën fiskale më të lartë

Një nivel i lartë i barrës fiskale do të justifikohet vetëm për ato qarqe me nivel të lartë teknologjie, produktivitet të lartë të punës dhe një kulturë të zhvilluar për pagimin vullnetar të taksave.

Në fakt, Barra fiskale më e lartë vijon edhe për vitin 2018 në qarkun e **Tiranës** me një nivel sa 28.4% të PBB-së rajonale. Treguesi i një barre më të lehtësuar tregon për një shpërndarje më të mirë të bizneseve edhe në qarqe të tjera të vendit, si pasojë e investimeve në energji dhe naftë. Ndërkohë, të ardhurat e pushtetit vendor të Bashkisë së Tiranës janë deri në 5.9 herë më të larta se Bashkia e dytë me të ardhura vendore të larta, Durrësi.



Qarku i **Durrësit**, mban vendin e 2^{të} për barrën më të lartë me një peshë sa 25.9% e PBB-së rajonale. Tirana dhe Durrësi janë dy qarqet që konsiderohen se kanë barrën më të lartë fiskale pasi janë edhe më lart se barra fiskale në nivel vendi. Në krahasim me 2017 ka një rënie të peshës së barrës fiskale me 0.2 % të PBB-së. Ndikimi nga aktivitetet tregtare, si dhe aktiviteti vjetor turistik, përveç vlerës së shtuar nga transporti rrugor dhe shoqëri prodhimi rezidente në Durrës i japin këtij qarku një rëndësi të madhe përsa lidhet me të ardhmen e shpërndarjes së barrës fiskale. Por, duhet theksuar se performanca e pushtetit vendor ka një

shfrytëzim në rënie të kapaciteteve për arkëtime të taksave edhe në zona të njohura për informalitetin në këtë qark.

Qarku i **Shkodrës** këtë vit qëndron tre pozicione më lart me një barrë fiskale më të lartë dhe afër nivelit të barrës fiskale të vendit. Shkodra pozicionohet si një qark me nivel mesatar të barrës fiskale. Ky qark është ngritur 6 pozicione më lart në krahasim me dy vite më parë duke u renditur në 2018 në vend të 3^{të}. Shkodra ka një performancë të dobët të arkëtimeve të taksave vendore, e cila në raport me qarkun e Tiranës është 13.2 herë më e ulët. Problemi kryesor për tu adresuar mbetet evazioni që ka referencën të informaliteti në të ardhurat e individëve, si dhe në moszgjerimin e bazës së TVSH-së.

Qarku i **Gjirokastrës**, pozicionohet si një qark me nivel mesatar të barrës fiskale. Ky nivel është për shkak se mbetet një portë e rëndësishme e importeve të jugut të vendit paraqitet me një rritje të lehtë të barrës fiskale me 0.1 % të PBB-së rajonale. Rritja e nivelit të barrës ka ardhur për arsye të rritjes së pagesave të tatimeve për taksat kryesore të TVSH dhe tatim-fitimit, por edhe rritjes së pagesave për taksat vendore. Një ndikim në rritjen e barrës ka dhënë edhe aktiviteti i turizmit, që shoqërohet me të ardhura më të larta dhe vlerë të shtuar në ekonomi. Por edhe pse ka një rritje të lehtë, si dhe të njëjtin nivel të barrës fiskale me qarkun e Shkodrës, për shkak të konkurrencës midis qarqeve është një pozicion më poshtë nga viti 2017 duke kaluar në 2018 në vend të 4^{të}.

Qarku i **Vlorës**, për vitin 2018 mban vendin e 5të duke u renditur në qarqet me nivel mesatar të barrës fiskale në raport me PBB-në rajonale edhe pse ka rënie të peshës së saj krahasuar me 2016 me 1.2% të PBB-së. Vlora ka stabilitet në renditje në krahasim me vitin 2017 duke treguar se ka nevojë për një rritje të performancës tatimore për të ruajtur standartin e arritur në nivelin e shpërndarjes së barrës fiskale mbi bizneset. Nga ana tjetër turizmi dhe portet e Vlorës bashkë me industrinë energjetike në zhvillim (energji hidro dhe diellore) janë mundësi që duhet të shfrytëzohen për të rritur barrën fiskale nëpërmjet zgjerimit të bazës dhe forcimit të kapaciteteve.

Qarku i **Korçës** në vitin 2018 ka humbur një vend nga renditja e vitit të kaluar për shkak të konkurrencës midis qarqeve regjistron pozicionin e 6^{të}. Edhe pse barra fiskale nuk ka ndryshuar në

krahasim me vitin e mëparshëm, qarku në 2018 është sa 1.2% e PBB-së kombëtare. Qarku i Korçës është në grupin e qarqeve me barrë mesatare fiskale.

Qarku i **Lezhës**, mban vendin e 7^{të} në vitin 2018 duke mbajtur të njëjtin pozicion si viti më përpara. Ky qark konsiderohet me një nivel barre mesatare fiskale.

Të 7 qarqet që konsiderohen me barrë të lartë fiskale dhe barrë të mesme fiskale, si dhe bashkitë që përfshihen brenda tyre konsiderohen me barrë fiskale që llogaritet të arrijë në nivelin e 20.8% të PBB-së 2018. Në këto qarqe edhe pse nuk ka patur politika tatimore specifike, shihet se nevojitet të adresohen trajtimi i rrisqeve drejt:


3. Barra Fiskale në Kosovë

Barra fiskale e të hyrave të përgjithshme në Kosovë është si rezultat i kontributit afër 74% nga tatimet indirekte, 15% nga tatimet direkte dhe rreth 11% nga të hyrat jo tatimore. Kjo strukturë e të hyrave është rezultat i përbërjes strukturore të ekonomisë kosovare, e cila ka një varësi nga importet dhe si rrjedhojë rezultojnë me deficit të lartë tregtar.


Barra e buxhetit dhe barra fiskale në Kosovë matet në të njëjtën mënyrë ashtu si është sqaruar për Shqipërinë.

3.1. Performanca e buxhetit dhe barra e të hyrave komunale dhe rajonale

Në vlerë absolute të hyrat buxhetore në 2018 janë 1.81 miliard Euro. Sipas grafikut, të hyrat tatimore janë 1.66 miliard Euro dhe të hyrat jotatimore janë 147 milionë Euro.




Të ardhurat e buxhetit të Kosovës në 2018 janë sa 26.9% e PBB-së. Ndërsa të hyrat tatimore, ku përfshihen edhe taksa nga të hyrat jotatimore janë sa 26.8% e PBB-së me diferencë 0.1%.




Struktura e të hyrave buxhetore, sipas grafikut në 2018 përbëhet në pjesën kryesore nga të hyrat tatimore (91.5%), nga të hyrat jotatimore (8.1%)

dhe Grantet (0.4%). Të hyrat tatimore përbëhen nga tatimet direkte dhe tatimet indirekte. Të hyrat jo tatimore përfshijnë të hyrat vetanake të



qeverisjes vendore, rentën minerare, taksat koncesionare, të hyrat nga dividendi, si dhe të hyra të tjera. Sipas grafikut, performanca vjetore e të hyrave në 5 vitet e fundit mesatarisht është rritur me 7.8%.

Në të hyrat tatimore në 2018, peshën kryesore e mbajnë doganat me 71.8%. Ndërsa tatimet zënë një peshë prej 25.2% dhe të hyrat nga qeverisja vendore zënë 3%. Të hyrat tatimore për 5 vitet e fundit janë rritur në total me 31.8%.



Në grafik shikohet pesha e doganave, tatimeve dhe qeverisjes vendore në të hyrat tatimore. Në 5 vitet e fundit, të hyrat nga tatimet kanë rritje me 2.2 përqind, të cilat kanë zvogëluar peshën e të hyrave nga dogana. Pesa e të hyrave nga

Tab. 22

PESHA SIPAS STRUKTURËS	2014	2015	2016	2017	2018
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	50.0%	49.7%	50.2%	52.5%	52.4%
nga administrata tatimore	11.4%	11.9%	12.3%	12.2%	12.3%
nga administrata doganore	35.7%	35.1%	35.3%	36.6%	37.3%
minus Rimbursimi TVSH	2.86%	2.76%	2.60%	3.74%	2.79%
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto)	47.1%	47.0%	47.6%	48.7%	49.6%
Tatimi mbi të ardhurat korporative	5%	5%	5.6%	4.8%	5.1%
Akcizat	26%	28%	27.6%	27.9%	27.0%
Tatimi në të Ardhurat Personale	9%	8%	8.5%	8.8%	8.8%
Tatimi në pronë dhe të tjera direkte	2%	2%	1.9%	1.6%	2.7%
Detyrimi Doganor	11%	10%	8.9%	8.1%	6.7%
Ndryshimi midis viteve		9.6%	12.0%	6.3%	6.4%

qeverisja vendore ka mbetur e pandryshuar.

Sipas tabelës 22, të hyrat nga TVSH në 2018 janë 49.6% dhe të hyrat nga akciza janë 27%. Të dy tatimet së bashku zënë një peshë në të hyrat

tatimore me 76.6% . Ndërsa detyrimet doganore zënë 6.7% të totalit të të hyrave tatimore.

Tatimi mbi të ardhurat korporatave zë 5.1% të të hyrave tatimore dhe tatimi në të ardhurat personale 8.8%. Tatimi mbi pronë zë 2.7% të të hyrave. Performanca e të hyrave ka rritje vjetore mesatare prej 8.6%.

Tab.23

PESHA - TE HYRAT JOTATIMORE	2014	2015	2016	2017
Taksa e ngarkesa tjera nga OB qeverisje qendrore	49%	44%	52%	50%
Taksa e ngarkesa tjera qeverisje lokale	24%	20%	26%	27%
Taksa Koncesionare	3%	4%	5%	5%
Renta minerare	16%	16%	18%	16%
Të tjera	9%	16%	0%	2%

Në tabelën 23 paraqitet pesha e të hyrave jotatimore ndaj totalit të tyre. Pesha e ngarkesave të obligacioneve të qeverisjes qendrore në vitin 2018 është sa gjysma e të hyrave jotatimore. Ndërsa taksat e qeverisjes vendore zënë 27% të të hyrave jotatimore. Renta minerare dhe taksat koncesionare zënë respektivisht 16% dhe 5% të të hyrave jotatimore. Pjesa e mbetur vjen nga të hyra të tjera që zënë 2% të totalit të të hyrave jotatimore.

Të hyra Tatimore Vendore, 2018 Euro

Renditja	Rajoni	Taksa vendore/ Banor
1	Prishtinë	84
2	Gjilan	40
3	Pejë	36
4	Ferizaj	35
5	Prizren	34
6	Gjakovë	28
7	Mitrovicë	26

Në Kosovë barra fiskale ka ardhur në rritje nga viti në vit. Nëse analizojmë arkëtimet nga qeverisja vendore sipas komunave që janë pjesë përbërëse e 7 rajoneve vërehet se barrën më të lartë e mbajnë qytetarët e Rajnit të Prishtinës me një ngarkesë taksash vendore prej 84 Euro në vit. Banorët e Gjilanit janë në vend të 2^{të} për barrën vendore me 40 Euro në vit. Në vend të 3^{të} është Peja që ka një ngarkesë të taksave vendore prej 36 Euro në vit për banor dhe poshtë mesatares së barrës vendore të Kosovës. Ferizaj mban vendin e 4^t për ngarkesën e taksave vendore për banor me 34 Euro në vit dhe poshtë mesatares së barrës vendore të Kosovës. Në vendin e 6^{të} pozicionohet Gjakova me ngarkesë të taksave vendore poshtë mesatares së Kosovës, me vetëm 28 Euro taksa vendore në vit. Në vend të fundit me barrën më të ulët të taksave vendore janë banorët e rajonit të Mitrovicës me 26 Euro në vit, e cila ka specifikat e saj lidhur me pagesat e taksave vendore, pasi si do shikojmë më poshtë vetë komuna e Mitrovicës paraqitet me një ngarkesë ndryshe.

Edhe pse barra e taksave ulet kur rritet baza tatimore, kjo nuk ka ndodhur në Kosovë. Rajonet e Prishtinës, Prizrenit dhe Mitrovicës janë me numrin më të lartë të popullsisë. Por, përveç Prishtinës, të dy rajonet e tjera nuk mbajnë një ngarkesë që të argumentohet nisur nga një bazë e gjerë tatimore. Në këtë këndvështrim, analiza kontaton se nivelet e administrimit të taksave vendore duhet të rritin kapacitetet e tyre për shfrytëzimin e mundësive për rritjen e të hyrave vendore.

Të hyra Tatimore, 2018 Euro

Renditja	Komuna	Të hyra tatimore
1	Prishtinë	145
2	Gracanica	139
3	Mitrovicë	77
4	Fushë Kosovë	75
5	Gjilan	54
6	Klllokot	48
6	Obiliq	48
7	Ferizaj	46
8	Shtërpçë	44
8	Prizren	44
9	Pejë	42
10	Ranillugë	39
11	Lipjan	38
12	Vushtri	36
13	Novobërd	34
13	Gjakovë	34
14	Suharekë	33
15	Partesh	32
16	Hani i Elezit	31
17	Istog	30
18	Rahovec	28
18	Kamenicë	28
19	Klinë	27
20	Viti	23
21	Kaçanik	21
22	Glogoc	20
23	Podujevë	19
24	Skënderaj	18
25	Deçan	17
26	Shtime	16
26	Junik	16
27	Malishevë	15
28	Dragash	14
29	Mamushë	12
30	Zveçan	2
30	Leposaviq	2
30	Zubin Potok	2
31	Mitrovica Veriore	1
Mesatare		35.5

Burimi: Pushteti Vendor, Kuvendi, MF

Nëse analizën e ndarjes së taksave vendore e zbresim në nivel komune, shikohet se Prishtina edhe në nivel komune mban barrën më të lartë të të hyrave vendore me 145 Euro në vit për banor. Në vend të 2^{të} është komuna e Gracanicës me 139 Euro në vit për banor. Vendin e 3^{të} e mban Mitrovica si komunë me 77 Euro në vit për banor. Komuna e Fushë-Kosovës mban vendin e 4^t për barrën më të lartë të taksave vendore. Në vend të 5^{të} është komuna e Gjilanit me ngarkesë fiskale më të ulët. Komunat e Klllokot dhe Obiliq mbajnë të njëjtin pozicion në vend të 6^{të}. Në vend të 7^{të} është komuna e Ferizaj dhe në vend të 8^{të} janë dy komuna, ajo e Shtërpçës dhe e Prizrenit. Vendin e 9^{të} e mban komuna e Pejës dhe vendin e 10^{të} e mban komuna e Ranillugës. Vendin e fundit e mban komuna e Mitrovicës veriore që dukshëm nuk ka taksa vendore, por po ashtu edhe komunat e Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan janë në po të njëjtën situatë të taksave vendore.

Ndërkohë komunat që i përkasin pozicioneve nga veni 10^{të} e deri në vendin e 29^{të} rezultojnë të kenë diferencë të madhe në raport me komunat që u paraqiten më lart edhe pse sistemi i taksave vendore është i njëjtë për të gjitha.

Në një vështrim të shpërndarjes së barrës vendore shikohet se problemi i parë është

kapaciteti i ulët i administrimit të taksave vendore.

Ndërkohë, shpërndarja jo e barabartë e barrës së taksave vendore spjegohet në një nivel të caktuar edhe me përqëndrimin e konsumit dhe industrisë e tregtisë jo në mënyrë të harmonizuar në të gjitha qarqet. Një faktor ndikues gjithashtu lidhet me shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve për konsum, të cilat kanë një prirje të konsumohen jashtë zonës ku krijohen apo prodhohen drejt eksportit apo në zonat me dendësi popullesie.

Por, problemi që ende nuk po kufizohet është evazioni, i cili vjen nga një ekonomi informale e pandryshuar edhe pse të hyrat rriten nga viti në vit. Por kjo rritje e të ardhurave nuk vjen për arsye të betejave të fituara ndaj evazionit, por më së shumti si pjesë e taksimit që i përgjigjet zgjerimit të ekonomisë, si dhe reflektimit të inflacionit. Përqindja më e lartë e shërbimeve të patakusara është një ndër problemet më të mprehta dhe masive për tregun kosovar.

Lufta ndaj evazionit fiskal, duhet të jetë fokusi kryesor i politikave fiskale, si pjesa e munguar që të mos jetë vetëm një mënyrë për të rritur të hyrat e qeverisë, por gjithashtu të shndërrohet në një mënyrë për të rritur barazinë e sistemit tatimor për tatimpaguesit. Kjo luftë do të diktojë edhe një transparencë më të plotë dhe një nevojë për të përmirësuar besueshmërinë e sistemit tatimor te qytetarët dhe bizneset.

3.2. Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacionit të buxhetit


Për të krijuar besimin në një sistem fiskal që funksionon për të rritur mirëqenien e jetës së qytetarëve të vet nevojitet që të bëhet një analizë lidhur me rikthimin e taksave të paguara si një barrë fiskale në shpenzimet publike për taksapaguesit.

Tab.24 mln. Euro

Shpenzimet e buxhetit	2014	2015	2016	2017	2018
Shpenzimet për pagat dhe kontributet	489	525	544	550	590
Shpenzime operative dhe mirëmbajtje	208	205	203	226	265
Shpenzime investime kapitale	411	404	444	468	694
Shpenzime për buxhetin vendor dhe transferta	361	418	475	506	526
TOTALI	1,469	1,552	1,666	1,750	2,075

Në analizën e shpenzimeve të buxhetit për 5 vitet e fundit, sipas tabelës 24 shikohet se shpenzimet kanë një rritje mesatare vjetore prej 120 milion Euro. Ndërkohë, të hyrat janë rritur mesatarisht për çdo vit me 95 milion Euro.

Rritja shpenzimeve kapitale ka patur ritmet më të larta me 69% në 5 vite. Ndërsa, vendin e dytë të rritjes së shpenzimeve buxhetore e mbajnë



transfertat për qeverisjen vendore me 47% në 5 vite. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për pagat e administratës kanë qenë me rritje respektive prej 27% dhe 21% në 5 vite.

Shpenzimet për investime kapitale në 2014 zënë 28% të totalit të shpenzimeve dhe në 2018 ato janë rritur në nivelin e 33% të shpenzimeve gjithsej. Ndërkohë, shpenzimet për administratën kanë ecur në kahun e kundërt me shpenzimet kapitale në të njëjtën peshë ndaj totalit.

Shpenzimet për qeverisjen vendore në pamje të parë duket sikur nuk kanë ndryshuar, pasi mbajnë të njëjtën peshë në shpenzimet në vitet 2014 dhe 2018. Por, në vitin 2016 dhe 2017 ato janë rritur me 4% duke ndikuar në uljen e peshë së shpenzimeve operative dhe pagave të qeverisë.

Nga krahasimi i të hyrave tatimore me shpenzimet e buxhetit, që përkojnë me to shihet se të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale justifikon vetëm 25% të shpenzimeve të buxhetit për pagat e administratës shtetërore. Ndërsa, për shpenzimet për investime kapitale justifikohet vetëm 19% nga të hyrat e tatimit mbi të ardhurat korporatave dhe taksës mbi pronën së bashku.

Destinacionet e tjera të shpenzimeve të buxhetit

Tab. 25

Shpenzimet vs Të hyrat	2014	2015	2016	2017	2018
Shpenzimet për administratën vs. të ardhurat personale	22%	21%	23%	25%	25%
Shpenzime kapitale vs. tatimi korporativ dhe mbi pronën	19%	22%	24%	21%	19%

(për qeverisje vendore dhe për shpenzime operative), së bashku me plotësimin e pjesëve të pambuluara nga taksat e dedikuara për shpenzimet kapitale dhe pagat mbulohen nga tatimet indirekte, të cilat ndërkohë shkojnë edhe për shpenzime të tjera vendore.


3.3. Rajonet me barrën fiskale më të lartë dhe më të ulët

Të hyrat tatimore dhe jotatimore në buxhet në vitin 2018 në raport me prodhimin e brendshëm të rajonit për vitin 2018 për secilin nga 7 rajonet në Kosovë paraqiten në tabelën 26.

Tab.26

Renditja	Barra fiskale* (% e PBB)	Viti Fiskal		Ndryshim i 18/17
		2017	2018	
1	Prishtinë	28.3%	30.2%	1.9%
2	Ferizaj	28.0%	29.1%	1.1%
3	Gjilan	26.9%	28.8%	1.9%
4	Gjakovë	25.4%	28.2%	2.8%
5	Pejë	25.5%	26.4%	0.9%
6	Prizren	25.1%	25.3%	0.2%
7	Mitrovicë	24.8%	23.7%	-1%


Barrën më të lartë fiskale edhe për vitin 2018 e paguajnë taksapaguesit e rajonit të Prishtinës (30.2%) me një rritje të nivelit të barrës me 1.9% në raport me vitin 2017.



Në vend të 2^{të} për barrën fiskale të lartë pozicionohen qytetarët e rajonit të Ferizaj (29.1%), të cilët edhe në 2017 kanë mbajtur të njëjtin vend. Në 2018 barra fiskale është rritur me 1.1%.

Gjilani është rajoni që për barrën e lartë (28.8%), e cila vjen si pasojë e të hyrave të larta në buxhet në raport me PBB-në rajonale pozicionohet në vend të 3^{të} në renditje. Të njëjtin vend ka mbajtur edhe në vitin 2017.

Gjakova mban vendin e 4^t për barrën e lartë fiskale (28.2%) duke u ngjitur me 1 vend më lart në raport me vitin e mëparshëm.



Në grupin e rajoneve me barrë fiskale të ulët vendin e 1^{rë} e mban rajoni i Mitrovicës (23.7%) me një rënie të saj me 1%. Në vend të 2^{të} për barrë të ulët fiskale është rajoni i Prizrenit (25.3%), me një barrë fiskale poshtë nivelit të barrës fiskale të Kosovës. Në vend të 3^{të} është rajoni i Pejës me barrë të ulët edhe pse ka një rritje nga viti 2017 me 0.9%.

Arsyet e një barre fiskale të ulët gjenden më së shumti te kufizime të biznesit në këto zona, por edhe në një performancë që lidhet me probleme në administrimin në terren. Nga ana tjetër, informaliteti dhe korrupsioni kanë dhënë një ndikim në mbajtjen e barrës fiskale të paeksponuar dhe jotransparente për buxhetin.

3.4. Krahasimi i barrës fiskale midis rajoneve të Shqipërisë dhe Kosovës

Të gjashtë rajonet dhe komunat, që përfshihen brenda tyre konsiderohen me barrë fiskale më të ulët se barra fiskale e qarqeve të Shqipërisë, por edhe nën nivelin kombëtar të barrës fiskale. Nëse krahasojmë për nga ngjashmëria politike rajonin e Prishtinës me qarkun e Tiranës, krahasimi midis tyre nxjerr një barrë fiskale për taksapaguesit e Tiranës 1.8 pikë përqind më të ulët. Po kështu edhe qarku i Kukësit që regjistron barrën më të ulët fiskale në Shqipëri është -3.9 pikë përqind më ulët se barra fiskale e rajonit të Mitrovicës.

Edhe pse krahasimi nuk mund të quhet korrekt gjithsesi është me vlerë për të parë se si ka ndikuar kjo barrë në zhvillimin ekonomik rajonal në të dy vendet. Po ashtu vlen për të parë ndikimin e saj mbi investimet e huaja, nsiur nga fakti se barra është më e lartë në Kosovë sesa në Shqipëri.

Nga krahasimi i hrjeve të investimeve të huaja shihet se Shqipëria ka një vlerë më të lartë të

hyrjeve të investimeve, por arsyeja prapa këtij fakti lidhet me pozicionin gjeostrategjik të Shqipërisë, e cila ka mikpritur në tre vite (2016-2018) një vlerë investimi vetëm nga projekti TAP në afër gjysmën e totalit të investimeve të huaja.

Por edhe përsa i përket shpenzimeve kapitale nga buxheti shikohet se Shqipëria shpenzon vetëm 16% të buxhetit, ndërsa Kosova shpenzon 33% të buxhetit. Nisur nga konkluzionet që vijnë nga përvoja e vendeve që kanë ecur më përpara me reformat mbi shpenzimet kapitale nevojitet që të mos neglizhohen kostot afat shkurtër, por të zhvendosen dhe monitorohen me një kujdes të caktuar për vetë rëndësinë që marrin lidhur me brishtësinë e ecurisë së reformave në vitet e para të tyre.

Pra, krahasimi për disa nga elementët që ndikohen më direkt nga barra fiskale tregojnë fakte që nuk i lidhin domosdoshmërisht me barrën fiskale, por edhe me nevojat që ka secili shtet për të zhvilluar politikat e tij, bazuar edhe mbi programet e qeverisë që ka drejtimin 4-vjeçar të vendit.

Në fakt, ashtu si u komentua edhe më lart barra fiskale nuk është elementi i vetëm që merret në konsideratë nga investitorët. Por gjithsesi një barrë e ulët tregon se zhvillimi i kapaciteteve dhe teknologjia në përdorim janë ende në rrugën e tyre të forcimit dhe depërtimit më të madh në ekonomi.

Në drejtim të lehtësimit të kësaj barre për importuesit kosovarë janë ndërmarrë nisima ligjore që synojnë adoptimin e masave të lirimit në prodhim. Një nga synimet e strukturimit të barrës fiskale është përmirësimi i bazës së saj përmes zëvendësimit të detyrimit doganor dhe TVSH-së së grumbulluar në kufi me të hyra më të larta nga tatimi në korporatë dhe të hyra personale.

Të hyrat e arkëtuara brenda vendit, kanë përcjellur trendin e aktivitetit ekonomik, me trend përmirësimi gradual. Megjithatë baza e këtyre të hyrave vazhdon të jetë e ulët, për arsye të implementimit të reformave strukturore ka sinjale pozitive për një trend më të përshpejtuar të rritjes përtej asaj të shtyrë nga rritja e aktivitetit ekonomik.

4. Barra Fiskale në 2018 në Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2018 të ardhurat buxhetore të Ballkanit Perëndimor janë sa 37.8% e PBB-së. Në një krahasim me barrën fiskale të BE-së (40.2%), shihet se shtetet e BP-së janë 2.4% më pak.


4.1. Barra fiskale sipas taksave

Barra buxhetore në vitin 2018 (tabela 27) në vendet e BP-së është 37.8%. Barrën më të lartë e mban Kroacia me 47.6% të PBB-së. Në vend të 2të është Mali i Zi (45.1%). Vendin e 3të e mban Bosnjë-Hercegovina (43.9%) dhe Serbia në vend të 4t (43.3%). Vendin e 5të e mban Maqedonia e Veriut (30.1%), ndërsa në vendin e 6të renditet Shqipëria (27.9%). Kosova mban pozicionin e vendit të 7të dhe të fundit në BP me 26.9% të PBB-së.

Tab.27 % e PBB


Të ardhurat gjithsej të buxhetit	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	42.6	44.4	46.1	46.7	47.6
Mali i Zi	43.3	40.2	41.2	43.5	45.1
Serbia	39.7	40.4	40.8	41.5	43.3
Kosova	23.9	25.1	26.3	26.7	26.9
Bosnjë-Hercegovina	43.4	43.2	42.7	43.5	43.9
Maqedonia e Veriut	27.5	28.7	28.4	29.1	30.1
Shqipëria	26.3	26.3	27.3	27.7	27.5
TOTALI	35.2	35.5	36.1	37.0	37.8

Nga krahasimi i barrave buxhetore shpjegohet edhe elasticiteti i shpërndarjes së shpenzimeve buxhetore, i cili për shtetet që kanë një të ardhur më të madhe i jep një tjetër ridimensionim dhe shpërndarjes së të ardhurave për qytetarët dhe ekonominë. Nga ana tjetër, kur krahasojmë vlerat absolute ku



Për madhësinë e ekonomisë në 2018, Kroacia mban vendin e 1rë (36.8%); Serbia mban vendin e 2të (26.9%); Bosnjë-Hercegovina mban vendin e 3të (11.9%); Shqipëria mban vendin e 4të (8.9%);

Pesha e shteteve ndaj PBB së Ballkanit Perëndimor, 2018 (%)




Maqedonia e Veriut mban vendin e 5të (7.8%); Kosova mban vendin e 6të (4.9%); Mali i Zi mban vendin e 7të (3%).

Dimensionet e ekonomisë kanë rëndësi për të parë edhe peshën që mban politika fiskale në raport me maturimin e saj në zbatim, pasi sa më e madhe ekonomia, aq më ngadalë është ecuria e një reforme/politike fiskale. Nga ana tjetër, dimensionet e një ekonomie kanë lidhje direkte me bazën e taksimit duke përcaktuar edhe trendin e zgjerimit të saj. Në rastin e një ekonomie të vogël ky zgjerim është më i vështirë të ndodhë, për arsye të konfliktit që ka baza e taksimit me politikën e diferencuar të taksimit sipas segmenteve.

Barra e TVSH-së në të 7 shtetet mbetet ende një problem për adresim. Kosova është me peshën më të madhe të TVSH dhe pas saj vjen Bosnjë-Hercegovina. Kjo e fundit ka një barrë të lartë edhe për taksat e punës, duke bërë që barra fiskale të jetë e lartë. Ndërsa, Kosova është ende larg administrimit afër potencialeve të taksave të punës dhe zhvendosjes së barrës së TVSH drejt barrës së tatimit mbi të ardhurat. Ndërkohë, përpjekjet për zhvendosje të barrës duhet të bëhen graduale dhe pa ndikim në bazën tatimore.

Barra e TVSH (% PBB), Ballkani Perëndimor, 2018



P.sh. në Shqipëri, ku uljet-ngritjet e normave të TVSH-së në 2018 kanë sjellë si efekt dytësor pretendime të sektorëve të tjerë të papërfshirë në përfitimet nga ulja, që të kërkojnë përfitime


edhe ata nga politika e luhatur dhe kontradiktore me parimet e TVSH-së, ku nuk tolerohet politika e përjashtimeve apo shkallëzimeve.

Rast tjetër nga viti 2018 është politika e taksimit të fermerëve duke u ndryshuar skemën e rimbursimit të TVSH për lëndën e parë, apo ndryshimi i politikës për taksat e ambalazheve, të cilat sjellin efekte në prishjen e besueshmërisë të skema dhe uljen e pajtueshmërisë vulnetare në zbatimin e ligjit nga taksapaguesit.

Grafiku tregon se si është shpërndarë barra e taksimit të punës në 7 vendet e BP-së. Në vitin 2018, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Kroacia janë 4 shtetet që e taksojnë më lart nga të tjerat të ardhurën nga puna.

Barra e lartë e punës në nivelet që shikohet në këto vende është me ndikim të vogël në produktivitetin e ekonomisë, për sa kohë ekonomia punn nën potencialin e saj. Kur kjo situatë e ciklit ekonomik do të ndryshojë, atëherë edhe politika duhet të reflektojë kushtet e


Barra e taksave të punës (% PBB) në Ballkanin Perëndimor, 2018



ndryshuara.

Politika e barrës së ulët mbi kontributet e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut është jo konkurruese karahasuar me vendet e tyre fqinje. Por ajo gjithashtu nuk i krijon mundësi buxhetit të shpenzojë më shumë për fondet sociale.

Barra e Sigurimeve (% PBB) në Ballkanin Perëndimor, 2018



Ekonomitë e rajonit të Ballkanit Perëndimor punojnë nën potencialet e tyre dhe në këto rrethana kërkesa për kapitale nuk është në kulmin e tyre. Kjo situatë provohet nga fakti që ekonomitë nuk shfrytëzojnë ofertat e sistemit financiar, por edhe ky i fundit nuk është i zhvilluar në shumëllojshmëri instrumentesh ashtu si në vendet e zhvilluara ekonomike.

Barra e tatimeve mbi kapitalin është në nivele të afërta midis shteteve të Ballkanit Perëndimor, ashtu si shihet në tabelën 29.

Tab.29 % e PBB

Të ardhura nga tatimet mbi kapitalin	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	4.1	4.2	4.5	4.3	4.6
Mali i Zi	1.7	1.6	1.4	1.6	1.6
Serbia	3.4	3.1	3.3	3.9	3.8
Kosova	4.1	4.2	4.3	4.2	4.4
Bosnjë-Hercegovina	3.3	3.5	3.4	3.6	3.8
Maqedonia e Veriut	1.8	3.0	3.1	3.0	3.0
Shqipëria	3.0	3.5	3.4	3.3	3.3
TOTALI	3.1	3.3	3.3	3.4	3.5

Gjithsesi, politika e zhvendosjes së barrave të taksave të ndryshme nga njeri segment taksapaguesisht te tjetri duhet të mbahet brenda kornizave të planifikimit afatmesëm buxhetor.


4.2. Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacioneve të buxhetit

Rishpërndarja e të ardhurave do të thotë barazi përpara ligjit dhe nga ky shkak vjen natyrshëm edhe zgjerimi i bazës tatimore për secilin nga tatimet me synimin për justifikimin e shpenzimeve sipas destinacionit të tyre.

Tab.30 % e PBB

Shpenzimet gjithsej të buxhetit	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	48.0	47.8	46.9	45.8	47.2
Mali i Zi	44.2	46.6	47.5	50.0	50.7
Serbia	46.3	44.0	41.9	40.4	42.7
Kosova	26.3	26.7	27.3	31.0	30.8
Bosnjë-Hercegovina	46.3	43.4	42.3	41.4	42.6
Maqedonia e Veriut	31.7	32.2	31.1	31.8	32.9
Shqipëria	32.2	30.9	29.6	29.7	29.7
TOTALI	39.3	38.8	38.1	38.6	39.5
Deficiti buxhetor	-4.0	-3.3	-2.0	-1.6	-1.7

Shpenzimet e buxhetit në të 7 shtetet arrin në nivelin 39.7% të PBB-së. Nisur nga të ardhurat e buxhetit të vitit 2018 është krijuar si edhe në vitet e mëparshme një deficit buxhetor sa 1.7% e PBB-së, i cili financohet nga burimet e brendshme të buxhetit, por edhe nga burime të jashtme në disa raste.



Kroacia, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina rezultojnë me suficit buxhetor dhe të katër shtetet e tjera janë me deficit buxhetor. Kjo situatë vjen edhe për arsye të disiplinës

buxhetore të shteteve, por edhe për arsye të kostove që mund të kenë reformat në shtetet që duhet të përballen edhe kostot buxhetore, ashtu si dhe ato politike


P.sh. në vitet e fundit Maqedonia mori një sërë veprimesh vendimtare që synojnë rritjen e produktivitetit. Sektori i energjisë u hap ndaj tregut privat dhe kontrolli i oligopolit në telekomunikacion dhe financa u zëvendësua me konkurrencë më të lirë. Diversifikimi i energjisë është duke u zhvilluar dhe kostot e telekomunikacionit kanë rënë, me përfitime për konsumatorin e gjerë. Institucionet që luftojnë informaitetin synojnë t'i tërheqin njerëzit nga informaliteti drejt ekonomisë formale, nëpërmjet reformave të punës që e lejojnë më shumë marrëveshje elastike për punëmarrësit. Rezultati prej kësaj politike është krijimi i 200 mijë vendeve të punës në 4 vitet e fundit. Punësimi në sektorin informal ka rënë si rrjedhojë e rritjes së punësimit formal.

Tab.31 % e PBB

Shpenzimet sociale*	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	17.0	16.5	16.0	16.0	16.1
Mali i Zi	14.2	13.3	14.1	14.2	13.9
Serbia	13.0	12.1	12.0	10.7	11.1
Kosova	6.2	6.9	7.7	7.6	7.5
Bosnjë-Hercegovina	15.4	14.8	14.2	13.7	13.8
Maqedonia e Veriut	13.3	13.2	13.5	13.8	14.0
Shqipëria	11.7	11.2	12.0	11.9	11.8
TOTALI	13.0	12.6	12.8	12.6	12.6

* përfshihen pensionet dhe shëndeti

Shpenzimet sociale janë gallabërueset e fondeve të buxhetit dhe në pjesën kryesore janë të financuara nga barra fiskale mbi pagat dhe kontributet e sigurimeve. Shpenzimet më të mëdha në 2018 (tabela 31) janë në Kroaci (16.1%) dhe pasohet nga Maqedonia e Veriut (14%). Kosova mban vendin e fundit për arsye se skema e shpenzimeve sociale nuk përfshihet në buxhet, por i nënshtrohet një skeme të bazuar në fonde pensionale, që është e modeluar ndryshe nga shtetet e tjera.



Në ballafaqimin midis të taksave mbi punën me shpenzimet sociale bie në sy fakti se Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi arrijnë të

mbulojnë shpenzimet sociale me taksat e punës të paguara në buxhet. Madje edhe të kenë edhe fonde për garanci të tjera të buxhetit. Kjo situatë është për arsye të barrës së lartë mbi taksat e punës.

Edhe pse kontributet nuk emërtohen në legjislacion si taksa, nisur nga fakti shumëvjeçar që ato janë të detyrueshme për tu paguar njësoj si taksat mbi të ardhurat personale, mbi të njëjtën të pagë, i vetmi element që i ndan nga taksat është sistemi i përfitimeve. Kur përmenden përfitimet, në rast se bëjmë një ndarje midis elementëve të shumtë të përfitimeve nga skemat që zbatohen në vend, të vetmet që lidhen me përjashtime nga rregulli i progresivitetit në taksim janë pensionet që do të paguhen në të ardhmen nga kjo pagesat aktuale të kontributeve. Në gjithë këtë mund të kuptojmë që taksimi progresiv nuk mundet të zbatohet dot në mënyrën e drejtë për të cilën ai dizajnohet, pasi pagesat e larta të kontributeve nuk mund të jenë pjesë e progresivitetit, pasi ato ndikojnë direkt në zinxhirin e rishpërndarjes së të ardhurave për të ardhmen e individit. Nga ana tjetër, të ardhurat e kontributeve nuk rishpërndahen për konsum publik apo të përdoren për qëllime të tjera, përtej atyre që garanton ligji për to.

Shpenzimet për administratën shtetërore (tabela 33) janë treguesi se sa i kushton shtetit tërësia e shërbimeve publike dhe sh të mirave monopol që furnizohen për qytetarët. Kroacia ka administratë më të kushtueshme se shtetet e tjera, por që nuk justifikohet me përmasat gjeografike apo ekonomike. Kështu, Mali i Zi që është ndër shtetet e BP-së me ekonomi të vogël ka një administratë që me kosto sa 10.7% e PBB-së. Por edhe Bosnjë-Hercegovina ka një kosto të administratës më të shtrenjtë se fqinji lindor i saj.

Tab.33 % e PBB

Shpenzimet për personelin e shtetit	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	11.7	11.8	11.6	11.7	11.9
Mali i Zi	11.4	11.0	11.0	11.2	10.7
Serbia	9.9	8.8	9.2	9.0	9.8
Kosova	8.7	9.0	9.0	8.6	8.7
Bosnjë-Hercegovina	12.0	12.0	11.7	11.2	10.8
Maqedonia e Veriut	4.4	4.4	4.4	4.2	4.2
Shqipëria	5.1	5.1	4.6	4.7	4.6
TOTALI	9.0	8.9	8.8	8.7	8.7

Ndërsa, kosto të lartë ka edhe Kosova megjithëse me një buxhet të vogël dhe që i kushton shtetit sa 8.7% e PBB-së. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut dallohen për kosto dy herë më të ulët se shtetet e tjera. Por, nëse kostoja e administratës është e lirë, përveç përfitimit buxhetor me gjasa shfaqet rrisja e shërbimeve

publike të paplota dhe me cilësi, por edhe për një shtet që ka deleguar disa funksione në sektorin privat duke lehtësuar buxhetin, por duke rritur për qytetarët koston e shërbimeve, që i ka deleguar te partnershipi privat.

Tab.32 % e PBB

Shpenzimet për investime kapitale	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	3.6	3.1	3.1	2.8	3.0
Mali i Zi	5.5	6.0	6.4	9.2	10.6
Serbia	2.5	2.8	3.1	2.8	3.3
Kosova	7.3	6.8	7.1	7.3	8.1
Bosnjë-Hercegovina	5.5	3.8	3.9	4.1	5.6
Maqedonia e Veriut	3.3	3.3	2.9	3.2	2.5
Shqipëria	4.3	4.4	3.9	4.4	5.0
TOTALI	4.6	4.3	4.3	4.8	5.4

Shpenzimet për investime publike dallojnë të jenë dukshëm më të larta në 2018 në Kosovë (8.1%) dhe Malin e Zi (10.6%) Bosnjë-Hercegovina dhe Shqipëria kanë nivele të afërta investimesh publike, respektivisht sa 5.6% dhe 5% e PBB-së. Ndërsa, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia kanë ruajtur një profil të ulët investimesh publike, nisur nga fakti se në këto shtete gjatë vitit 2018 kanë hyrë apo janë duke hyrë investime të huaja potenciale, të cilat realizojnë traqetin për investime dhe hapje vende pune dhe zgjerim të ekonomisë.

Sipas studimeve të fundit nga gjithë bota, theksohet fakti se një rritje e konsiderueshme në investimet publike mundet të nxisë punësimin në një kohë afatshkurtër dhe bazuar në rritjen e shpejtë të produktivitetit në dekadat e ardhshme buxheti përfiton të ardhurën e tij nga pagesa e dividendëve në vlera të konsiderueshme. Por, ndërkohë që investimet e huaja dhe ato private kanë një fokus më të qartë në përfitimet dhe rimarrjen e shpejtë të investimit, ndërkohë janë shprehur shqetësime lidhur me faktin e investimeve publike inteligjente nga sektori publik. Edhe në qoftë se rritja e investimeve publike në sektorë ekonomikë tradicionalë mund të rrisë performancën e ekonomisë, financimi i nevojshëm për investimet në sektorë që nuk kanë normë të lartë kthimi investimesh mund të paraqesë deformime ekonomike që do të zvogëlojnë rritjen në terma afatgjatë. Nëse është kështu, kjo çështje vlen të diskutohet jo vetëm lidhur me faktin se sa investime publike duhen ndërmarrë (sasia), por edhe se si/ku kryhen financimet (cilësia). Një program investimesh të mëdha publike mund të arrijë një shtytje të madhe të sektorëve të ekonomisë, ose mund të stimulojë investime të shumta private, të cilat së bashku përbëjnë një shtytje të madhe në të dy sektorët, privat dhe publik.

Nisur nga fakti se shpenzimet janë sinjali se ku duhet të planifikohen më saktë të ardhurat, nevojitet që të bëhen edhe modifikime të politikës buxhetore përfshirë dhe atë fiskale me synimin e rritjes së efikasitetit të përdorimit të taksave dhe të ardhurave të tjera buxhetore.

Në Shqipëri, financat publike janë drejt performimit, që tregon për konsolidim të tyre, por borxhi publik mban ende peng politikën stimuluese buxhetore dhe fiskale. Nevojitet një përpjekje e fortë për të krijuar një hapësirë të nevojshme për shpenzimet në fusha kyçe, si infrastruktura, shëndetësia dhe arsimit. Vonesat në ndjekjen e reformës së energjisë mund të vendosin përsëri stabilitetin e buxhetit në rrezik. Shpejtësia e reduktimit të borxhit në përputhje me politikën optimale ka të ngjarë të jetë shumë e ngadaltë, me të paktën sa gjysma e kohës së rregullimit të borxhit duke arritur më tej se 10 vite.

Kosova po redukton burokracinë joefikase dhe korrupsionin në shërbimet që mendohet se sjellin përfitime të paligjshme. Kosova tani po punon për të ringjallur investimet kapitale për rritjen e rritjes. Investime të kujdeshme financiare, publike, dhe menaxhim të buxhetit po ndihmojnë vendin që të sigurojë minimizimin e rreziqeve fiskale që lidhen me investimet, të cilat duhet të lehtësojnë presionet mbi qëndrueshmërinë afatmesme të borxhit.

	% e PBB				
Deficiti/ Suficiti buxhet	2014	2015	2016	2017	2018
Kroacia	-5.4	-3.4	-0.8	0.9	0.4
Mali i Zi	-0.9	-6.4	-6.3	-6.5	-5.6
Serbia	-6.6	-3.6	-1.1	1.1	0.6
Kosova	-2.4	-1.6	-1.0	-4.3	-3.9
Bosnjë-Hercegovina	-2.9	-0.2	0.4	2.1	1.3
Maqedonia e Veriut	-4.2	-3.5	-2.7	-2.7	-2.8
Shqipëria	-5.9	-4.6	-2.3	-2.0	-2.2

Vetëm pak shtete kanë suficite buxhetore. Të tjerat nuk e kanë këtë mundësi duke e subvencionuar vit pas viti buxhetin. Përdorimi i subvencionimit financiar nëpërmjet kreditimit të buxhetit tregon se suksesi i provuar nga zbatimi i kësaj politike në firmat private mund të jetë përgjigja për të ndryshuar modelet e menaxhimit financiar në administratën publike. Për më tepër, ky model dikton nevojën absolute për "temën kryesore" të institucioneve publike, njësoj si menaxhohet buxheti i firmave private që rritin përdorimin me efikasitet të mjeteve të planifikimit të tilla si plani i biznesit.

Një orientim i ri i politikës buxhetore të Ballkanit Perëndimor duhet të jetë edhe instrumenti i financimit të hapur monetar. I vetmi qëllim i parave të reja është financimi i stadit fillestar të stimullit fiskal përmes buxhetit. Me zbatimin e këtij stimuli paratë e reja mund të kërkohen nga ekonomia, duke patur parasysh që të ketë mjaftueshëm likuiditete për vijimësinë e aktivitetit ekonomik.

Financimi monetar direkt do të përfshijë krijimin e depozitimeve shtesë në vend të parave letër në qarkullim. Ky stad do të karakterizohet fillimisht në një ambient financiar i mbizotëruar nga depozitimi i parave në llogaritë e qeverisë, të cilat më pas do të transferohen në llogaritë private të depozitave ose si një ulje e një ose disa taksave, ose përmes shpenzimeve publike shtesë.

5. Liria Fiskale në vitin 2019

Indeksi i Lirisë Fiskale 2019

Metodologjia

Dita e Lirisë Fiskale llogaritet në bazë të raportit të të ardhurave tatimore për vitin fiskal me produktin e brendshëm bruto. Të ardhurat tatimore përfshijnë të gjithë llojet e taksave dhe tatimeve, detyrimet doganore, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Totali i të ardhurave tatimore llogaritet si një përqindje ndaj PBB-së. Raporti që rezulton shumëzohet me numrin e diteve të vitit (për vitin 2016 viti përmban 366 ditë). Numri që rezulton llogaritet si ditë të muajve duke filluar nga 1 Janari. Numri i ditëve të ndarë, sipas ditëve të çdo muaji vijues ndalon deri në ditën që plotësohet sipas muajit që i përkon. Ajo ditë që llogaritja ndalon konsiderohet si Dita e Lirisë Fiskale.

Kuptimi i kësaj dite lidhet me faktin se tatimpaguesit e vendit në këtë ditë kanë mbyllur llogaritë e pagimit të detyrimeve tatimore dhe nga kjo ditë e vitit e në vijim ata punojnë për veten e tyre, pa i patur asnjë detyrim tatimor shtetit.

Llogariteni Ditën e Lirisë Fiskale për veten tuaj

Dita e Lirisë Fiskale përfaqëson popullin shqiptar në tërësi. Por, cila është Dita juaj e Lirisë Tatimore?

Ja një mënyrë e thjeshtë për ta llogaritur atë për çdo vit më parë.

Nëse ju do të keni të gjithë informacionin që ju nevojitet kur të paguani taksat tuaja llogaritja është një konkluzion i thjeshtuar veprimesh. Së pari, shtoni detyrimet tuaja totale ndaj zyrës së tatim taksave qendrore (për rastet kur jeni i regjistruar si aktivitet) si dhe taksat dhe tarifat vendore.

Në rastin e individit që nuk është i regjistruar në zyrën e tatimeve, por ka të ardhura nga burime të ndryshme duhen përfshirë në këtë llogaritje gjithë tatimet dhe taksat që paguani për shërbimet që ju kërkohen, si dhe ato që ju mbahen në burim (p.sh. tatimi mbi pagën, tatimi mbi interesat, taksat e bashkisë etj. të ngjashme).

Në kahun tjetër, regjistroni llogaritni të ardhurat bruto që keni marrë gjatë vitit që kaloi. Nga raporti midis gjithë totalit të taksave dhe tarifave të paguara dhe gjithë të ardhurave tuaja bruto rezulton një numër. Ky numër është dita e fundit e vitit që lidhet me barrën fiskale. Pas kësaj date që përkon në kalendar me një ditë të muajve të vitit konsiderohet si Dita juaj e Lirisë Fiskale.

5.1. Dita e Lirisë Fiskale në 2019 në Ballkanin Perëndimor

Sipas llogaritjeve të ALTAX, këtë vit Dita e Lirisë Fiskale për Ballkanin Perëndimor bie ditën e 122^{të} të vitit 2019. Këtë vit liria fiskale vjen 5 ditë më vonë se viti i kaluar. Dita e Lirisë Fiskale është data treguese për tu informuar, se në çfarë dite të vitit në mënyrë simbolike barra ndaj buxhetit të shtetit është përbushur. Pas kësaj dite të ardhurat e mbetura janë për të paguar shpenzimet individuale, familjare apo shpenzime për bizneset. Nga llogaritja e ditëve që konsumohen në secilin shtet për të paguar barrën fiskale, sipas të dhënave që deklarohen secili nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, rezultojnë se në varësi të nivelit të barrës fiskale ndaj PBB-së, Dita e Lirisë Fiskale në 2019 në Ballkanin Perëndimor vjen në **2 Maj**.

KALENDARI I LIRISË FISKALE 2019

Shteti	Ditët për buxhetin*	Data e Lirisë Fiskale
SHQIPËRI	93	3 Prill
MAQEDONI E VERIUT	97	7 Prill
KOSOVË	98	8 Prill
SERBI	139	9 Maj
BOSNJË-HERCEGOVINË	140	10 Maj
MALI I ZI	140	10 Maj
KROACI	144	14 Maj

* llogaritjet janë nga ALTAX

Liria Fiskale fillon udhëtimin nëpër rajon duke trokitur së pari në Shqipëri në 3 Prill. Më pas shkon në Maqedoninë e Veriut në 7 Prill. Pasi festa është mbyllur në këto dy shtete, Dita e Lirisë Fiskale mbërrin në Kosovë në 8 Prill dhe pas gati 1 muaj më vonë liria fiskale arrin në Serbi, më 9 Maj. Në datën 10 Maj, Liria Fiskale festohet në dy shtete njëkohësisht, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Malin e Zi. Liria Fiskale festohet së fundmi edhe në Kroaci në datën 14 Maj dhe rajoni i Ballkanit nis e ndihet i gjithi i liruar nga barra fiskale që i detyrohej buxhetit.

Këtë vit, Shqipëria e feston Lirinë Fiskale 5 ditë përpara Kosovës. Nisur nga data kur festohet Liria Fiskale, secili kupton se sa i rëndon barra e buxhetit qytetarëve të vendit, por nga ana tjetër është indeksi që tregon se sa ditë të lira kanë bizneset dhe individët përgjatë vitit për të punuar për veten dhe familjet e tyre.

Pse ndryshon çdo vit Dita e Lirisë Fiskale?

Përgjigja është e thjeshtë dhe e lidhur ngushtë me të ardhurat që mbledhen nga administrata fiskale dhe agjensitë që mbledhin kontribute për

buxhetin e shtetit. Sa më shumë të ardhura të mbledhen gjatë një viti, aq më vonë festohet Dita e Lirisë Fiskale për vitin pasardhës. Shqipëria e festoi më herët në 2019 pasi ajo mbledhi më shumë të ardhura se një vit më parë, por në raport me PBB-në zë një peshë më të vogël. Po kështu edhe Kosova dhe vende të tjera që efestuan më vonë se një vit më parë.

Kalendari i Indeksit të Lirisë Fiskale 2019, përfshin 7 shtetet e Ballkanit Perëndimor, për të cilët ishte i mundur edhe disponibiliteti dhe përpunimi i të dhënave statistikore për PBB dhe të ardhurat buxhetore të mbledhura në këto vende, por duke llogaritur shtrirjen e barrës fiskale përgjatë muajve të vitit 2019.

5.2. Dita e Lirisë Fiskale në 2019, në Shqipëri

Me datën e këtij viti, që është afuar me 2 ditë, Dita e Lirisë Fiskale festohet në ditët e para të Prillit. **Liria Fiskale për vitin 2019** është në ditën e 93^{të} të vitit, që bie në datën **3 Prill**.

Kjo datë u tregon gjithë shqiptarëve se sa u është dashur të punojnë për buxhetin e shtetit të tyre dhe u tregon se kjo periudhë ka zgjatur deri afër fundit të dhjetëditëshit të tretë të muajit të tretë të vitit. Pas kësaj periudhe, fitimet nga puna dhe kapitali i përkasin individit dhe pronarit të biznesit, pasi konsiderohet se buxheti ka arritur për vetëm 3 muaj dhe 3 ditë të marrë nga ata një pjesë të fitimeve të gjeneruara nga puna apo kapitali.

Dita që feston gjithë Shqipëria nuk përkon me ditën e lirisë fiskale të secilit qark, pasi barra fiskale për Shqipërinë llogaritet si mesatare e gjithë barrës fiskale të qarqeve të vendit.

Sipas barrës fiskale të secilit qark, si dhe nga llogaritja sipas kalendarit të vitit rezultojnë që Liria Fiskale të vijë në 10 qarqet dhe qytetet shqiptare në 3-mujorin e parë të vitit 2019. Durrësi dhe Tirana janë të vetmit që e festojnë Lirinë Fiskale në fillim të Prillit 2019

Liria Fiskale në 2019 vjen fillimisht në qarkun e Fierit duke çelur festën e lirimit nga barra fiskale në 13 Mars.

Banorët e Dibrës e festojnë këtë ditë 1 ditë më pas. Qarku i Kukësit e feston lirinë fiskale në 20 Mars.

KALENDARI I LIRISE FISKALE 2019

Rajoni	Ditët për buxhetin*	Data e Lirisë Fiskale
FIER	72	13 Mars
DIBER	73	14 Mars
KUKES	79	20 Mars
ELBASAN	82	23 Mars
BERAT	84	25 Mars
LEZHE	87	28 Mars
KORCE	88	29 Mars
VLORE	89	30 Mars
GJIROKASTER	90	31 Mars
SHKODER	90	31 Mars
DURRES	94	4 Prill
TIRANE	103	13 Prill

* Ilogaritjet janë nga ALTAX

fiskale kalon në Korçë dhe e vijon udhëtimin e saj në jugperëndim të vendit, në Vlorë në datë 30 Mars. Liria fiskale festohet njëkohësisht në dy qarqe në datën 31 Mars, që janë në dy skajet e vendit, në Shkodër dhe në Gjirokastrë.

Pas disa ditësh pushime, festimi i lirisë fiskale bie në Durrës në 4 Prill. Festimet e lirisë fiskale mbyllen në Tiranë, kryeqyteti i Shqipërisë më 13 Prill. Këtë vit Tirana e feston lirinë fiskale 2 ditë më vponë se viti i kaluar

Pas kësaj date gjithë tatimpaguesit mund të llogaritin që të ardhurat që u mbeten ti përdorin për qëllimet dhe nevojat e tyre për konsum, kursim, apo investime. Kjo lehtësi, ndihmon në nxitjen e një konsumi më të madh për familjarët, si dhe në rritjen e kursimeve dhe përdorimin e tyre për investime nga bizneset. Por, në realitet përtej simbolikës së datës, planifikimet bëhen bazuar mbi programet që bazohen te performanca e biznesit apo individuale.

5.3. Dita e Lirisë Fiskale në 2019, në Kosovë

Liria Fiskale në Kosovë mbërrin ditën e 98^{të} të muajit Prill 2019, apo 5 ditë pasi ka mbërritur në Shqipëri. Këtë vit festimet fillojnë 2 ditë më vonë se viti i kaluar.

Dita e festës së Lirisë Fiskale shkon në Kosovë në 8 Prill dhe ajo është shtyrë në kohë nëpërmjet

KALENDARI I LIRISE FISKALE 2019

Rajoni	Ditët për buxhetin*	Data e Lirisë Fiskale
Mitrovicë	72	26 Mars
Prizren	73	3 Prill
Pejë	79	6 Prill
Gjakovë	82	13 Prill
Gjilan	84	15 Prill
Ferizaj	87	16 Prill
Prishtinë	88	20 Prill

* Ilogaritjet janë nga ALTAX

barrës fiskale që është më e lartë në Kosovë në krahasim me Shqipërinë.

Festa e Lirisë Fiskale në Kosovë për vitin 2019 mbërrin më shpejt në rajonin e Mitrovicës në ditën e 26^{të} të muajit Mars. Ky rajon e feston këtë vit Ditën e Lirisë Fiskale 2 ditë më herët, bazuar në të ardhurat që janë mbledhur gjatë vitit 2018.

Shumica e taksapaguesve që janë rezidentë të 6^{të} rajoneve të Kosovës e festojnë Ditën e Lirisë Fiskale gjatë muajit Prill. Vetëm Mitrovica e feston në ditët e fundit të 3-mujorit të parë të vitit.

Taksapaguesit në rajonin e Prizrenit e festojnë lirinë fiskale në datën 3 Prill, që bie 1 ditë më vonë se viti i kaluar. Taksapaguesit e Pejës e festojnë lirinë fiskal në 6 Prill, apo 3 ditë më vonë se viti i kaluar. Pas disa ditësh pushimi festa e lirisë fiskale rifillon të festohet në datën 13 Prill në Gjakovë. Pas 2 ditësh të tjera pushimi festa kalon në rajonin e Gjilanit në datë 15 Prill. Banorët e Ferizaj e festojnë lirinë fiskal vetëm 1 ditë më vonë se Gjilani. Të fundit që e festojnë janë banorët e rajonit të Prishtinës dhe komunave të saj. Ata lirohen nga detyrimet për buxhetin në datë 20 Prill.

Festa e ditës së Lirisë Fiskale në Kosovë është shtyrë pothuajse gjatë Prillit, për arsye se performanca e të hyrave në buxhet përgjatë vitit 2018 në të gjitha rajonet e Kosovës ka përmirësime të mëtejshme nga viti i kaluar.

Megjithatë mbetet sfida e pamohueshme lufta që duhet të fillojë me forcë për të shtyrë drejt kufijve minimale evazion tatimor, i cili po tenton të kalojë kufijtë që ishin vendosur deri më sot dhe po fillon të ndikojë në barazinë tatimore të taksapaguesve. Ky fakt duket edhe te shpërndarja e të ardhurave sipas Indeksit GINI, të përmendur më lart. Kosova ka përqendrim të situatës së shpërndarjes së të ardhurave nga vetëm pesë vite më parë.

ALTAX e llogarit për herë të 3^{të} Indeks in e Lirisë Fiskale për Kosovën.

Përmbledhje

Politika fiskale e ndikon rritjen ekonomike nëpërmjet katër drejtimeve kryesore: ofertës për vende pune, kapitalit fizik, kapitalit njerëzor dhe inovacionit teknologjik. Produktiviteti i fuqisë punëtore në ekonomi është pasqyra më e qartë e një numri faktorësh, duke përfshirë kapitalin njerëzor, kapitalin fizik me të cilin ata duhet të punojnë dhe teknologjinë në dispozicion të tyre.

Pasiguria ekonomike ende nuk është larguar nga Ballkani Perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri, Serbi çoi edhe në situata paqëndrueshmërie politike. Vetëm Kroacia tregoi për një ndikim pozitiv të situatës politike në ndihmë të IHD-ve, në reduktimin e papunësisë, edhe pse norma e papunësisë mbetet ende e lartë. Duke pasur parasysh shpenzimet e pakta të investimeve kapitale në shumicën e shteteve, si dhe kërkimin e një modeli ekonomik funksional në terma afatgjatë nevojitet qëndrueshmëria e performancave buxhetore dhe konsolidimit fiskale, në mënyrë që të arrihet zhvillimi ekonomik, dhe garantimi mirëqenies sociale.

Barra fiskale, si një e ardhur e deleguar nga tatimpaguesit për buxhetin e qeverisë, kur ajo nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë dhe të adresohet sipas nevojave të qytetarëve dhe përparimit ekonomik do të jetë një kosto ekonomike për vendin që çon në shtrejbërime politike dhe sociale.

Barra fiskale ende nuk është qëllimi kryesor i transparencës së qeverive të Ballkanit Perëndimor. Shtetet duhet të fillojnë të mendojnë dhe vendosin objektiva lidhur me shpërndarjen e barrës drejt atyre segmenteve të tatimpaguesve dhe qytetarëve që kanë mundësi më të mëdha për të përballuar pjesën kryesore të barrës fiskale, por veçanërisht drejt ngushtimit të evazionit nëpërmjet formalizimit të ekonomisë.

Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova nuk përbëjnë më shumë se ¼ e PBB-së së Ballkanit Perëndimor. Nisur nga kjo peshë ekonomike ato të 4^{ta} së bashku janë pak ndikuese në marrëdhëniet e ekonomisë së rajonit dhe për të synuar një politikë të izoluar fiskale. Megjithatë, vërehet një rritje e barrës në 2018 krahasuar me periudhat më përpara dhe i kanë dhënë më tej shtytje dimensioneve të buxhetit dhe politikës së taksave.

Politika e taksave ka ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e ofertës së tregut të punës, si rastet e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Penetrimi i teknologjisë në ekonomi dhe nxitjet e fundit në legjislacionin fiskal (rasti i Shqipërisë) për lehtësim barre në taksimin e fitimeve të kompanive në programim dhe teknologji informatike duke i parë nën optikën e taksave të kapitalit pritet të nxitin investime nisur nga ulja e kostonë së taksave direkte. Uljet e normave të tatimit mbi fitimin mundet të inkurajojnë bizneset të investojnë në kapitalin fizik, i cili mund të bëjë më produktiv punën e fuqisë punëtore.

Nëse shikohen Investimet e Huaja Direkte neto Shqipëria është në vend të dytë në Ballkan për peshën e tyre në raport me PBB-në për periudhën 2016-2018. Ndërsa Mali i Zi ka mbajtur vendin e parë në rajon për IHD Neto si % e PBB-së në 2018. Studimet dhe anketimet e kryera tregojnë se është e mundur që tatimet të kenë ndikim edhe në IHD. Por, shembulli nga dy shtete me modele taksimi të ndryshme të të ardhurave janë prova e qartë se efekti i normave tatimore nuk është ndikuesi primar në tërheqjen e investimeve. Nëse normat tatimore harmonizohen me sukses me rritjen e kapaciteteve të administrimit dhe forcimin e kapaciteteve rregullatore dhe uljen e korrupsionit, atëherë pritet të rezultojë një rritje e flukseve të investimeve të huaja në vend.

Tatimet mbi të ardhurat, mbi konsumin dhe punën ndikojnë në nxitjen për rritjen/uljen e vendeve të punës. Kështu, ndërsa oferta e punës mund të jetë joelastike në një periudhë afatshkurtër, që do të thotë se efekti bie mbi fuqinë punëtore, nëse e shikojmë për një periudhë afatgjatë, elasticiteti i furnizimit të punës duhet të jetë më i lartë. Sipas kësaj logjike, taksat mbi punën dhe taksat e konsumit rrisin kostot e pagave për punëdhënësit. Shpenzimet e larta për pagat (paga dhe tatime) mund të shkaktojnë efektin frenues të bizneset rezidente të mendojnë se si të zëvendësojnë kapitalin për investime me atë për punësime, duke ulur kështu fondet e tyre për investime. Nga ana tjetër, një ekonomi me kosto të lartë të pagave mund të ketë efekte negative ndaj fondeve të investimeve.

Barra fiskale e shpërndarë në rajonet e ndryshme, nëse ballafaqohet me burimet dhe kapacitetet në dispozicion, si dhe nëse ndërthuret në mënyrë më racionale me

ekonominë që synohet të zhvillohet, ndikimi i rolit të programeve të qeverisë në shpërndarjen e investimeve dhe përgatitjen e kushteve për investitorët aty ku barra nuk është nxitëse do të ndihmonte secilën bashki, që të mendojë më thellë mundësitë dhe mënyrat për tu integruar brenda modelit të të bërit ekonomi dhe buxhet.

Ndërkohë, politika fiskale duhet të ketë lidhje të forta me zhvillimin e strukturës së ekonomisë, duke analizuar pa ndërprerje ndryshimet dhe zhvendosjet e ecurisë së ekonomisë nga njeri sektor te tjetri duke i pararendur tregut dhe konkurrencës globale. P.sh. ndikimet e thatësirës në vitin 2017 dhe 2018, treguan se parashikimi për rishpërndarjen e barrës fiskale nuk duhet të mbetet statik dhe të bëhet vetëm një herë. Barra fiskale duhet të synojë të shtrihet në territoret e evazionit, por edhe në dinamikat e ekonomisë.

Duke pasur parasysh nivelet e ulëta të pjesëmarrjes në treg të fuqisë punëtore, investimeve kapitale dhe produktivitetit poshtë kapaciteteve të ekonomisë është e rëndësishme që reforma e taksave të funksionojë në të gjitha këto drejtime për të gjallëruar rritjen ekonomike, si pjesë e mozaikut ekonomik të nevojshëm për të fituar me konkurentët rajonalë.

Nuk është vetëm barra fiskale ajo që duhet të tërheqë vëmendjen e taksapaguesve dhe mediave në rajon. Ekonomia është përpara gjithshkaje. Konkurrenca fiskale, e cila ka filluar prej shumë vitesh në Ballkanin Perëndimor, po çon vërtet politikën në drejtim të uljes së taksave në nivele më të ulëta, por në mjaft raste këto ulje nuk janë efikase. Një shembull është fuqia punëtore. Nëse krahu i punës është i palëvizshëm (nuk emigron), edukimi dhe shëndetësia që financohen nga buxheti i shtetit rritin produktivitetin e punës dhe janë në këtë kuptim një vlerë e shtuar publike në ekonomi. Por, në qoftë se krahu i punës është i lëvizshëm, atëherë edukimi dhe shëndetësia mund të konsumohen në vendin që e mirëpret kapitalin njerëzor të furnizuar nga një vend tjetër.

Një gjetje e fortë nga gjithë analiza është se jo të gjitha ndryshimet e normave tatimore mund të kenë efekt në rritjen ekonomike, të konsumit apo edhe të investimeve të huaja. Reformat që përmirësojnë nxitjen për investime, reduktojnë mbështetjet buxhetore për sektorë të

ekonomisë publike, shmangin kolapset financiare dhe thellimin e borxhit publik kanë një efekt të qartë dhe të dukshëm për gjithë qytetarët lidhur me ecurinë afatgjatë të ekonomisë.

Nga vlerësimet tona mbi ndikimin e rritjes së arkëtimeve të tatimit mbi të ardhurat prej kapitalit dhe konsumit, pra barrës fiskale reale (të cilat kontrollojnë edhe fluksin për të ardhurat nga puna dhe qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve) rezulton se taksat e larta e inkurajojnë largimin e investimeve drejt vende që kanë ambient të ngjashëm ekonomik, por me norma më të ulëta tatimore. Por, në rast se rritet potenciali i administrimit fiskal duke rritur arkëtimet pa ndryshuar normat tatimore, atëherë kjo nuk është rritje taksash, por fillimi i zbatimit më korrektësisht të legjislacionit fiskal.

Taksat dhe investimet ecin perpjestimisht në të njëjtin kah për vendet e Ballkanit, pasi tregojnë se shteti dhe ligji po forcohen. Kjo dëshmi shton më shumë mbështetjen për idenë se kur reformohet politika tatimore, ka arsye të mirë për qeveritë që të marrin parasysh ndikimet e politikës tatimore në atraktivitetin e vendit të saj ndaj flukseve të investimeve.

Çfarë duhet të vlerësojmë nga kjo panoramë ballkanike?

Së pari, një klimë biznesi në të cilën rregullat e lojës duhet të jenë të thjeshta, transparente dhe të respektuara nga qytetarët, në të cilat bizneset e vogla mund të rriten në kompani të mesme dhe madje edhe në të mëdha.

Së dyti, siguria më e madhe rregullatore për të inkurajuar investimet dhe konkurrencën.

Së treti, ekonomia zhvillohet më tej pa praninë me tepri të sektorit publik në ekonomi, veçanërisht në biznes dhe tregti, me qëllimin për të zgjeruar hapësirën për rritjen e sektorit privat dhe për të lehtësuar sipërmarrësit nga konkurimi që nuk mund ta fitojnë dot me sektorin publik.

Së katërti, nevojitet mjaft fleksibilitet në tregun e punës për të lejuar të rinjtë të gjejnë punë.

Së pesti, vlen zvogëlimi i barrierave dhe mbrojtjeve jo-tarifore për industritë vendase në mënyrë që kompanitë të mund të bëhen pjesë e zinxhirit të furnizimit global dhe mund të zgjerohen për të kapur një pjesë më të madhe të tregut rajonal.

Së gjashti, një sistem ekonomik i ndërtuar mbi drejtësinë dhe pa korrupsion.

SHTOJCA

Kutia 2. Regjimet fiskale dhe ndryshimet ligjore në Ballkanin Perëndimor, 2019

1. Bosnjë – Hercegovina

Bosnjë-Hercegovina ka në përbërje të administrimit tatimor 4 struktura që zbatojnë legjislacionin tatimor: Autoritetin e Tatimeve Indirekte; Administratën Tatimore të Bosnjë-Hercegovinës; Administratën e Distriktit të Brčko; Administratën tatimore të Republikës Serbe. Nga këto juridiksione tatimore, dy prej tyre janë kryesore: Administrata Tatimore Federative e Bosnjë-Hercegovinës dhe Administrata tatimore e Republikës Serbe. Ndryshimet ligjore dhe kuadri ligjor më së shumti janë referencë për zbatim për administratën tatimore të Bosnjë-Hercegovinës. Kuadri rregullator midis administratave të juridiksioneve të ndryshme ka harmonizim, por me diferenca të caktuara lidhur me tatimet direkte.

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar**, sipas Ligjit Për kontabilitetin dhe Auditimin janë të zbatueshme sipas SNK dhe SNRF të gjithë territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

Vendi i **rezidencës fiskale** përcaktohet bazuar regjistrimit të një biznesi si një entitet juridik, apo ku ka vendin kryesor të aktivitetit duke zbatuar kriteret e vendqëndrimit të përhershëm, apo nëse janë subjekt i tatimit në burim. Riatdhesimi i fitimeve pas tatimit është i lejuar.

Taksimi i **rezidentit fiskal** bëhet duke marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara brenda dhe jashtë vendit. Kompanitë jorezidente taksohen vetëm për të ardhurat që burojnë nga aktiviteti brenda juridiksionit të vendit.

Dividentët taksohen me normën e sheshtë 10%. Dividentët, që përfitohen nga filialet e biznesit brenda të njëjtit juridiksion fiskal janë të përjashtuara nga tatimi mbi fitimin. Ndërsa, dividentët të përfituar nga burime jashtë vendit përfshihen në të ardhurat e tatueshme. Rezidentët fiskalë lejohen të kreditojnë tatimin e paguar jashtë vendit.

Fitimet nga kapitali taksohen me një normë tatimore 10%.

Tatimi mbi fitimin zbatohet me normën 10%. **Deklarimi i konsoliduar** i pasqyrave financiare lejohet, me kushtin që njëra kompani të zotërojë mbi 50% të aksioneve të tjetrës.

E re! Nxitjet për investime, (a) ulje me 50% e tatimit mbi fitimin nëse një kompani investon mbi 25.5 milion Euro në aktive prodhuese, (b) ulje 30% e tatim fitimit nëse investon mbi 50% të vlerës që kalon fitimet para tatimit në pasije për prodhim, (c) njohje dyfishin e shpenzimeve për paga për punësime të reja që zgjasin përtej 12 muajve.

Humbjet tatimore mund të mbarten për një periudhë 5 vjeçare. Humbjet mund të pakësohen nga fitimi i vitit pasardhës.

Shitja e pasurisë së paluajtshme është subjekt i taksimit të transferimit të të drejtës së pronësisë e vendosur në nivel rajonal, duke variuar nga 0.05% deri 0.5% e vlerës së transaksionit, sipas referencës së tregut të hapur. Përgjegjës për pagimin e këtij tatimi mund të jenë si shitësi, po ashtu edhe blerësi. Kjo përgjegjësi është e përcaktuar në rregullat e vendosura nga rajonet.

Taksa e trashëgimisë dhe dhurimit vendosen në nivel rajonal dhe varion nga 2% deri 10%, njësoj si në rastin e përcaktimit të vlerës nga tregu.

TVSH zbatohet në të gjithë shtetin e Bosnjë-Hercegovinës me të njëjtat rregulla dhe përjashtime. Norma standarte e TVSH-së është 17% për vitin 2019.

Pragu i regjistrimit për në TVSH vlen për bizneset dhe individët që kryejnë transaksione mbi vlerën 25.560 Euro në vit. Por, regjistrimi në TVSH mund të bëhet edhe vullnetarisht, pavarësisht nëse nuk realizohet një xhiro vjetore mbi pragun e përcaktuar.

Përjashtohen nga TVSH shërbimet publike, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet financiare. Eksporti taksohet me normën 0%. Për vitin 2019 nuk ka ndryshime ligjore përveç atyre sa përshkruar më lart.

2. Kosova

Sistemi tatimor në Kosovë përbëhet nga një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative, ku përfshihen: (a) Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK), (b) Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP), (c) Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), (d) Detyrimet Doganore, (e) Akciza, si dhe Dispozitat e Veçanta, Transferimi i Çmimeve dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të Shmangies së tatimit të dyfishtë.

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë të zbatueshme sipas Standarteve Kontabile të Kosovës, të bazuara në SNK dhe SNRF. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto prej 50.000€ ose më tepër dhe ata me të ardhura vjetore bruto më të ulëta se 50.000€, të cilët zgjedhin të taten në bazë të të ardhurave reale, mban librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Tatim në të Ardhura të Korporatave dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Rezidenca fiskale përcaktohet sipas parimeve të vendqëndrimit të përhershëm të OECD.

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave aplikohet në të ardhurat e tatueshme të korporatave. Norma standarte e tatimit në të Ardhura të Korporatave është 10% e të ardhurave të tatueshme. Lejohet kreditimi tatimit të huaj.

E re! Të ardhura të tatueshme për një periudhë tatimore bazohen mbi ndryshimin në mes të të ardhurave bruto të pranuar apo të rrjedhura gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve të lejueshme në lidhje me të ardhurat bruto të tilla.

Humbja tatimore mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite. Mbartja e humbjes nuk lejohet nëse biznesi ka ndryshim në pronësi prej më shumë se 50%, apo nëse një ndërmarrje personale afariste është ndryshuar në ndonjë formë tjetër biznesi (entitet juridik, ortakëri apo të ngjashme).

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore prej 50.000€ apo më pak, taten në masën 3% (për veprimtaritë siç është tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale) apo 9% (për veprimtaritë shërbyese, profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme). Tatimpaguesit me të ardhura bruto

vjetore mbi 50,000€ taten me 10% në të ardhurat e tatueshme.

Tatimpaguesi që paguan qira mban tatimin në burim 9% në kohën e pagesës apo të kreditimit.

Tatimpaguesi që bënë pagesa për personat fizik jo-afaristë, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve ricikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, në momentin e pagesës mban tatimin në burim në shkallën prej 3% në bruto pagesë

Fitimet nga kapitali takohen me një normë tatimore 10%.

Kompanitë e sigurimit (që bëjnë sigurimin ose ri-sigurimin e jetës, pronës, rreziqeve tjera) paguajnë 5% tatim në primet bruto të periudhës tatimore (në vend të Tatimit në të Ardhura të Korporatave).

Punëdhënësi i cili është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, **mban në burim** një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave. Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, mbanë në burim shumën prej 10% të pagave të tatueshme për periudhën tatimore.

Pensionet e paguara nga, apo për interes të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve i rregulluar me legjislacionin mbi kontributet pensionale, si dhe sigurimet shëndetësore sipas Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve apo i sigurimeve shëndetësore të tilla në shkallët e parapara në legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale;

TVSH është përshkallëzuar në dy norma: atë standarde prej 18% dhe në normën e reduktuar 8% te vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendshme të tatueshme për mallrat ushimore bazë dhe energjinë elektrike, me përjashtim të furnizimeve të liruara dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte.

Taksa doganore është 0% - 10%. Shumica e lëndëve të para janë të liruara. Po ashtu, edhe shumica e pajisjeve për prodhimin janë të liruara. Disa nga materialet e papërpunuara bujqësore (të tilla si farat, etj.) dhe pajisjet janë të liruara nga Dogana dhe TVSH-ja.

3. Kroacia

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë të zbatueshme sipas SNK dhe për kompanitë publike të listuara dhe kompanitë e mëdha. Standartet e Raportimit Financiar të Kroacisë janë të detyrueshme për zbatim për bizneset e vogla dhe të mesme të palistuar.

Format juridike të bizneseve janë (a) tregtari thjeshtë, (b) shoqëritë anonime, (c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, (d) grupimet ekonomike, (e) partnershipi, (f) degët dhe zyrat e përfaqësimit.

Vendi i **rezidencës fiskale** përcaktohet bazuar te regjistrimi si një entitet juridik në Kroaci, apo nëse kontrollohet dhe menaxhohet në Kroaci. Rezidenca përcaktohet edhe nëse plotëson kriteret e vendqëndrimit të përhershëm.

Dividenti nuk është subjekt i tatimit mbi të ardhurën korporatave, por janë objekt i tatimit në burim me normën 12%, përveç pagesës që bëhet ndaj një eniteti rezident në Kroaci.

Interesat bankare, të ardhurat nga trashëgimnitë dhe të drejta autorësie, shërbime teknike (përveç atyre që paguhen në shtete të konsideruara si parajsa fiskale) **tatohen në burim** me normën standarte 15%.

Norma standarte e **tatimit në të Ardhura të Korporatave** është 18% e të ardhurave të tatueshme. Tatimpaguesit që realizojnë një xhiro nën 403.470€ tatohen me normën 12%.

Politika e **kapitalizimit të hollë** zbatohet, për rastet e interesave kur aksioneri që zotëron 25% apo më shumë aksione/drejtë votimi merr hua që kalon 4 herë vlerën e aksioneve në kompani.

Fitimet nga kapitali taksohen me normë tatimore nga 12% deri 36%, në varësi të natyrës së transaksionit.

Tatimi mbi të ardhurat personale tatohet në mënyrë progresive nga 24% deri në 36%.

E re! Kategori e re e pagesave të patatueshme të lidhura me bonuset për punëmarrësit dhe forma të tjera kompensimi për ta (shtesa page) është 670€.

E re! Kufiri i fashës së pagave që tatohen me 24% rritet në 2019 nga 2.355€ në 4.030€. Të ardhurat mbi këtë kufi pagë tatohen me 36%.

Nuk taten nga Janari 2019, (a) Shpërblimet vjetore mbi 6.700€, që u paguhen punonjësve, (b) dhuratat për raste festash mbi 330€.

Tatimi mbi trashëgiminë dhe pasurinë, për vlera mbi 6.700€ të transfertave të parave, të transfertave të aktiveve financiare, apo pasurive të luajtshme aplikohet me normën 5%.

E re! Me synimin për të ulur barrën fiskale, norma e tatimit mbi pasurinë nga Janari 2019 reduktohet në 3% për transaksionet e pasurisë së paluajtshme që nuk janë subjekt i TVSH-së.

Tatimi mbi fitimin zbatohet me normën 18%.

Nxitjet për investime (a) kompanitë që kualifikohen si investitorë sipas ligjit mund të përfitojnë ulje të tatimit nga 50% deri 100% për 5-10 vite në varësi të madhësisë së investimit, numrit të vendeve të punës, sipas sektorëve prodhim, inovacion dhe me sektorë strate gjikë. Vlera minimale për përfitim është 50 mijë Euro dhe 3 vende pune të reja, (grante të caktuara janë në dispozicion në plotësim të disa kriterëve sipas ligjit.

TVSH është përshkallëzuar në tre norma, atë standarde prej 25% dhe normat e reduktuara prej 13% (ushqimet bazë dhe për artistët) dhe 5% (librat, gazetat dhe ilaçet nga viti 2019).

E re! Nga viti 2020 norma standarte do të ulet në 24%.

Pragu i TVSH-së për regjistrimin në TVSH është mbi 40.000€. Personat e tatueshëm lejohen të zbrisin 50% të TVSH-së së blerjeve për makinat (deri më përpara ishte kufiri i lejuar i kreditimit të TVSH-së ishte 53.700€.

Kontributet e sigurimeve shoqërore përbëhen nga kontributet për pensionet (mbahen në burim nga punëdhënësi) në masën 20% mbi pagën bruto dhe kontributet për punësimin dhe shëndetin (mbahen në burim nga punëdhënësi) në masën 17.2% të pagës bruto. Për të ardhura të tjera kontributet e sigurimeve janë 17.5% (10% për pensionet dhe 7.5% për shëndetin)

E re! Kontributet e detyrueshme për papunësinë (1.7%) dhe sigurinë në punë (0.5%) hiqen nga Janari 2019.

Kontributi për sigurimet shëndetësore rritet nga 5% në 15%.

4. Mali i Zi

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë të zbatueshme sipas SNK.

Format juridike të bizneseve janë (a) shoqëritë anonime, (b) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, (c) partnershipi, (d) degët dhe zyrat e përfaqësimit.

Vendi i **rezidencës fiskale** përcaktohet bazuar te regjistrimi si një entitet juridik në Malin e Zi, apo nëse kontrollohet dhe menaxhohet në Malin e Zi. Rezidenca përcaktohet nëse plotësohen kriteret e vendqëndrimit të përhershëm.

Taksimi i **rezidentit fiskal** bëhet duke marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara brenda dhe jashtë vendit. Kompanitë jorezidente taksohen vetëm për të ardhurat që burojnë nga aktiviteti brenda juridiksionit të vendit.

Dividentët që paguhen midis rezidentëve janë subjekt i tatimit në burim me normën 9%, por nuk përfshihen në të ardhurën e tatueshme. Dividentët e përfituar nga shpërndarje fitimi nga jashtë Malit të Zi përfshihen në të ardhurat e tatueshme, por rezidenti në këtë rast mund të kërkojë kreditimin e tatimit të paguar jashtë vendit.

Fitimet nga kapitali nga një rezident, si dhe jorezident taksohen me një normë tatimore 9%.

Humbja tatimore mund të bartet deri në 5 vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Tatimi mbi fitimin zbatohet me normën e sheshtë 9%. Kompanitë dhe degët janë të detyruara ta paguajnë tatimin mbi fitimin në Malin e Zi.

Kompanitë prodhuese përfitojnë lehtësi të tatimit mbi fitimin për 8 vite pas fillimit të aktivitetit.

Tatimi në burim zbatohet me normë të sheshtë prej 9% për interesat bankare, qeranë, shërbimet

tregtare, konsulentat, auditimet, të drejtat e autorësisë, patenta, shërbimet teknike.

Tatimi mbi pronën zbatohet mbi pronarin/përdoruesin me normat 0.25% deri 1%. Për kompanitë e ndërtimit ka përjashtime të kufizuara nga pagesa e këtij tatimi.

Transferimi i **të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe trashëgimisë** tatonen me normën 3% të vlerës së transaksionit. Ky tatim nuk zbatohet nëse transferimi i pasurisë realizohet si një **dhuratë** apo trashëgimni të fëmijët, prindërit apo bashkëshortja.

Në Malin e Zi nuk zbatohet politika për **kapitalizimin e hollë**, në dallim nga disa shtete fqinje të Ballkanit Perëndimor.

E ardhura nga paga është subjekti i taksimit progresiv me normat 9% dhe 11%. Kufiri ndarës për zbatimin e normave progresive është paga mesatare (750€ në muaj). Poshtë këtij pragu norma e taksimit zbatohet me 9% dhe mbi këtë prag zbatohet me 11%.

TVSH zbatohet në një normë standarte prej 21%, ndërsa norma e reduktuar është 7%. Pragu i regjistrimit për në TVSH vlen për bizneset dhe individët që kryejnë transaksione mbi vlerën 18.000 Euro në vit. Por, regjistrimi në TVSH mund të bëhet edhe vullnetarisht, pavarësisht nëse nuk realizohet një xhiro vjetore mbi pragun e përcaktuar. Përjashtimet nga TVSH përfshijnë shërbimin shëndetësor, shërbimet financiare përfshirë ato të sigurimit, edukimin. Eksperti taksohet me normën 0%.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme të paguhen janë kontributet për pensionet dhe paaftësinë në punë (20.5%), kontributi për shëndetin (12.8%) dhe kontributet për papunësinë (1%), ku përfshihen punëdhënësi dhe punëmarrësi. Niveli maksimal vjetor për pagesat e kontributeve është jo më shumë se 50.000€.

5. Maqedonia e Veriut

Format juridike të bizneseve janë (a) shoqëritë publike, (b) shoqëritë anonime, (c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, (d) partnershipi, (d) degët dhe zyrat e përfaqësimit.

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë të zbatueshme sipas SNK dhe SNRF.

Vendi i **rezidencës fiskale** përcaktohet nëse është e regjistruar sipas ligjeve maqedonase, ose nëse ka selinë ligjore si një entitet juridik, duke zbatuar kriteret e vendqëndrimit të përhershëm.

Taksimi i **rezidentit fiskal** bëhet duke marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara brenda dhe jashtë vendit. Kompanitë jorezidente taksohen vetëm për të ardhurat që burojnë nga aktiviteti brenda juridiksionit të vendit.

Dividentët që paguhen midis kompanive rezidente janë subjekt i përjashtimit nga tatimi. Dividenti taksohet me normën 10%.

Fitimet nga kapitali që shpërndahen nga kompanitë trajtohen si të ardhura të tatueshme dhe taten me 15%.

E re! Nga janari 2019, të ardhurat nga e drejta e pronësisë, të drejtat industriale, nga interes, nga qeraja dhe fitimet nga kapitali, nga lojrat e fatit, sigurimet do të taten me normën 15%, me një rritje me 50% nga më parë.

Humbja tatimore mund të bartet deri në 3 vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Sipas **kapitalizimit të hollë** nuk njihen shpenzimet për interesa për rastet kur aksionerët, që zotërojnë 25% apo më shumë aksione/drejtë votimi marrin hua që kalon 3 herë vlerën e aksioneve të tyre në kompani.

Taksa e trashëgimisë dhe transferimit të pronësisë zbatohen mbi vlerën e transaksionit me normat që variojnë nga 2% deri 5%, në varësi të afërsisë së lidhjes mes shitësit dhe blerësit.

Shitja e pasurisë së paluajtshme është subjekt i taksimit të transferimit të të drejtës së pronësisë e vendosur në nivel lokal, duke variuar nga 0.1% deri 0.2% e vlerës së transaksionit.

E re! Maqedonia e Veriut shfuqizoi zbatimin e taksës së sheshtë 10% për të ardhurat personale pas 10 vitesh praktikë. Nga Janari 2019, sipas Ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale progresive synohet të krijohet një system taksimi më i ndershëm. Të ardhurat personale mujore, që kalojnë shumën 1.460€ taksohen me normën 18%. Ky nivel taksimi nuk prek më shujë se 1% të taksapaguesve. Të ardhurat poshtë këtij pragu mujor taksohen si dhe më parë me normën 10%.

TVSH zbatohet në një normë standarte prej 18%, ndërsa norma e reduktuar është 5% për produkte farmaceutike, ushqim, teknologji informatike dhe transport publik. Pragu i regjistrimit në TVSH është 16.200€. Por, regjistrimi në TVSH mund të bëhet edhe vullnetarisht, pavarësisht nëse nuk realizohet një xhiro vjetore mbi pragun e përcaktuar.

Përjashtimet nga TVSH përfshijnë shërbimin shëndetësor, shërbimet financiare përfshirë ato të sigurimit, edukimin. Eksporti taksohet me normën 0%.

Kontributet e sigurimeve shoqërore paguhen nga punëdhënësi në emër të punëamrrësit në masën gjithsej prej 27%. Ky detyrim përfshin pagesën me 7.3% për sigurimet shëndetësore, 0.5% për sigurime shëndetësore shtesë, 18% për pension dhe paaftësi për punë dhe 1.2% për papunësinë.

6. Serbia

Format juridike të bizneseve janë (a) shoqëritë publike, (b) shoqëritë anonime, (c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, (d) partnershipi, (e) shoqëri publike, (f) degët dhe zyrat e përfaqësimit.

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë të zbatueshme sipas SNK dhe SNRF.

Vendi i **rezidencës fiskale** përcaktohet bazuar te regjistrimi si një entitet juridik në Serbi, apo nëse kontrollohet dhe menaxhohet në Serbi. Rezidenca përcaktohet edhe nëse plotësohen kriteret e vendqëndrimit të përhershëm.

Rezidenti fiskal taksohet për të ardhurat e krijuara prej tij, si brenda dhe jashtë vendit.

Dividentët që përfitohen nga kompani rezidente serbe taten në burim me normën 10%. Dividentët që i paguhen një jorezidenti taksohen në burim me normën 20%. Dividentët, që përfitohen nga kompani rezidente serbe janë të përjashtuara nga tatimi mbi fitimin.

Interesat bankare, patentat, të drejtat e autorësisë që i paguhen një jorezidenti taksohen në burim me normën 20%.

Fitimet nga kapitali nga një rezident taksohen me normën tatimore 15%, ndërsa për jorezidentët taksohen me normën tatimore 20%.

Taksa mbi pronën për bizneset që aplikojnë SNK norma e taksimit për pasurinë e paluajtshme është 0.4%.

Transferimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme aplikohet me normën 2.5%.

Tatimi mbi pagën zbatohet me normën e sheshtë 10%, pasi zbritet shuma 127€, si prag i tatimit të pagës.

E re! Blerja e aksioneve nga punonjësit e kompanisë me pagën e tyre është e përjashtuar nga tatimi i të ardhurave personale, por kushtëzohet nga kriteret e përcaktuara në ligj.

Tatim fitimi zbatohet me normën standarte 15%. **Humbja tatimore** mund të bartet deri në 5 vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

E re! Nxitje për tatimin mbi fitimin me 10 vite përjashtim (a) për investitorët e mëdhenj që financojnë projekte me vlerë mbi 8.47 milion Euro në aktive të paluajtshme dhe punësojnë 100

punëtorë gjatë periudhës së investimit, (b) njohje dyfishin e vlerës për shpenzimet për kërkim dhe zhvillim, (c) përjashtim të 80% të të ardhurës për bizneset që bëjnë regjistrim të autorësisë për pronësi intelektuale, (d) kompanitë që investojnë në kapitalizime të kompanive të reja mund të kreditojnë tatimin deri në 30% të shumës së investuar, por jo më shumë se 800.000 Euro, (e) transferimi i pronës nga një individ te një entitet që zbaton një të drejtë koncesionare është i përjashtuar nga taksimi, nëse vlera e koncesionit kalon shumë 50 milion Euro.

Kreditimi i tatimit të huaj është i kufizuar deri në shumën e nivelit të taksimit në Serbi për të ardhurën e përfituar.

Kapitalizimi i hollë zbatohet deri në nivelin e njohjes së interesave të zbritshme për hua që nuk kalojnë përtej 4 herëve kapitalin e shoqërisë dhe 10 herëve për bankat dhe shoqëritë që japin leasing.

Konsolidimi i pasqyrave financiare është funksional për Serbinë, ku kompania që këkron të raportojë në formën e konsoliduar mund të zgjedhë një nga kompanitë e grupit. Grupi konsiderohet si i tillë kur të paktën një kompani zotëron të paktën 75% të aksioneve të tjetrës.

TVSH zbatohet në një normë standarte prej 20%, ndërsa norma e reduktuar është 10%. Pragu i regjistrimit në TVSH është 67.700€. Taksapaguesit me vlerë të taksueshme nën 453.450€ deklarojnë çdo muaj, ndërsa ata që e kalojnë këtë vlerë të tatueshme vjetore deklarojnë një herë në 3 muaj. Përjashtimet nga TVSH përfshijnë disa mallra dhe shërbime. Eksportet janë të përjashtuara nga TVSH.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme janë gjithsej në masën 37.05%. Punëdhënësi paguan direkt nga llogaria e tij për pagën që i jep punëmarrësit kontribute për pensionet dhe paaftësinë në punë (12%), kontributin për shëndetin (5.15%). Punëdhënësi mban nga paga bruto dhe i paguan në emër të punëmarrësit edhe kontributet për pensionet dhe paaftësinë në punë (14%), kontributi për shëndetin (5.15%) dhe pagesa për papunësinë (0%)

E re! Pagesa e papunësisë që i mbahet punëmarrësit nga punëdhënësi është shfuqizuar nga 1.5% në 0%.

7. Shqipëria

Format juridike e biznesve në Shqipëri janë (i) tregtar i thjeshtë, (ii) shoqëri kolektive; (iii) ortakëri e kufizuar; (iv) kompani me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.); (v) shoqëri aksionare (sh.a.); (vi) shoqëri publike, (vii) degë dhe zyrë përfaqësimi.

Rregullat e **kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë të zbatueshme sipas SNK dhe SNRF.

E re! Një ligj i ri zbatohet nga Janari 2019 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Vendi i **rezidencës fiskale** përcaktohet bazuar te regjistrimi si një entitet juridik në Shqipëri, apo nëse kontrollohet dhe menaxhohet në Shqipëri. Rezidenca përcaktohet edhe nëse plotësohen kriteret e vendqëndrimit të përhershëm. **Riadthesimi i fitimeve** pas tatimit është i lejuar.

Rezidenti fiskal taksohet për të ardhurat e krijuara prej tij, si brenda dhe jashtë vendit.

E re! Të ardhurat nga shërbimet e kryera nga personat jo rezidentë do të konsiderohen me burim në Shqipëri, nëse ato kryhen për një person rezident, pavarësisht vendit se ku kryhen fizikisht e pavarësisht vendit nga i cili paguhen. Më parë, konsideroheshin me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, vetëm të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga personat jo rezidentë.

E re! Krahasa të ardhurave nga pronësia (dhe nga të drejta të tjera që rrjedhin nga pronësia) mbi pasuri të paluajtshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të konsiderohen të ardhura me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, edhe të ardhurat nga (i) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, (ii) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure, (iii) të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacioni që u përket këtyre të drejtave. Të drejtat e mësipërme dhe informacioni i lidhur me to do të trajtohen për qëllime të tatimit në Shqipëri sikur të ishin pasuri e paluajtshme. Si të tilla, përveç të ardhurave nga shfrytëzimi i tyre, edhe të ardhurat nga tjetërsimi i tyre (kalimi i pronësisë mbi to) do të konsiderohen gjithashtu me burim në Shqipëri, pra të tatueshme në Shqipëri.

E re! Të ardhurat nga aksionet e pjesëmarrjet me burim në Shqipëri. Do të konsiderohen me burim

në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, të ardhurat e realizuara nga personat jo rezidentë nga kalimi i pronësisë mbi aksione ose interesa pjesëmarrjeje, kudo që ato ndodhen, nëse (i) përgjatë një viti para kalimit të pronësisë, më shumë se 50% e vlerës së atyre aksioneve a interesave, i atribuohet direkt ose indirekt pasurisë së paluajtshme, të drejtave ose informacionit të përmendura më lart.

Dividentët që përfitohen nga shpërndarja e fitimit taten në burim me normën 15%. Dividentët që i paguhen një jorezidenti taksohen në burim me normën 15%. Dividentët, që përfitohen nga kompani rezidente janë të përjashtuara nga tatimi mbi fitimin.

E re! Norma e tatimit mbi dividendët që u shpërndahen aksionarëve e mbi fitimet që u shpërndahen ortakëve do të ulet nga 15% në 8%. Për dividendët/fitimet që shpërndahen nga shoqëritë rezidente në Shqipëri, kjo normë e reduktuar do të zbatohet mbi fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që (a) tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30.09.2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20.08.2019.

Interesat bankare, patentat, të drejtat e autorësisë që i paguhen një rezidenti apo jorezidenti taksohen në burim me normën 15%.

Fitimet nga kapitali nga një rezident taksohen me normën tatimore 15%, ashtu si dhe jorezidentët taksohen me normën tatimore 15%.

E re! Në rastet, kur fitimi kapital i realizuar nga aksionarët nga shitja direkte apo indirekte e kapitalit a të drejtave të votës të një personi juridik në Shqipëri konsiderohet si e ardhur me burim në Shqipëri dhe personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë llogarit dhe paguan tatimin mbi fitimin e konsideruar nga shitja e aktiveve, sipas parashikimeve të mësipërme, atëherë fitimi kapital i aksionarëve nuk do të jetë objekt tatimi mbi fitimi në Shqipëri.

E re! Nëse, gjatë një periudhe tatimore, pronësia direkte ose indirekte e kapitalit apo të drejtave të votës të një personi juridik ndryshon me më shumë se 20%, ai person juridik do të trajtohet sikur (i) të ketë shitur një pjesë proporcionale të aktiveve të veta me vlerën e tregut të tyre, dhe të ketë riblerë të njëjtat aktive me

të njëjtën vlerë tregu. Në këtë mënyrë, personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë do të njohë një 'fitim të tatueshëm nga shitja e konsideruar e aktiveve' dhe do të llogarisë tatim fitimi mbi të. Ky rregull zbatohet në rast se personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë ka realizuar në 3 vitet paraardhëse një mesatare qarkullimi prej të paktën 500 milionë Lekë.

Taksa mbi pronën për projektet e ndërtimeve, që përdoren për qëllime biznesi aplikohen (a) 4%-8% e çmimit të shitjes për m² për ndërtesat për qëllime banimi dhe tregti, (b) 2%-4% për mbi vlerën e investimit për kryeqytetin dhe 1%-3% për bashkitë e tjera, për ndëtime turistike, agroindustri, industri, për qëllime personale banimi, si dhe për qëllime publike (c) 0.1% të vlerës së investimit për projekte infrastrukturore, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, aeroporteve, porteve etj.

Transferimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme aplikohet me normën 2% të çmimit të shitjes për pasuritë e paluajtshme, përveç ndërtesave që kanë një taksë nga 2.4€/m² deri 16€/m².

Taksa e trashëgimisë dhe transferimit të pronësisë zbatohen mbi vlerën e transaksionit me normën 15%.

Tatimi mbi pagën zbatohet me normën e sheshtë 10%, pasi zbritet shuma 240€, si prag i tatimit të pagës së pataueshme.

E re! Rritet niveli i sipërm i segmentit të pagave që taten me normën 13%, duke u rritur nga 130,000 Lekë/muaj në 150,000 Lekë/muaj.

Tatimi i fitimit zbatohet me normën standarte 15% dhe me normën e reduktuar për aktivitete turistike, informatike.

E re! Nga Janari 2019 bizneset e regjistruara për tatim fitimin me xhiro nga 64.000€ deri 112.000€ do të paguajnë normën tatimore 5% mbi fitimin në vend të 15% që ishte më parë. Bizneset me xhiro vjetore nga 40.000€ deri 64.000€ do të paguajnë normën tatimore 5%.

Nxitjet për investime jepen në forma të ndryshme të zbatuara sipas ligjeve që i përcaktojnë ato, të tilla si: (i) norma të ulëta tatimore (5%) pa parakushte; (ii) Skemë e veçantë për fermerët; (iii) norma të reduktuara TVSH për shërbime turistike dhe informatike; (iv) sektor ekonomik i përjashtuar nga TVSH (kërkimi hidrokarbureve); (v) përjashtim nga tatim fitimi

për 10 vite për hotelet turistike me 4 – 5 yje(vi) lehtësim nga tatim fitimi bazuar mbi projekte investimi rast pas rasti, si ndërtimet infrastrukturore, turizm, industri e veshjeve, prodhimi naftës dhe sipërmarrjet e reja; (vii) njohje dyfish të shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim investime në zonat e lira ekonomike.

Humbja tatimore mund të bartet deri në 3 vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Kreditimi i tatimit të huaj është i kufizuar deri në shumën e nivelit të taksimit në Serbi për të ardhurën e përfutur.

Kapitalizimi i hollë zbatohet deri në nivelin e njohjes së interesave të zbritshme për hua që nuk kalojnë përtej 4:1 të raportit borxhe/kapital, si dhe tejkalimi i interesave neto me 30% mbi fitimin para EBITDA është i panjohur për taksimin si shpenzim.

Konsolidimi i pasqyrave financiare nuk është funksional për Shqipërinë.

E re! Rregull i ri **anti-shmangje** është në zbatim nga Janari 2019, ku administratës tatimore i jepet e drejta të mos pranojë transaksione të konsideruara të dyshuara bazuar mbi kriteret kufizuese për palët e lidhur në transaksione.

TVSH zbatohet në një normë standarte prej 20%, ndërsa norma e reduktuar është 6% (minibusët elektrike, hotelet turistike, reklamat për mediat audiovizive, librat, akomodimi dhe restorantet për njësitë e agroturizmit). Pragu i regjistrimit në TVSH është 16.000€. Disa aktivitete si profesionistët e licensuar nuk kanë prag xhiro për regjistrimin në TVSH. Aktiviteti i prodhuesve bujqësorë e kanë praguin e xhiros 40.000€ për tu regjistruar në TVSH. Përjashtimet nga TVSH përfshijnë disa mallra dhe shërbime. Eksportet janë me normë 0% TVSH.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme janë gjithsej në masën 27.9%. Punëdhënësi paguan direkt nga llogaria e tij për pagën që i jep punëmarrësit kontribute për pensionet dhe papaftësinë në punë (15%), kontributin për shëndetin (1.7%). Punëdhënësi mban nga paga bruto dhe i paguan në emër të punëmarrësit edhe kontributet për pensionet dhe papaftësinë në punë (9.5%), kontributi për shëndetin (1.7%).

REFERENCA

- Ministria e Financave, Statistika Fiskale Janar - Dhjetor 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- Ministria e Financave, Buletini Fiskal (ne tremujore)
- Ministria e Financave, Treguesit e Borxhit, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- Ministria e Financave te Republikës se Kosovës, Treguesit makro - Buxhetet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- ATK, Raportet vjetore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- ATK, Plani Vjetor i Punës për vitin 2017, 2018
- Raportet e buxheteve komunale, Kosovë
- Raportet e buxheteve bashkive 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- INSTAT, ASK, PBB sipas qarqeve/rajoneve viti 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- KPMG
- Paying taxes 2016, 2017, 2018, 2019
- World Bank, Statistical data, 2015, 2016, 2017, 2018
- IMF, Country Reports 2014, 2015, 2016, 2017, 2018
- Index of Tax Freedom, 2018, Heritage.org
- <http://vendime.al>
- <http://portavendore.al>
- <http://orbitax.com>
- February 2018, Dabrowski Marek and Myachenkova Yana, The Western Balkans on the road to the European Union
- Deloitte 2018, Corporate tax rate 2018
- Ruben Atoyán, Dora Benedek, Ezequiel Cabezon, Giuseppe Cipollone, Jacques Miniane, Nhu Nguyen, Martin Petri, Jens Reinke, and James Roaf - IMF, Public Infrastructure in Western Balkans
- OECD, Tax Effects on Foreign Direct Investment
- OECD, Tracking Special Economic Zones in the Western Balkans,
- Bashkia Tiranë, Bilanci i përgjithshëm i të hyrave dhe të dalave, 2018
- CE 02.2018, A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans
- World Bank Group, wiiw, Western Balkans Labor Market Trends 2019

BARRA FISKALE

në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019

Raporti i Tatimeve, taksave dhe kontributeve ndaj Prodhimit të Brendshëm

Barra fiskale sipas Qarqeve/Rajoneve në Shqipëri dhe në Kosovë në vitin 2018

Investimi dhe Normat Tatimore në 7 shtetet e Ballkanit Perëndimor

Indeksi GINI dhe pabarazia

Shpërndarja e barrës fiskale

ALTAX

Dita e Lirisë Fiskale në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, 2019

Tatimet ndaj Prodhimit të Brendshëm

Barra fiskale sipas qarqeve/rajoneve në Shqipëri dhe Kosovë, 2018

Shpërndarja e barrës fiskale sipas destinacionit të shpenzimeve

Investimet dhe Normat Tatimore në 7 shtetet e Ballkanit Perëndimor

Indeksi GINI dhe pabarazia

Tax Freedom Day in Albania, Kosovo and Western Balkans in 2019

Tax to GDP ratio 2018

Tax burden according to regions in Albania and Kosovo in 2018

Distribution of tax burden based on the destination of expenditures

Investments and tax rates in the 7 countries of Western Balkans

GINI Index and Inequality